

# LIGJI PËR KUNDËRVAJTJE

("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 65/2013 dhe 13/2016)

## Pjesa e parë DISPOZITAT MATERIALO-JURIDIKE

### Kreu I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

#### Objekti i ligjit

##### Neni 1

Me anë të këtij ligji rregullohet: definicioni i kundërvajtjes, kushtet për përgjegjësinë kundërvajtëse, kushtet për përshkrimin dhe zbatimin e sanksioneve kundërvajtëse, sistemi i sanksioneve, procedura kundërvajtëse, dhënia e urdhërit kundërvajtës, procedura e zbatimit të vendimit, regjistri i sanksioneve dhe regjistri i gjobave të papaguara dhe shumave tjera në të holla.

#### Definicioni i kundërvajtjes

##### Neni 2

Kundërvajtje është çdo veprim kundërligjor i cili me ligj apo rregull tjetër të organit përgjegjës është caktuar si kundërvajtje dhe për të cilin është caktuar sanksioni kundërvajtës.

#### Ligjshmëria në rregullimin e kundërvajtjes dhe sanksioneve kundërvajtëse

##### Neni 3

Askush nuk mund të dënohet për kundërvajtje, as kundër tij nuk mund të zbatohen sanksione tjera kundërvajtëse, nëse ajo veprë para se të zbatohet, me ligj, apo me rregullën e bazuar në ligj nuk është paraparë si kundërvajtje dhe për të cilin me ligj apo me rregull tjetër të bazuar në ligj nuk është paraparë se me cilin lloj apo lartësi të sanksionit mund të dënohet kundërvajtësi.

#### Rregullimi i kundërvajtjes

##### Neni 4

Kundërvajtjet mund të rregullohen me ligj apo rregullore, gjegjësisht me anë të vendimit të kuvendit të krahinës autonome, kuvendit komunal, kuvendit të qytetit dhe kuvendit të qytetit të Beogradit.

Organet e autorizuara për miratimin e rregullave për kundërvajtjet mund të rregullojnë vetëm sanksionet e parapara me anë të këtij ligji dhe brenda kufijve të cilat i cakton ky ligj.

Organet e autorizuar për miratimin e rregullave nga pika 1 e këtij neni mund të rregullojnë sanksione kundërvajtëse vetëm për shkeljet e rregullave të cilat i miratojnë ata në kuadër të kompetencës së tyre të caktuar me anë të kushtetutës dhe ligjit, nën kushtet e caktuara me këtë ligj.

Organi i cili është i autorizuar që të rregullojë sanksionet kundërvajtëse nuk mund ta bartë këtë të drejtë tek organet tjera.

## **Qëllimi i sanksioneve kundërvajtëse**

### **Neni 5**

Për kundërvajtje mund të caktohen sanksione të rregulluara me anë të këtij ligji.

Qëllimi i rregullimit, caktimit dhe zbatimit të sanksioneve kundërvajtëse është që qytetarët të respektojnë sistemin juridik dhe që në të ardhmen të mos bëhen shkelje.

## **Vlefshmëria kohore e rregullave**

### **Neni 6**

Në autorin e veprës zbatohet ligji, gjegjësisht rregulla e cila ishte e vlefshme në kohën e kryerjes së veprës.

Nëse pas kundërvajtjes një herë apo më shumë herë është ndryshuar rregulla, zbatohet rregulla e cila është më e butë për kryesin.

## **Vlefshmëria hapësinore e rregullës**

### **Neni 7**

Dispozitat për kundërvajtje vlejné në territorin e Republikës së Serbisë kur janë të rregulluara me ligj, gjegjësisht në territorin e njërive të autonomisë territoriale dhe njërive të qeverisë lokale, kur janë të rregulluara me anë të vendimit të kuvendit të krahinës autonome, kuvendit komunal, kuvendit të qytetit apo kuvendit të qytetit të Beogradit.

Për kundërvajtjen e paraparë me rregullat e Republikës së Serbisë do të dënohet kryesi nëse kundërvajtja është kryer në territorin e Republikës së Serbisë apo nëse është kryer në anijen apo aeroplanin vendor derisa gjendej jashtë territorit të Republikës së Serbisë.

Për kundërvajtjen e kryer jashtë shtetit do të dënohet kundërvajtësi vetëm nëse kjo gjë është e rregulluar me anë të ligjit apo rregullores.

Në rastin nga pika 2 e këtij neni, nën kushtin e reciprocitetit, ndjekja mund t'i dorëzohet shtetit të jashtëm në të cilin kundërvajtësi i cili është shtetas i huaj ka vendbanim.

## **Ndalimi i gjykimit të përsëritur të çështjes së njëjtë**

### **Neni 8**

Askujt nuk mund t'i përsëritet gjykimi dhe as nuk mund t'i kumtohet sanksioni kundërvajtës për kundërvajtje mbi të cilën është vendosur në pajtim me ligjin.

Ndalesa nga pika 1 e këtij neni nuk pengon përsëritjen e procedurës kundërvajtëse në pajtim me këtë ligj.

Kundër kundërvajtësit i cili në procedurë penale është shpallur fajtor për veprën penale e cila përfshin edhe karakteristika të kundërvajtjes nuk mundet për atë kundërvajtje të nisët procedurë, kurse nëse është filluar apo është duke u zhvilluar, nuk mund të vazhdohet dhe të përfundohet.

Kundër kryesit të veprës i cili gjatë procedurës sipas shkeljes ekonomike është deklaruar përgjegjës për shkeljen e cila përfshin edhe karakteristika të kundërvajtjes nuk mund të iniciohet procedurë, dhe nëse është filluar apo është duke u zhvilluar, nuk mund të vazhdohet apo të përfundohet.

## **Imuniteti diplomatik**

### **Neni 9**

Procedura kundërvajtëse nuk do të zhvillohet dhe as nuk do të kumtohet sanksioni kundërvajtës kundër personave të cilët gëzojnë imunitet diplomatik, në rastin e ekzistimit të reciprocitetit.

## **Kreu II KRYERJA E KUNDËRVAJTJES**

### **Vepra e kryerjes së kundërvajtjes**

#### **Neni 10**

Kundërvajtja mund të kryhet me anë të veprimit apo mosveprimit.

Kundërvajtja është kryer me mosveprim kur moskryerja e veprës me rregullore është e paraparë si kundërvajtje.

### **Koha e kryerjes së kundërvajtjes**

#### **Neni 11**

Kundërvajtja është kryer në kohën kur kryesi ka punuar apo ishte i detyruar të punojë, pa marrë parasysh kur është paraqitur pasoja.

### **Vendi i kryerjes së kundërvajtjes**

#### **Neni 12**

Kundërvajtja është kryer në vendin ku kundërvajtësi ka punuar apo ka qenë i detyruar të punojë, si dhe në vendin ku është paraqitur pasoja.

### **Mbrojtja e domosdoshme**

#### **Neni 13**

Nuk ka kundërvajtje nëse vepra është rregulluar si kundërvajtje e kryer në mbrojtje të domosdoshme.

Mbrojtja e domosdoshme është ajo mbrojtje e cila është e nevojshme që kryesi nga e mira e vet ose e mira e tjetërkujt refuzon sulmin e njëkohëshëm kundërmbrojtës.

Kryesi i cili ka tejkalluar kufijtë e mbrojtjes së domosdoshme, mund të dënohet më butë. Nëse ky tejkallim është bërë nën rrethanat posaçërisht lehtësuese, kryesi mund të lirohet nga dënimi.

### **Nevoja ekstreme**

#### **Neni 14**

Nuk ka kundërvajtje nëse vepra është shënuar si kundërvajtje e kryer në nevojë ekstreme.

Nevoja ekstreme ekziston nëse kundërvajtja është kryer në mënyrë që kryesi të heqë nga e mira e tij apo e mira e dikujt tjetër rrezikun e pandryshuar i cili në mënyrë tjetër nuk mundi të hiqet, dhe nëse gjatë kësaj dëmi i shkaktuar nuk është më i madh se dëmi i cila kërcënohej.

Kryesi i cili ka kaluar kufirin e nevojës ekstreme, mund të dënohet më lehtë. Nëse ai tejkallim është bërë nën rrethana posaçërisht lehtësuese, kryesi mund të lirohet nga dënimi.

### **Forca dhe kërcënimi**

#### **Neni 15**

Nuk ka kundërvajtje nëse kryesi ka vepruar nën ndikimin e forcës së pashmangshme.

Kryesi i cili ka kryer kundërvajtje nën ndikimin e forcës të cilës ka mundur t'i rezistojë apo nën ndikimin e kërcënimit mund të dënohet lehtë, nëse fuqia dhe kërcënimi nuk konsiderohen si rrezik i pandryshueshëm në kuptimin e nenit 14 të këtij ligji.

### **Tentativa**

#### **Neni 16**

Për tentativë të kundërvajtjes kryesi do të dënohet vetëm nëse kjo është rregulluar në mënyrë të posaçme.

## **Kreu III PËRGJEGJËSIA PËR KUNDËRVAJTJE**

### **Subjektet e përgjegjesisë**

#### **Neni 17**

Për kundërvajtje mund të përgjigjen personi fizik, ndërmarrësi, personi juridik dhe personi përgjegjës në personin juridik.

Republika e Serbisë, autonomitë territoriale dhe njësitë e qeverisë lokale dhe organet e tyre nuk mund të jenë përgjegjës për kundërvajtje, por me anë të ligjit mund të rregullohet që për kundërvajtje nën kushtet nga neni 18, paragrafi 1 i këtij ligji përgjigjet personi përgjegjës në organin shtetëror, organin e autonomisë territoriale apo organin e njësisë së qeverisë lokale.

## *Përgjegjësia e personit fizik*

### **Neni 18**

Personi fizik përgjigjet për kundërvajtjen e cila mund t'i atribuohet faji për arsye se ishte e menduar dhe kundërvajtja është bërë me plan apo nga pakujdesi, kurse ishte i vetëdijshëm apo ishte i detyruar dhe mund të ishte i vetëdijshëm që ky veprim është i ndaluar.

Nëse me anë të këtij ligji nuk është rregulluar ndryshe, rregulla nga paragrafi 1 i këtij ligji aplikohet edhe tek ndërmarrësi, personat përgjegjës në personin juridik, organin shtetëror, organin e autonomisë territoriale dhe njësitë e qeverisë lokale apo te ndërmarrësi.

### **Moskompetenca, moskompetenca e fshehur dhe kompetenca e zvogëluar**

### **Neni 19**

Kryesi jo kompetent nuk është përgjegjës për kundërvajtjen.

Jo kompetent është kryesi i cili nuk ka mundur të kuptojë rëndësinë e këtij procesi apo nuk ka mundur të udhëheqë me veprimet e veta për shkak të sëmundjeve mendore, çrregullimeve të përkohshme mendore, ngecjes në zhvillimin mendor apo çrregullimit tjetër më të rëndë.

Kryesit të kundërvajtjes, aftësia e të cilit për të kuptuar rëndësinë e këtij veprimi apo aftësi që të udhëheqë me veprimet e veta është dukshëm e zvogëluar për shkak të ndonjëres nga gjendjet nga paragrafi 2 i këtij neni (kapaciteti mendor i ulur) mund t'i lehtësohet dënimi.

Nuk konsiderohet jo kompetent kundërvajtësi i cili me përdorimin e alkoolit apo në mënyrë tjetër e shpie veten në gjendjen në të cilën nuk ka mundur të kuptojë rëndësinë e veprimit të vet apo nuk ka mundur të udhëheqë me veprimet e veta nëse në kohën kur është gjendur në atë gjendje ishte e vetëdijshëm apo ishte i obliguar dhe ka mundur të jetë i vetëdijshëm që në atë gjendje mund të kryejë kundërvajtje.

### **Pakujdesia dhe qëllimi**

### **Neni 20**

Për ekzistimin e përgjegjësisë është e mjaftueshme pakujdesia e kryesit nëse me anë të rregullores për kundërvajtje nuk është caktuar që do të dënohet nëse kundërvajtja është kryer me qëllim.

Kundërvajtja e kryer nga pakujdesia kur kundërvajtësi ishte i vetëdijshëm që gjatë kryerjes së saj apo moskryerjes mund të paraqitet pasoja e ndaluar, apo nëse ka menduar se mund ta parandalojë apo se ajo nuk do të ndodhë, apo kur nuk ishte i vetëdijshëm për mundësitë e paraqitjes së pasojës së ndaluar, edhe pse sipas rrethanave dhe sipas cilësive tjera personale ishte i obliguar dhe ka mundur të jetë i vetëdijshëm për atë mundësi.

Kundërvajtja është bërë me qëllim kur kundërvajtësi ishte i vetëdijshëm për veprimin e vet dhe dëshironte ekzekutimin e tij apo kur ishte i vetëdijshëm që gjatë kryerjes së tij apo moskryerjes mund të paraqitet pasoja e ndaluar dhe ka pranuar paraqitjen e tij.

### **Lajthimi real**

## **Neni 21**

Nuk është përgjegjës për kundërvajtje kryesi i cili në kohën e kundërvajtjes së kryer ishte në lajthitje reale të pashmangshme.

Lajthitja reale është e pashmangshme nëse kryesi nuk ishte i detyruar dhe nuk ka mundur t'i shmanget lajthitjes në pikëpamjen e ndonjë rrethane reale e cila paraqet karakteristikat e kundërvajtjes apo në pikëpamjen e ndonjë rrethane reale e cila, po të kishte ekzistuar me të vërtetë, do ta mundësonte veprimin e kryesit.

## **Lajthitja ligjore**

### **Neni 22**

Nuk është përgjegjës për kundërvajtje kryesi i cili gjatë kohës së kundërvajtjes ishte në lajthitje ligjore të pashmangshme.

Lajthitja ligjore është e pashmangshme nëse kryesi nuk ishte i detyruar dhe nuk ka mundur të dijë që ai veprim është i ndaluar.

Nëse lajthitja mund të shmanget, kryesi mund të dënohet më lehtë për kundërvajtjen e kryer.

## **Bashkëkryerja**

### **Neni 23**

Nëse më shumë persona, me pjesëmarrje në veprën kundërvajtëse, e kryejnë kundërvajtjen së bashku apo me realizimin e vendimit të përbashkët për një vepër tjetër dukshëm kontribuojnë në kryerjen e kundërvajtjes, secili prej tyre do të dënohet me anë të dënimit të paraparë për atë kundërvajtje.

## **Nxitja**

### **Neni 24**

Ai i cili e nxitë tjetrin që të kryejë kundërvajtje do të dënohet sikur ta kishte kryer vetë.

## **Ndihma**

### **Neni 25**

Ai i cili tjetrin me paramendim e ndihmon që të kryejë kundërvajtje do të dënohet njëjtë sikur ta kishte kryer vetë.

## **Kufijtë e përgjegjësisë së bashkëvepruesit**

### **Neni 26**

Nxitësi dhe ndihmësi janë përgjegjës në kufijtë e paramendimit të tyre, kurse kryesi është përgjegjës për kundërvajtjen në kufijtë e paramendimit apo qëllimit të tij.

Duke pasur parasysh natyrën e kundërvajtjes, mënyrën apo rrethanat nën të cilat është kryer kundërvajtja, ndihmësi mund të dënohet lehtë.

## **Përgjegjësia e personit juridik**

### **Neni 27**

Personi juridik është përgjegjës për kundërvajtjen e kryer me anë të veprës apo moskryerjes së mbikëqyrjes shtetërore të organit të udhëheqjes apo personit përgjegjës apo me anë të veprës së personit tjetër i cili në kohën e kryerjes së kundërvajtjes ishte i autorizuar që të veprojë në emër të personit juridik.

Personi juridik është përgjegjës për kundërvajtje edhe kur:

- 1) organi i udhëheqjes merr vendim të paligjshëm apo urdhër me të cilin është mundësuar kryerja e kundërvajtjes apo personi përgjegjës e urdhëron personin që të kryejë kundërvajtje;
- 2) personi fizik kryen kundërvajtje gjatë lëshimit që mbi personin përgjegjës të kryejë mbikëqyrje apo kontrollë.

Nën kushtet nga paragrafit 2 i këtij neni personi juridik mund të përgjigjet për kundërvajtje edhe kur:

- 1) kundër personit përgjegjës është ndaluar procedura kundërvajtëse apo ai person është liruar nga përgjegjësia në pajtim me dispozitat e nenit 250 të këtij ligji;
- 2) Ekzistojnë pengësia ligjore apo reale për përcaktimin e përgjegjësisë së personit përgjegjës në personin juridik apo nuk mund të caktohet se kush është personi përgjegjës.

Përgjegjësia e personit fizik apo përgjegjës në personin juridik për kundërvajtjen e kryer, veprën penale apo deliktin ekonomik nuk përjashton përgjegjësinë e personit juridik për kundërvajtje.

### **Neni 28**

Me ndalimin e ekzistimit të personit juridik gjatë procedurës kundërvajtëse ndërpritet përgjegjësia e tij për kundërvajtjen, përveç në rastin e ekzistimit të pasardhësit ligjor, kur për kundërvajtje përgjigjet pasardhësi ligjor.

Nëse personi juridik e ka ndërprerë ekzistencën pas procedurës kundërvajtëse të përfunduar me vendim, sanksioni i kumtuar do të zbatohet sipas pasardhësit ligjor.

Personi juridik i cili gjendet në falimentim mund të përgjigjet për kundërvajtjen e kryer para hapjes apo gjatë procedurës falimentuese, por nuk mund t'i kumtohet dënimi, por vetëm masa mbrojtëse e marrjes së lëndës dhe marrja e dobisë pronësorë.

## **Përgjegjësia e ndërmarrësit**

### **Neni 29**

Ndërmarrësi përgjigjet për kundërvajtjen të cilën e kryen gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij.

## **Përgjegjësia e personit përgjegjës**

### **Neni 30**

Personi përgjegjës, më kuptimin e këtij ligji, konsiderohet personi të cilit në personin juridik i janë besuar punë të caktuara të cilat kanë të bëjnë me udhëheqjen, afarizimin apo procesin e punës, si dhe personi i cili në organin shtetëror, organin e autonomisë territoriale dhe njësitë e qeverisë lokale kryen detyra të caktuara.

Nuk është përgjegjës për kundërvajtje personi përgjegjës i cili ka vepruar në bazë të urdhërit të personit tjetër përgjegjës apo organit udhëheqës dhe nëse ka ndërmarrë të gjitha punët të cilat në bazë të ligjit, rregullores tjetër apo aktit ka qenë i detyruar t'i ndërmarrë në mënyrë që të pengojë kryerjen e kundërvajtjes.

Përgjegjësia e personit përgjegjës nuk përfundon për arsye se i ka përfunduar marrëdhënia e punës në personin juridik, organin shtetëror apo organin e njësisë së qeverisë lokale dhe as për shkak se janë paraqitur pamundësi që personi juridik të deklarohet përgjegjës për ndërprerjen e saj.

### **Përgjegjësia e personave të huaj**

#### **Neni 31**

Personi fizik i huaj, personi juridik i huaj dhe personi përgjegjës përgjigjen për kundërvajtje njëjtë sikur edhe personi fizik, juridik dhe përgjegjës vendor.

Personi juridik i huaj dhe personi përgjegjës do të dënohen për kundërvajtjen e kryer në territorin e Republikës së Serbisë nëse personi juridik i huaj ka njësinë punuese apo përfaqësinë në Republikën e Serbisë apo kundërvajtja është kryer me anë të mjetit të tij të transportit, nëse me rregulloren më të cilën është rregulluar kundërvajtja nuk është paraparë diçka tjetër.

### **Kreu IV**

## **SANKSIONET KUNDËRVAJTËSE**

#### **Neni 32**

Sanksionet kundërvajtëse janë:

- 1) dënimet;
- 2) dënimet me pikë;
- 3) vërejtja;
- 4) masat mbrojtëse;
- 5) masat edukative.

#### ***1. Dënimet***

#### **Neni 33**

Për dënim mund të rregullohen dënimi me burg, dënimi me para dhe puna në interes publik.



Në kuadër të qëllimit të përgjithshëm të sanksioneve kundërvajtëse (neni 5 paragrafi 2.) qëllimi i dënimit është që t'i shprehet ndëshkimi publik vepruesit për shkak të kundërvajtjes së kryer dhe të ndikohet në atë dhe në të gjithë personat tjerë që në të ardhmen të mos kryejnë kundërvajtje.

### **Mënyra e rregullimit të dënimeve**

#### **Neni 34**

Për një kundërvajtje mund të jepet edhe dënimi me burgim edhe gjoba dhe të dyjat mund të kumtohen bashkë.

Për kundërvajtjen e personit juridik mund të kumtohet vetëm gjoba.

### **Kompetenca për caktimin e dënimeve**

#### **Neni 35**

Dënimi me burgim mund të caktohet vetëm me anë të ligjit.

Gjoba dhe puna në interes publik mund të caktohen me anë të ligjit apo rregullores, gjegjësisht vendimin e kuvendit të krahinës autonome, kuvendit komunal, kuvendit të qytetit apo kuvendit të komunës së Beogradit.

### **Kumtimi i dënimit**

#### **Neni 36**

Dënimi me burgim mund të kumtohet vetëm si dënim kryesor.

Gjoba dhe puna në interesin publik mund të kumtohen si dënim kryesor apo anësor.

Nëse gjoba dhe dënimi me burgim janë rregulluar në mënyrë alternative, dënimi me burgim kumtohet vetëm për kundërvajtjen me të cilën janë shkaktuar pasoja më të rënda, apo për kundërvajtjet të cilat tregojnë për shkallën më të lartë të fajit të kundërvajtësit në pajtim me nenin 18, paragrafi 1 i këtij ligji.

### **Dënim me burgim**

#### **Neni 37**

Dënimi me burgim nuk mund të caktohet në kohëzgjatje më të shkurtër se një e as më të gjatë se gjashtëdhjetë ditë.

Dënimi me burgim nuk mund t'i shqiptohet gruas shtatzëne, pas tre muajve të shtatzënisë, as nënës derisa fëmija të mos mbushë një vjet, dhe nëse fëmija ka lindur i vdekur apo nëse ka vdekur pas lindjes derisa të mos kalojnë gjashtë muaj nga dita e lindjes.

### **Puna në interes publik**

#### **Neni 38**

Puna në interesin publik është punë e papaguar në dobi të shoqërisë e cila nuk kryhet nën detyrim, me të cilin nuk lëndohet dinjiteti njerëzor dhe nuk realizohet fitimi.

Puna në interesin publik nuk mund të zgjatë më pak se 20 orë dhe as më gjatë se 360 orë.

Gjatë shqiptimit të punës në interes publik, gjykata do të ketë parasysh llojin e kundërvajtjes së kryer, moshën, aftësinë fizike dhe punëtore, karakteristikat psikike, arsimimin, prirjet dhe rrethanat tjera të veçanta të cilat kanë të bëjnë me personalitetit e kundërvajtësit.

Nëse personi i dënuar nuk kryen një pjesë apo të gjitha orët e dënimit të shqiptuar të punës në interes publik, gjykata do ta zëvendësojë atë dënim me dënim me burg ashtu që për çdo tetë orët e filluara të punës në interes publik do të caktohet një ditë burgim.

## **Gjoha**

### **Neni 39**

Me anët ligjit apo rregullores gjoha mund të rregullohet në proporcionin:

- 1) prej 5.000 deri 150.000 dinarë për person fizik apo personin përgjegjës;
- 2) prej 50.000 deri 2.000.000 dinarë për personin juridik;
- 3) prej 10.000 deri 500.000 dinarë për ndërmarrësit.

Me përjashtim të dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni, gjoha mund të rregullohet në shumën fikse për personin fizik dhe personin përgjegjës prej 1.000 deri 50.000 dinarë, për ndërmarrësin prej 5.000 deri 150.000 dinarë, kurse për personin juridik prej 10.000 deri 300.000 dinarë.

Me vendimet e kuvendit të krahinës autonome, kuvendit komunal, kuvendit të qytetit apo kuvendit të qytetit të Beogradit, mund të rregullohen gjobat vetëm në shumë fikse, edhe atë nga shuma minimale deri të gjysma e shumës më të lartë fikse të rregulluara në paragrafin 2 të këtij neni.

Me përjashtim të dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni, për kundërvajtjet nga fusha e të ardhurave publike, informimit publik, punës doganore, tregtisë së jashtme dhe devizore, mjedisit njerëzor, qarkullimit të mallrave dhe shërbimeve dhe tregtisë me letra me vlerë, me ligj mund të rregullohen dënimet në proporcion me lartësinë e dëmit të shkaktuar apo obligimit të pakryer, vlerës së mallit apo gjësë tjetër e cila është subjekt i kundërvajtjes, por jo më shumë se shuma njëzetfish të atyre vlerave ashtu që të mos kalojë shumën e pesëfish të gjobave më të larta të cilat mund të shqiptohen sipas dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni.

## **Afati i pagesës së gjobës**

### **Neni 40**

Në aktgjykim dhe urdhër kundërvajtje caktohet afati për pagesën e gjobës, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 15 ditë nga dita e marrjes së aktgjykimit, dhe nëse ankesa është bërë apeli, nga dita e dorëzimit të aktgjykimit të shkallës së dytë, gjegjësisht tetë ditë nga dita e dorëzimit të urdhrit të kundërvajtjes.

Me anë të vendimit gjykata mund të lejojë që në raste të arsyetuara gjoba të paguhet në këste, ku caktohet mënyra dhe afati i pagesës, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se gjashtë muaj, nën kushtin që të jenë paguar shpenzimet e procedurës.

Në vendimin nga paragrafi 2 i këtij neni nuk lejohet ankesa.

Nëse personi i dënuar të cilit i lejohet që gjobën ta paguajë në këste nuk e bën pagesën me rregull, gjykata mundet, me anë të vendimit, ta tërheqë vendimin e saj për pagesën me këste.

Kundër vendimit nga paragrafi 4 i këtij neni, nuk është e lejuar ankesa.

## **Zëvendësimi i gjobës së papaguar**

### **Neni 41**

Gjobjën të cilën personi i dënuar fizik, ndërmarrësi apo personi përgjegjës në personin juridik nuk e paguan (në tërësi apo pjesërisht), gjykata mund ta zëvendësojë me dënim me burg ashtu që për çdo 1.000 dinarët e filluar cakton një ditë burgim, ashtu që dënimi me burgim të mos zgjasë më pak se një ditë e as më gjatë se gjashtëdhjetë ditë.

Nëse përveç gjobës personit të dënuar i është kumtuar edhe dënimi me burgim, burgimi me të cilin zëvendësohet gjoba e papaguar dhe dënim me burg nuk mund të zgjasin më shumë se nëntëdhjetë ditë.

Nëse gjykata e vlerëson të arsyeshme, duke marrë parasysh seriozitetin e kundërvajtjes, lartësinë e gjobës së papaguar dhe mundësitë pronësore të të gjykuarit gjykata mundet, në vend të dënimit me burg, të caktojë që gjoba e papaguar të zëvendësohet me punë të interesit publik, ashtu që tetë orë të punës zëvendësohen me një ditë burgim, gjegjësisht 1.000 dinarë gjobë, kurse puna nuk mund të zgjasë më shumë se 360 orë.

Pjesa e gjobës e cila nuk ka mundur të zëvendësohet me dënim me burg apo punë të interesit publik, paguhet në mënyrë të detyruar.

Nëse pas vendimit të gjykatës mbi zëvendësimin e gjobës së papaguar personi fizik i dënuar e paguan gjobjën, dënimi me burg apo puna e interesit publik nuk do të zbatohet. Nëse ka filluar mbajtja e dënimit, kurse personi i dënuar e paguan gjobjën e mbetur, mbajtja e dënimit me burg dhe puna e interesit publik ndërpriten.

Zëvendësimi i dënimit me gjobë me dënim me burg nuk mund të caktohet për dënimet me gjobë ndaj të miturve dhe personave juridik.

Dënimi me gjobë i papaguar i shqiptuar ndaj të miturit do të paguhet detyrimisht në pronë të të miturit, prindit të tij apo personit tjetër përgjegjës që të kujdeset për atë.

Në zëvendësimin e gjobës së papaguar paralelisht aplikohen dispozitat e ligjit i cili rregullon ekzekutimin e sanksioneve penale.

## **Llogaritja e dënimit**

### **Neni 42**

Dënimi për kundërvajtje llogaritet në kufijtë të cilat janë caktuar për atë kundërvajtje, dhe gjatë kësaj merren parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë që dënimi të jetë më i madh apo më i vogël, dhe sidomos: pesha dhe pasojat e kundërvajtjes, rrethanat nën të cilat është kryer kundërvajtja, shkalla e përgjegjësisë së kryesor, gjykimi i mëhershëm, rastet personale të kundërvajtësit dhe mbajtja e vepruesit pas kundërvajtjes së kryer.

Nuk mund të merret parasysh si rrethanë e rëndë sanksioni i shqiptuar kundërvajtësit më herët nëse nga dita e aktgjykimit të marrë deri në ditën e atij të riut kanë kaluar më shumë se katër vite.

Gjatë caktimit të lartësisë së gjobës do të merret parasysh edhe gjendja pronësore e kundërvajtësit.

### **Lehtësimi i dënimit**

#### **Neni 43**

Nëse gjatë llogaritjes së dënimit vërtetohet se me kundërvajtje nuk janë shkaktuar pasoja të rënda, dhe ekzistojnë rrethana lehtësuese të cilat tregojnë se edhe me anë të dënimit më të lehtë arrihet qëllimi i dënimit, dënimi i caktuar mund të lehtësohet ashtu që mund të:

- 1) shqiptohet dënimi nën masën më të ulët të dënimit e cila është caktuar për atë kundërvajtje por jo nën masën më të ulët ligjore të atij lloji të dënimit;
- 2) në vend të dënimit të caktuar me burgim të shqiptohet dënimi me gjobë apo puna në interes të publikut, por jo nën masën më të ulët ligjore të atij lloji të dënimit;
- 3) në vend të dënimit të caktuar me burgim dhe dënimit me gjobë të caktohet vetëm njëra nga ato dënime.

### **Lirimi nga dënimi**

#### **Neni 44**

Gjykata mund ta shpallë kundërvajtësin përgjegjës dhe ta lirojë nga dënimi nën kushtet nga neni 13 dhe 14 i këtij ligji.

Gjykata mund ta lirojë nga dënimi dhe kundërvajtësin për të cilin është caktuar dënimi me gjobë nëse pas kundërvajtjes së kryer, dhe para se të informohet se është dënuar, i heq pasojat e veprës apo kompenson dëmin e shkaktuar përmes kundërvajtjes.

Gjykata mund të lirojë nga dënimi edhe kryesin e kundërvajtjes së bërë me qëllim kur pasojat e veprës e goditin aq rëndë kryesin sa që shqiptimi i dënimit në atë rast qartë nuk do t'i përgjigjej qëllimit të dënimit.

### **Përputhja e kundërvajtjeve**

#### **Neni 45**

Nëse kryesi me një vepër apo më shumë vepra ka kryer më shumë kundërvajtje për të cilat i gjykohet në të njëjtën kohë, paraprakisht do të caktohet dënimi për secilën nga ato kundërvajtje, pastaj për të gjitha ato kundërvajtje do të shqiptohet një dënim i vetëm.

Dënimi i vetëm do të shqiptohet sipas rregullave në vijim:

- 1) Nëse për të gjitha kundërvajtjet në bashkëveprim është caktuar dënimi me burgim, do të shqiptohet dënimi i vetëm me burgim, i cili nuk mund të jetë më i lartë se nëntëdhjetë ditë;
- 2) Nëse për të gjitha kundërvajtjet në bashkëveprim është caktuar dënimi me gjobë, do të shqiptohet një dënim me gjobë i cili paraqet bashkësinë e dënimeve të caktuara me gjobë, ashtu që dënimi i vetëm me gjobë nuk mund të jetë më i lartë se shuma e dyfishtë e gjobës më të madhe të paraparë me anë të këtij ligji;
- 3) Nëse për të gjitha kundërvajtjet në bashkëveprim është caktuar dënimi me punë të interesit publik, do të shqiptohet një dënim me punë të interesit publik i cili nuk do të zgjasë më shumë se 360 orë;
- 4) Nëse për kundërvajtjet në bashkëveprim është caktuar dënimi me burgim, kurse për kundërvajtjet tjera dënim me gjobë, do të shqiptohet një dënim i vetëm me burgim dhe një dënim me gjobë në mënyrën e paraparë në pikën 1) dhe 2) të këtij paragrafi.

### **Kundërvajtja në kohëzgjatje të zgjatur**

#### **Neni 46**

Kundërvajtja në kohëzgjatje të zgjatur ekziston nëse vepruesi me të njëjtin paramendim kryen më shumë kundërvajtje të njëjta të lidhura në aspektin kohor, të cilat përbëjnë një tërësi për shkak të së paku dy nga rrethanat vijuese: ngjashmërisë së subjektit të lënduar, njëllojshmërisë së kundërvajtjes, shfrytëzimit të situatës së njëjtë apo raportit të përhershëm, vendit apo hapësirës së njëjtë të kryerjes së kundërvajtjes.

Dispozita e paragrafit 1 të këtij neni mund të aplikohet vetëm të kundërvajtjet natyra e të cilave lejon bashkimin në një tërësi.

Kundërvajtja me të cilën i shkaktohet dëm të mirave jo materiale ligjore të personit fizik apo juridik mund të bëhet në kohëzgjatje të zgjatur vetëm nëse është bërë kundër personit të njëjtë.

Kundërvajtja e cila nuk është përfshirë me kundërvajtjen në kohëzgjatjen e zgjatur në vendimin e prerë të gjyqit, paraqet kundërvajtje të posaçme, gjegjësisht hyn në përbërjen e kundërvajtjes së posaçme në kohëzgjatje të zgjatur.

Për kundërvajtjen nga paragrafi 1 i këtij ligji mund të shqiptohet dënimi më i rëndë nga ai i paraparë, por ai nuk guxon të kalojë masën e dyfishtë të dënimit të caktuar, dhe as masën më të lartë të dënimit të paraparë me nenin 45, paragrafi 2 i këtij ligji për llogaritjen e dënimeve për kundërvajtjet e kryera në bashkëveprim.

### **Llogaritja e mbajtjes në dënim**

#### **Neni 47**

Koha gjatë së cilës kundërvajtësi është mbajtur para marrjes së aktgjykimit llogaritet në dënimin e shqiptuar.

Mbajtja e cila ka zgjatur më shumë se 12, dhe më pak se 24 orë llogaritet në një ditë burgimi, gjegjësisht si 1.000 dinarë të dënimit me gjobë, gjegjësisht tetë orë punë të interesit publik.

## ***2. Dënimet me pikë***

### **Neni 48**

Për kundërvajtjet kundër sigurisë së komunikacionit në rrugë, me ligj mund të caktohen dënime me pikë në proporcionin prej 1 deri 25.

Sanksionet nga paragrafi 1 i këtij neni shqiptohen me dënimin apo vërejtjen nën kushtet e parapara me këtë ligj nëse me ligjet tjera nuk është rregulluar ndryshe.

Me sanksionin nga paragrafi 1 i këtij ligji kryesit mund t'i shqiptohen obligime plotësuese me qëllim të edukimit të vozitësit apo ndjekjes së sjelljes së tij në komunikacion. Llojet e obligimeve plotësuese dhe kushtet për shqiptimin e tyre rregullohen me ligj të posaçëm.

Dënimet me pikë mund t'i shqiptohen vozitësit i cili në kohën e kryerjes së kundërvajtjes posedon leje për vozitje të dhënë në Republikën e Serbisë apo vozitësit të cilit me anë të vendimit të prerë i është ndaluar drejtimi i automjetit.

## **Aprovimi i dënimeve me pikë**

### **Neni 49**

Nëse për kundërvajtjet në aprovim janë caktuar dënime me pikë, do të shqiptohet një dënim me pikë, i cili i përgjigjet bashkësisë së të gjitha dënimeve të caktuara me pikë, të cilat nuk mund të jenë më të mëdha se 25 pikë.

## ***3. Vërejtja***

### **Neni 50**

Në vend të dënimit me gjobë për kundërvajtje mund të shqiptohet vërejtja nëse ekzistojnë rrethanat të cilat në masë të madhe zvogëlojnë përgjegjësinë e kryesit, ashtu që mund të pritët që në të ardhmen do t'i shmanget kundërvajtjes edhe pa shqiptimin e dënimit.

Vërejtja mund të shqiptohet edhe nëse kundërvajtja ka të bëjë me mospërbushjen e obligimit të caktuar apo nëse përmes kundërvajtjes është shkaktuar dëm, kurse kryesi pas fillimit të procedurës, kurse para marrjes së aktvendimit, ka plotësuar obligimin e caktuar, gjegjësisht ka eliminuar apo kompensuar dëmin e shkaktuar.

## ***4. Masat mbrojtëse***

### **Qëllimit dhe rregullimi**

### **Neni 51**

Në kuadër të qëllimit të përgjithshëm të sanksioneve kundërvajtëse (neni 5, paragrafi 2), qëllimi i aplikimit të masës mbrojtëse është që të eliminojë kushtet të cilat mundësojnë apo nxisin kryesin që të kryejë kundërvajtje të re.

Masa mbrojtëse mund të rregullohet me ligj apo rregullore.

## **Llojet e masave mbrojtëse**

### **Neni 52**

Për kundërvajtje mund të rregullohen masat mbrojtëse vijuese:

- 1) marrja e objektit;
- 2) ndalimi i kryerjes së veprimtarive të caktuara;
- 3) ndalimi i personit juridik që të kryejë veprimtari të caktuara;
- 4) ndalimi i personit përgjegjës që të kryejë punë të caktuara;
- 5) ndalimi i drejtimit me automjet;
- 6) mjekimi i detyrueshëm i të varurit nga alkooli dhe substancat psikoaktive;
- 7) mjekimi psikiatrik i detyrueshëm;
- 8) ndalimi i qasjes së objekteve të dëmtuara apo vendeve ku është kryer kundërvajtja;
- 9) ndalimi i pjesëmarrjes në shfaqje të caktuara sportive;
- 10) shpallja publike e aktgjykimit;
- 11) largimi i të huajit nga territori i Republikës së Serbisë;
- 12) marrja e kafshëve dhe ndalimi i ruajtjes së kafshëve.

Masat mbrojtëse të marrjes së subjektit, mjekimit të detyrueshëm të të varurve nga alkool dhe substancat tjera psikoaktive, mjekimi i detyrueshëm psikiatrik, ndalimi i qasjes së objekteve të dëmtuara apo vendit të kryerjes së kundërvajtjes dhe largimi i një të huaji nga territori i Republikës së Serbisë mund të shqiptohet nën kushtet e rregulluara me anë të këtij ligji edhe kur nuk janë paraparë me rregullën me të cilën është caktuar kundërvajtja.

Masat mbrojtëse të ndalimit të kryerjes së veprimtarive të caktuara dhe shpallja publike e aktgjykimit nuk mund t'i shqiptohen të miturit.

## **Shqiptimi i masave mbrojtëse**

### **Neni 53**

Kur ekzistojnë kushtet për shqiptimin e masave mbrojtëse të parapara me këtë apo me një ligj tjetër, kryesit të kundërvajtjes mund t'i shqiptohet një apo më shumë masa mbrojtëse.

Masat mbrojtëse shqiptohen me dënimin e shqiptuar, vërejtjen apo masën edukative.

Me përjashtim të paragrafit 2, të këtij neni masat mbrojtëse mund të shqiptohen pavarësisht nëse është rregulluar ajo mundësi.

## **Marrja e objektit**

### **Neni 54**

Objektet të cilat janë përdorur apo ishin të dedikuara për kryerjen e kundërvajtjes apo të cilat janë paraqitur me kryerjen e kundërvajtjes mund të merren nga kundërvajtësi.

Gjykata e cila ka marrë aktgjykimin do të caktojë, në pajtim me rregullat e posaçme, se a do të shkatërrohen objektet e marra, të shiten apo t'i dorëzohen organit të interesuar, gjegjësisht organizatës.

Nëse kryesi vullnetarisht i ka larguar apo shkatërruar objektet apo në mënyrë tjetër ka mundësuar marrjen e tyre, në aktvendim do të caktohet që të paguajë shumën e parave e cila i përgjigjet vlerës së objektit.

Me anë të rregullës me të cilën caktohet kundërvajtja mund të parashihet shqiptimi i detyrueshëm i masës mbrojtëse të marrjes së objektit.

Objektet nga paragrafi 1 i këtij neni mund të merren edhe atëherë kur procedura kundërvajtëse nuk përfundon më aktgjykimin me të cilin fajtori shpallet përgjegjës nëse atë e kërkojnë interesat e sigurisë së përgjithshme apo arsyet e moralit sikur edhe rastet tjera të caktuara me ligj të posaçëm. Mbi këtë merret vendim i posaçëm në të cilin fajtori ka të drejtë të ankohet.

Me marrjen e objektit nuk preket e drejta e palëve të treta për kompensim nga kryesi.

## **Ndalimi i kryerjes së veprimtarive të caktuara**

### **Neni 55**

Ndalimi i kryerjes së veprimtarive të caktuara përbëhet nga ndalesa e përkohshme kryesit që të kryejë veprimtari të caktuar tregtare apo tjetër për të cilën lëshohet leja a organit kompetent apo e cila shënohet në regjistrin adekuat.

Nëse me anë të rregullës e cila cakton kundërvajtjen nuk janë paraparë kushte të caktuara për shqiptimin e masës mbrojtëse nga paragrafi 1 i këtij neni, masa mund të shqiptohet nëse kundërvajtësi e keqpërdorë veprimtarinë për kryerjen e kundërvajtjes apo nëse në mënyrë të arsyetuar mund të pritet që kryerja e mëtejshme e asaj veprimtarie do të ishte me rrezik për jetën apo shëndetin e njerëzve apo interesave tjera të mbrojtura me ligj.

Ndalimi i kryerjes së veprimtarisë së caktuar mund të shqiptohet në kohëzgjatje prej gjashtë muajve deri në tri vite, duke llogaritur nga dita e dhënies së aktvendimit.

Koha e kaluar në mbajtjen e dënimit me burg nuk llogaritet në kohëzgjatjen e masës së shqiptuar.

## **Ndalesa personit juridik që të kryejë veprimtari të caktuara**

### **Neni 56**



Ndalesa personit juridik që të kryejë veprimtari të caktuara përbëhet nga ndalesa e prodhimit të prodhimeve të caktuara apo kryerja e punëve të caktuara në fushën e qarkullimit të mallrave, financave dhe shërbimeve, apo në ndalesën e kryerjes së punëve tjera të caktuara.

Nëse me anë të rregullës me të cilën caktohet kundërvajtja nuk janë paraparë veçmas kushtet për shqiptimin e masës mbrojtëse, masa mund të shqiptohet nëse kryerja e mëtejshme e veprimtarisë së caktuar do të ishte e rrezikshme për jetën apo shëndetin e njerëzve, e dëmshme për ekonominë apo biznesin e personave tjerë juridik apo tregtinë në tërësi.

Ndalesa personit juridik që të kryejë veprimtari të caktuar mund t'i shqiptohet në kohëzgjatje prej gjashtë muajve deri tri vite, duke e llogaritur nga dita e zbatimit të aktgjykimit.

### **Ndalesa personit përgjegjës që të kryejë punë të caktuara**

#### **Neni 57**

Ndalesa personit përgjegjës që të kryejë punë të caktuara përbëhet nga ndalesa e kundërvajtësit që të kryejë punët të cilat i kryente në kohën e kundërvajtjes apo detyrën udhëheqëse në tregti apo biznes apo llojin e caktuar të punëve, të gjitha apo disa detyra të lidhura me deponimin, shfrytëzimin, drejtimin apo menaxhimin e pronës së besuar.

Nëse me anë të rregullës me të cilën caktohet kundërvajtja nuk është caktuar ndryshe, ndalesa personit përgjegjës që të kryejë punë të caktuara i shqiptohet kur personi përgjegjës të keqpërdorë detyrën me qëllim të kryerjes së kundërvajtjes.

Ndalesa personit përgjegjës që të kryejë punë të caktuara mund t'i shqiptohet në kohëzgjatje prej gjashtë muajve deri në tri vite, duke u llogaritur nga dita e zbatimit të aktgjykimit.

Koha e kaluar në mbajtjen e dënimit me burgim nuk llogaritet në kohëzgjatjen e masës së shqiptuar.

### **Ndalesa e drejtimit të automjetit**

#### **Neni 58**

Ndalesa e drejtimit të automjetit përbëhet nga ajo që kryesit përkohësisht t'i ndalohet drejtimi i automjetit të llojit apo kategorisë së caktuar.

Nëse me anë të rregullës me të cilën caktohet kundërvajtja nuk janë paraparë veçmas kushtet oër shqiptimin e masës mbrojtëse, masa mund t'i shqiptohet kundërvajtësit i cili e ka kryer kundërvajtjen kundër sigurisë së komunikacionit kur ekziston rreziku që duke drejtuar automjetin përsëri do të kryejë kundërvajtje apo për arsye se shkelja e mëhershme e atyre rregullave tregon se është e rrezikshme që të drejtoje automjetin e llojit apo kategorisë së caktuar.

Masa mbrojtëse nga paragrafi 1 i këtij neni mund të shqiptohet në kohëzgjatje prej 30 ditëve deri në një vit.

Koha e kaluar në mbajtjen e dënimit me burgim nuk llogaritet në periudhën e masës.

### **Mjekimi i detyrueshëm i të varurve nga alkooli dhe substancave psikoaktive**

## **Neni 59**

Mjekimi i detyrueshëm i të varurve nga alkooli dhe substancat psikoaktive mund t'i shqiptohet personit i cili ka kryer kundërvajtje gjatë varësisë nga përdorimi i vazhdueshëm i alkoolit apo substancave psikoaktive dhe tek të cilët ekziston rreziku që gjatë kësaj varësie edhe më tej do të kryejë kundërvajtje.

Para shqiptimit të masës nga paragrafi 1 i këtij neni gjykata do të marrë mendimin e ekspertit, gjegjësisht organizatës shëndetësore kompetente.

Gjatë shqiptimit të masës nga paragrafi 1 i këtij neni kundërvajtësit do t'i urdhërohet mjekimi i detyrueshëm në entin shëndetësor adekuat apo ent tjetër të specializuar. Nëse kundërvajtësi pa arsye refuzon mjekimin, masa do të zbatohet në mënyrë të detyrueshme.

Masa mbrojtëse nga paragrafi 1 i këtij neni më së gjati mund të zgjasë deri në një vit, kurse ekzekutimi i masës do të ndalet edhe para skadimit të kohës së caktuar në aktgjykim nëse organizata shëndetësore vendosë që mjekimi është kryer.

## **Mjekimi i detyrueshëm psikiatrik**

### **Neni 60**

Kundërvajtësi i cili në gjendje të paaftë ka kryer kundërvajtje, gjykata do t'i shqiptojë mjekim psikiatrik të detyrueshëm, nëse vërteton se ekziston rreziku serioz që kryesi ta përsërisë kundërvajtjen, kurse për ta hequr rrezikun duhet të mjekim psikiatrik i tij.

Mjekimi psikiatrik i detyrueshëm është sanksioni i vetëm kundërvajtës i cili në mënyrë të pavarur mund t'i shqiptohet kundërvajtësit të paaftë.

Nën kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni gjykata mund t'i shqiptojë mjekim psikiatrik të detyrueshëm kundërvajtësit aftësia mendore e të cilit është zvogëluar dukshëm, nëse i është dhënë dënimi me gjobë, puna e interesit publik, vërejtja apo është liruar nga dënimi.

Mjekimi i detyrueshëm psikiatrik realizohet në liri dhe zgjarë deri sa ekziston nevoja për mjekim, por jo më shumë se një vit.

Me qëllim të mjekimit më të suksesshëm mund të caktohet që nganjëherë mjekimi të realizohet në entin shëndetësor por mjekimi i pandërprerë në ent nuk mund të zgjasë më shumë se 15 ditë, dhe mund të ndërmerret dy herë gjatë vitit.

Nëse në rastin nga paragrafi 1 dhe 3 i këtij neni kryesi nuk i nënshtrohet mjekimit në liri apo largohet vullnetarisht nga ai, gjykata mund të caktojë që masa mbrojtëse të realizohet në entin shëndetësor nën kushtet nga paragrafi 4 i këtij neni.

## **Ndalesa e qasjes në objektet apo vendin e dëmtuar të kundërvajtjes**

### **Neni 61**

Ndalesa e qasjes në objektet dhe vendet e dëmtuara të kundërvajtjes shqiptohet me qëllim të pengimit të kryesit që të përsërisë kundërvajtjen apo të vazhdojë të kërcënojë të dëmtuarin.

Masa nga parag 1 i këtij neni shqiptohet në propozimin me shkrim të kërkesëbërësit për inicimin e procedurës kundërvajtëse apo në kërkesën gojore të të dëmtuarit, të theksuar gjatë dëgjimit në procedurën kundërvajtëse.

Vendimi i gjykatës me të cilin është shqiptuar ndalesa e qasjes duhet të përmbajë: periudhën kohore në të cilën ekzekutohet, të dhënat mbi personat të cilëve kryesi nuk mund t'i qaset, shënimi i objekteve të cilëve nuk guxon t'i qaset dhe në cilën kohë, vend apo lokacion në kuadër të së cilëve kryesit i ndalohet qasja.

Masa e shqiptuar e ndalimit të qasjes së të dëmtuarit përfshinë edhe masën e ndalesës së qasjes në banesën apo shtëpinë e përbashkët në periudhën për të cilën vlen ndalesa.

Masa mbrojtëse e ndalesës së qasjes mund të shqiptohet në kohëzgjatjen deri në një vit, duke llogaritur nga ekzekutimi i aktgjykimit.

Mbi vendimin e gjykatës me të cilin shqiptohet ndalesa e qasjes informohet i dëmtuari, administrata policore kompetente për zbatimin e masës dhe organi kompetent i kujdestarisë nëse masa ka të bëjë me ndalimin e qasjes së fëmijëve, bashkëshortit apo anëtarëve të familjes.

### **Thyerja e ndalesës së qasjes tek i dëmtuari, objektet apo vendi i kundërvajtjes**

#### **Neni 62**

Të dënuarit të cilit me anë të aktgjykimit të prerë i është shqiptuar masa e ndalesës së qasjes, dhe i cili i qaset të dëmtuarit, objekteve apo vendit të kundërvajtjes gjatë kohëzgjatjes së masës apo realizon kontakt me të dëmtuarin në mënyrë të palejueshme apo në kohë të palejueshme do t'i shqiptohet sanksioni sipas rregullës me të cilën është paraparë kundërvajtja për të cilën është shqiptuar kjo masë.

### **Ndalesa e pjesëmarrjes në shfaqje të caktuara sportive**

#### **Neni 63**

Ndalimi i pjesëmarrjes në shfaqje të caktuara sportive përbëhet nga obligimi i kundërvajtësit që menjëherë para fillimit të kohës së mbajtjes së shfaqjeve të caktuara sportive personalisht të paraqiten tek personi zyrtar në administratën policore të rajonit, gjegjësisht stacionit policor në territorin në të cilin gjendet kundërvajtësi dhe të qëndrojnë në hapësirat e tyre gjatë kohës së mbajtjes së ngjarjes sportive.

Masa mbrojtëse nga paragrafi 1 i këtij neni mund të shqiptohet në kohëzgjatjen prej një deri në tetë vite.

Koha e kaluar në vuajtjen e dënimit me burgim nuk llogaritet në kohëzgjatjen e masës.

I dënuari të cilit me aktgjykimtë prerë i është shqiptuar masa e ndalimit të pjesëmarrjes në ngjarje të caktuara sportive, dhe i cili nuk kryen obligimin nga paragrafi 1 i këtij neni, do të dënohet me burgim prej tridhjetë deri në gjashtëdhjetë ditë.

Mbi masën mbrojtëse të shqiptuar nga paragrafi 1 i këtij neni, gjykata është e detyruar që të informojë administratën policore të rajonit sipas vendbanimit të personit të dënuar.

Me anë të rregullës e cila cakton kundërvajtjen mund të parashihet shqiptimi i detyrueshëm i masës mbrojtëse të ndalimit të pjesëmarrjes ngjarjeve të caktuara sportive.

## **Shpallja publike e aktgjykimit**

### **Neni 64**

Masën mbrojtëse të shpalljes së aktgjykimit gjykata do ta shqiptojë nëse mendon se do të ishte e dobishme që publiku të informohet për aktgjykimin, sidomos nëse publikimi i aktgjykimit do të kontribuonte që të eliminohet rreziku për jetën apo shëndetin e njerëzve apo të mbrohet siguria e mallrave dhe shërbimeve apo tregtia.

Sipas rëndësisë së kundërvajtjes gjykata vendosë se a do ta shpallë aktgjykimin përmes shtypit, radios apo televizionit apo përmes disa mjeteve të cekura të informimit, si dhe a do ta shpallet aktgjykimi në tërësi apo në ekstrakte, duke u kujdesur gjatë kësaj që mënyra e shpalljes së mundësojë informimin e gjithë atyre në interesin e të cilëve është shpallja e aktgjykimit.

Aktgjykimi mund të shpallet brenda afatit më së gjati 30 ditor nga dita e hyrjes në fuqi të aktgjykimit.

Me rregullën e cila cakton kundërvajtjen mund të parashihet shqiptimi i detyrueshëm i masës mbrojtëse të shpalles publike të aktgjykimit.

Shpenzimet e shpalljes publike të aktgjykimit bien në barrën e të dënuarit.

## **Largimi i të huajit nga territori i Republikës së Serbisë**

### **Neni 65**

Largimi i të huajit nga territori i Republikës së Serbisë mund t'i shqiptohet një të huaji i cili ka kryer kundërvajtje për shkak të së cilës qëndrimi i mëtejshëm i tij në vend është i padëshirueshëm.

Masa mbrojtëse nga paragrafi 1 i këtij neni mund të shqiptohet në kohëzgjatje prej gjashtë muaj deri pesë vjet.

Kohëzgjatja e masës së shqiptuar rrjedh nga dita e hyrjes në fuqi të aktgjykimit, kurse koha e kaluar në vuajtjen e dënimit me burgim nuk llogaritet në kohëzgjatjen e masës.

Me ligj të posaçëm mund të rregullohen kushtet nën të cilat në kohë të caktuar të shtyhet zbatimi i masës mbrojtëse nga paragrafi 1 i këtij neni.

## **Marrja e kafshëve dhe ndalimi i ruajtjes së kafshëve**

### **Neni 66**

Marrja e kafshëve nga pronari apo ruajtësi i cili është shpallur përgjegjës për kundërvajtje nga fusha e mbrojtjes së mirëqenies së kafshëve shqiptohet me qëllim të pengimit të kryesit që ta përsërisë kundërvajtjen, gjegjësisht në mënyrë tjetër të vazhdojë të kërcënojë mirëqenien e kafshëve.

Gjykata e cila ka marrë aktgjykimin do të caktojë në pajtim me rregullat e posaçme se a do t'i dorëzohet kafsha e marrë qendrës kompetente të pranimit të kafshëve apo organizatës së interesuar.

Me rregulloren e cila cakton kundërvajtjen mund të parashihet shqiptimi i obligueshëm i masës mbrojtëse të marrjes së kafshës.

Ndalimi i ruajtjes së një, më shumë, apo të gjitha llojeve të kafshëve personit i cili është shpallur përgjegjës për kundërvajtje nga fusha e mbrojtjes së mirëqenies së kafshëve shqiptohet me qëllim të pengimit të kryesit që ta përsërisë kundërvajtjen, gjegjësisht në mënyrë tjetër të vazhdojë të kërcënojë mirëqenien e kafshëve.

Kjo masë mund të shqiptohet në kohëzgjatje prej një deri në tri vite duke llogaritur nga zbatimi i aktgjykimit.

Personit të cilit me anë të aktgjykimit i është shqiptuar masa mbrojtëse e ndalimit të ruajtjes së kafshëve, dhe i cili vepron në kundërshtim me ndalesën nga paragrafi 1 i këtij neni, do t'i shqiptohet sanksioni sipas rregullës me të cilën është paraparë kundërvajtja për të cilën është shqiptuar kjo masë.

Me anë të rregullës me të cilën rregullohet kundërvajtja mund të parashihet shqiptimi i detyrueshëm i ndalimit të ruajtjes së të gjitha, gjegjësisht disa llojeve të kafshëve si masë mbrojtëse e përhershme.

### **Përputhja e masave mbrojtëse**

#### **Neni 67**

Nëse me anë të një aktgjykimi për disa kundërvajtje janë caktuar më shumë masa mbrojtëse të llojit të njëjtë për të cilat është caktuar se do të shqiptohen në kohëzgjatje të caktuara, do të shqiptohet një masë mbrojtëse e vetme e cila është e barabartë me bashkësinë e kohëzgjatjes së masave mbrojtëse të caktuara në mënyrë individuale, në atë mënyrë që ajo nuk mund të kalojë kufirin më të lartë ligjor të kohëzgjatjes së atij lloji të masës mbrojtëse.

#### **Kreu V**

### **KONFISKIMI I DOBISË PRONËSORE TË ARRITUR ME ANË TË KUNDËRVAJTJES**

#### **Baza e konfiskimit të dobisë pronësor**

#### **Neni 68**

Askush nuk mund të mbajë fitimin pronësor të arritur përmes kundërvajtjes.

Fitimi nga paragrafi 1 i këtij neni konfiskohet me anë të aktvendimit me të cilin janë vërtetuar kundërvajtja dhe përgjegjësia për të, nën kushtet e caktuara me këtë ligj.

#### **Mënyra e konfiskimit të dobisë pronësore**

#### **Neni 69**

Nga kundërvajtësi do të konfiskohen paratë, letrat me vlerë, gjërat me vlerë si dhe çdo dobi tjetër pronësore e cili është fituar përmes kundërvajtjes. Nëse ai konfiskim nuk është i mundur, kryesi do të jetë i detyruar që të paguajë shumën e parave e cila i përgjigjet dobisë pronësore të arritur.

Nëse i akuzuari në kohë të caktuar nuk e paguan shumën e parave nga paragrafi 1 i këtij neni, pagesa do të kryhet në mënyrë të detyrueshme.

Dobia pronësore e arritur përmes kundërvajtjes mund të konfiskohet nga personi tek i cili është bartur pa kompenzim apo me kompenzimin i cili nuk i përgjigjet vlerës reale.

## **Mbrojtja e të dëmtuarit**

### **Neni 70**

Nëse të dëmtuarit në procedurën kundërvajtëse i është dhënë kërkesa pronësoro-juridike, konfiskimi i dobisë pronësore do të shqiptohet vetëm nëse ai fitim nuk kalon kërkesën e dhënë pronësoro-juridike të të dëmtuarit.

## **Kreu VI DISPOZITAT MBI TË MITURIT**

### **Përgjegjësia e të miturve për kundërvajtje**

#### **Neni 71**

Ndaj të miturit i cili në kohën e kryerjes së kundërvajtjes nuk i kishte të mbushura katërmbëdhjetë vjet (fëmijë) nuk mund të zhvillohet procedurë kundërvajtëse.

Tek të miturin e moshës prej katërmbëdhjetë vjet të mbushura deri në tetëmbëdhjetë vjet të mbushura të cilët kryejnë kundërvajtje, aplikohen dispozitat e këtij kreu, kurse dispozitat tjera të këtij ligji vetëm nëse nuk janë në kundërshtim me këto dispozita.

### **Përgjegjësia e prindërve, adoptuesve, kujdestarëve apo strehuesve të fëmijëve dhe të miturve**

#### **Neni 72**

Kur fëmija kryen kundërvajtje për shkak të moskujdesit të prindërve, adoptuesve, kujdestarëve, gjegjësisht strehuesve, kurse këta persona kishin mundësi të bënin mbikqyrjen, prindërit, adoptuesit, kujdestarët gjegjësisht strehuesit e fëmijës do të dënohen për kundërvajtje njëjtë sikur ta kishin kryer vetë.

Me ligj është paraparë që për kundërvajtjen e kryer nga ana e të miturit të përgjigjen edhe prindërit, adoptuesit, kujdestarët gjegjësisht strehuesi i të miturit të moshës prej katërmbëdhjetë vjet të mbushura deri tetëmbëdhjetë vjet të mbushura nëse kundërvajtja e kryer është pasojë e moskujdesit ndaj të miturit, kurse kishin mundësi të ta mbikqyrnin.

Përveç prindërve, adoptuesve, kujdestarëve apo strehuesve, me ligj mund të rregullohet që për kundërvajtjen e të miturit të përgjigjen edhe personat tjerë për të cilët është ka kryer kundërvajtje.

### **Sanksionet kundërvajtëse ndaj të miturve**

### **Neni 73**

Tek të miturit i cili në kohën e kundërvajtjes i ka pasur të mbushura katërbëdhjetë vjet, por nuk i ka pasur të mbushura gjashtëmbëdhjetë (i mitur më i ri) mund t'i shqiptohen vetëm masa edukative.

Tek të miturit i cili në kohën e kryerjes së kundërvajtjes i ka të mbushura gjashtëmbëdhjetë vjet, kurse nuk i ka të mbushura tetëmbëdhjetë vjet (i mitur më i vjetër) mund t'i shqiptohet masa edukative, dënim me pikë apo dënim.

Nëse për shkak të natyrës së kundërvajtjes është e domosdoshme, masa mbrojtëse mund t'i shqiptohet të miturit me masën edukative apo dënimin.

Vet gjykata mund t'i shqiptojë të miturit masë edukative, dënim me gjobë, dënim me pikë, dënime me burgim për të mitur dhe masë mbrojtëse.

### **Llojet e masave edukative**

#### **Neni 74**

Të miturve mund t'i shqiptohen këto masa edukative:

- 1) Masat e paralajmërimit dhe udhëzimit: qortimi dhe obligimet e posaçme;
- 2) Masat e mbikqyrjes së përforcuar.

Masat e paralajmërimit dhe udhëzimit shqiptohen kur me ato masa duhet të ndikohet në personalitetin e të miturit dhe sjelljen e tij edhe kur ato janë të mjaftueshme që të arrihet qëllimi i këtyre masave.

Masat e mbikqyrjes së përforcuar shqiptohen kur për edukimin dhe zhvillimin e të miturve duhet ndërmarrë masa edukative më të përhershme me mbikqyrje dhe ndihmë profesionale adekuate.

#### **Qortimi**

#### **Neni 75**

Qortimi i shqiptohet të miturit ndaj të cilit nuk është e nevojshme që të ndërmerren masa edukative më të përhershme, dhe sidomos kur nga raporti i tij ndaj kundërvajtjes së kryer dhe gadishmërisë që në të ardhmen të mos kryhen kundërvajtje mund të konkludohet se me masën edukative të shqiptuar do të arrihet qëllimi i kësaj mase.

Me rastin e shqiptimit të qortimit të miturit do t'i tregohet për mospranimin shoqëror të veprimit të tij dhe nëse përsëri kryen kundërvajtje, mundësinë e shqiptimit edhe të masës edukative tjetër.

#### **Obligimet e posaçme**

#### **Neni 76**

Nëse gjykata vlerëson se me kërkesa dhe ndalesa adekuate është e nevojshme që të ndikohet në të miturin dhe sjelljen e tij, mund t'i caktojë të miturit një apo më shumë obligime të caktuara edhe atë:

- 1) T'i kërkojë falje të dëmtuarit;
- 2) Në kuadër të mundësive të veta, të rregullojë apo të kompenzojë dëmin të cilin e ka shkaktuar;
- 3) Të mos vizitojë vende të caktuara dhe t'i shmaget shoqërisë së personave të caktuar të cilët ndikojnë negativisht tek ai;
- 4) T'i nënshtrohet mjekimit nga varësia nga alkooli apo substancat tjera psikoaktive;
- 5) Me qëllim të mësimit apo testimit të njohurisë mbi rregullat e komunikacionit të drejtohet në entin kompetent për aftësimin e vozitësve;
- 6) Që pa kompenzim të përfshihet në punën e organizatave humanitare apo në punët me rëndësi ekologjike, sociale apo lokale;
- 7) Të përfshihet në punën e seksioneve sportive apo tjera në shkollë nën mbikqyrjen pedagogjike të mësimdhënësve.

Obligimet nga paragrafi 1 pika 2) deri 7) të këtij neni, nuk mund të zgjasin më shumë se gjashtë muaj dhe nuk guxojnë të pengojnë shkollimin e apo punësimin e të miturit.

Në kuadër të obligimeve nga paragrafi 1 pika 2) e këtij neni, gjykata do të caktojë lartësinë, format dhe mënyrën e rregullimit të dëmit, ku puna personale e të miturit në rregullimin e dëmit mund të zgjasë më së shumti deri në 20 orë në periudhën prej një muaji dhe duhet të jetë i radhitur në atë mënyrë që të mos e pengojë shkollimin e rregullt apo punësimin e të miturit.

Gjykata gjatë shqiptimit të obligimeve të caktuara do ta paralajmërojë të miturin se për shkak të mospërmbushjes së obligimeve të caktuara, ato mund t'i zëvendësojnë me obligim tjetër apo masë edukative.

Kryerja e obligimeve të caktuara realizohet nën mbikqyrjen e organit kompetent për punët e kujdestarisë, i cili e informon gjykatën për kryerjen e obligimeve.

### **Masat e mbikqyrjes së përforcuar**

#### **Neni 77**

Masat edukative të mbikqyrjes së përforcuar shqiptohen nëse është e nevojshme që ndaj të miturit të zbatohet masa më e përhershme e edukimit.

Masën e mbikqyrjes së përforcuar nga ana e prindërve, adoptuesve apo kujdestarëve, gjykata do ta shqiptojë nëse prindërit, adoptuesit apo kujdestarët nuk kanë mundur të kryejnë kujdesin dhe mbikqyrjen e të miturit, kurse kanë mundësi që ta kryejnë atë mbikqyrje dhe pritja që ata ta kryejnë atë është e bazuar.

Nëse prindërit, adoptuesi apo kujdestari nuk mund të kryejnë mbikqyrjen e përforcuar mbi të miturin, të miturit do t'i shqiptohet mbikqyrja e përforcuar e organit të kujdestarisë.

Masat e mbikqyrjes së përforcuar nga paragrafi 2 dhe 3 i këtij neni mund të zgjasin më së paku tre muaj, kurse më së shumti një vit.



## **Kushtet për shqiptimin e masave edukative**

### **Neni 78**

Gjatë shqiptimit të masave edukative merren parasysh mosha e të miturit, shkalla e zhvillimit të tij shoqëror, karakteristikat psikike dhe motivet për të cilat ka kryer kundërvajtje, edukimi i deritanishëm, rrethi dhe kushtet në të cilat ka jetuar, pesha e kundërvajtjes, nëse iu është shqiptuar masa edukative më parë, si dhe të gjitha rrethanat tjera të cilat ndikojnë zgjedhjen e masës edukative me të cilën më së miri do të arrihet qëllimi i edukimit.

Me qëllim të vërtetimit të rrethanave nga paragrafi 1 i këtij neni gjykata duhet të dëgjojë prindërit dhe adoptuesin e të miturit, kujdestarin e tij dhe personat tjerë të cilët mund ofrojnë të dhëna të nevojshme.

### **Pezullimi i zbatimit dhe ndryshimi i vendimit mbi masën edukative**

#### **Neni 79**

Kur pas lëshimit të aktgjykimit me të cilin është shqiptuar masa edukative paraqiten rrethana të cilat nuk ishin në kohën e marrjes së vendimit apo nuk ishin të ditura, kurse ato do të ishin me ndikim në marrjen e vendimit, zbatimi i masës së shqiptuar mund të pezullohet apo masa e shqiptuar mund të zëvendësohet me masë tjetër edukative.

### **Vendimi i përsëritur mbi masat edukative**

#### **Neni 80**

Nëse nga hyrja në fuqi e vendimit me të cilin është shqiptuar ndonjëra nga masat edukative apo obligimet e detyruara ka kaluar më shumë se gjashtë muaj, kurse zbatimi nuk ka filluar, gjykata do të vendosë përsëri mbi nevojën që të zbatohet masa e shqiptuar apo obligimi i posaçëm apo të zëvendësohet me ndonjë masë tjetër edukative apo obligim të posaçëm.

Gjykata është e obliguar që të mbajë evidencë të posaçme për secilin të mitur të cilit i është shqiptuar masa edukative.

### **Dënimi i të miturit më të vjetër**

#### **Neni 81**

Të miturit më të vjetër mund t'i shqiptohet dënimi vetëm nëse në kohën kur ka kryer kundërvajtje, sipas zhvillimit të tij shpirtëror ka mund të kuptojë rëndësinë e veprës së vet dhe të menaxhojë me veprimet e veta dhe nëse për shkak të pasojave më të rënda të kundërvajtjes apo shkallës më të lartë të fajit nuk do të ishte e arsyeshme që të aplikohet masa edukative.

Dënimi me burg të të miturve për të miturin më të vjetër mund të shqiptohet me përjashtim ku duhet pasur parasysh natyrën e kundërvajtjes, karakteristikat personale dhe sjelljen e të miturit.

Dënimi me burg të miturve i cili i shqiptohet të miturit më të vjetër nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë.

Kryesit të mitur të kundërvajtjes nuk mund t'i zëvendësohet dënimi i shqiptuar me gjobë me dënim me burg të miturve, por do të paguhet përmes rrugës së detyruar, në pajtim me ligjin.

Gjykata për Kundërvajte është e obliguar që organin e kujdestarisë, përgjegjës sipas vendbanimit të miturit, ta njoftojë mbi masën e shqiptuar edukative apo dënimin për kundërvajtësin e mitur.

### **Shqiptimi i masës edukative apo dënimit për kundërvajtjet në përputhje**

#### **Neni 82**

Nëse i mituri ka kryer më shumë kundërvajtje në përputhje, gjatë zgjedhjes së masave edukative gjykata në mënyrë të bashkuar do të vlerësojë të gjitha kundërvajtjet dhe do të shqiptojë vetëm një masë.

Nëse gjykata për ndonjërin nga kundërvajtjet cakton dënimin, kurse për kundërvajtjet tjera masat edukative, do të shqiptojë vetëm dënim.

Në mënyrën nga paragrafi 2 i këtij neni gjykata do të veprojë nëse pas masës së shqiptuar edukative, gjegjësisht dënimit, vërtetohet se i mituri para apo pas shqiptimit të saj ka kryer kundërvajtje.

### **Efketi i moshës madhore**

#### **Neni 83**

Nëse kundërvajtësi i mitur para ose gjatë procedurës është bërë i moshës madhore, do të aplikohen dispozitat mbi të miturit, përveç dispozitave mbi masat edukative.

Nëse i mituri është bërë i moshës madhore pas marrjes së vendimit me të cilin është shqiptuar masa edukative, pezullohet zbatimi i asaj mase.

## **Kreu VII PARASHKRIMI**

### **Parashkrimi i inicimit dhe zhvillimit të procedurës kundërvajtëse**

#### **Neni 84**

Procedura kundërvajtëse nuk mund të fillohet as të zhvillohet nëse kalon një vit nga dita kur është kryer kundërvajtja.

Parashkrimi i inicimit dhe zhvillimit të procedurës kundërvajtëse nuk rrjedh gjatë kohës në të cilën fillimi dhe zhvillimi i procedurës nuk mund të ndërmerret me ligj.

Parashkrimi ndërpritet me secilën punë procedurale të gjykatës kompetente e cila ndërmerret me qëllim të zhvillimit të procedurës kundërvajtëse.

Pas secilës ndërprerje parashkrimi fillon përsëri.

Me përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni, për kundërvajtje nga fusha e punës doganore, tregtisë së jashtme, devizore, të ardhurat dhe financat publike, prokurimeve publike, qarkullimit të

mallrave dhe shërbimeve, mjedisit jetësor, pengimit të korrupsionit dhe transportit ajror mund të rregullohet me ligj të posaçëm afati më i gjatë i parashkrimit.

Afati nga paragrafi 5 i këtij neni nuk mund të jetë më i gjatë se pesë vjet.

Fillimi dhe udhëheqja e procedurës kundërvajtëse parashkruhet në çdo rast kur kalon dy herë më shumë kohë se sa është kërkuar sipas ligjit për parashkrim.

Dispozitat e paragrafit 1 deri 4 dhe paragrafit 7 të këtij neni aplikohen paralelisht në parashkrimin e fillimit dhe udhëheqjes për lëshimin e urdhërit kundërvajtës.

### **Parashkrimi i zbatimit të dënimit dhe masës mbrojtëse**

#### **Neni 85**

Dënimi dhe masa mbrojtëse e shqiptuar nuk mund të zbatohen nëse nga dita e hyrjes në fuqi të aktvendimit ka kaluar një vit.

Parashkrimi i zbatimit të dënimit dhe masës mbrojtëse fillon nga dita e hyrjes në fuqi të aktvendimit me të cilën është shqiptuar dënimi gjegjësisht masa mbrojtëse.

Parashkrimi i zbatimit të dënimit dhe masës mbrojtëse nuk rrjedh gjatë kohës për të cilën zbatimi nuk mund të ndërmerret sipas ligjit.

Parashkrimi ndërpritet me secilën punë procedurale të organit kompetent e cila ndërmerret me qëllim të zbatimit të dënimit, gjegjësisht masës mbrojtëse.

Pas secilës ndërprerje parashkrimi fillon të rrjedhë përsëri.

Zbatimi i dënimit gjegjësisht masës mbrojtëse parashkruhet në çdo rast kur kalon dy herë po aq kohë sa kërkohet me ligj për zbatimin e dënimit gjegjësisht masës mbrojtëse.

## **Pjesa e dytë PROCEDURA KUNDËRVAJTËSE**

### **Kreu VIII PARIMET KRYESORE TË PROCEDURËS**

#### **Parimi i ligjshmërisë**

#### **Neni 86**

Ky ligj definon rregullat me të cilat sigurohet që askush i pafajshëm të mos dënohet, dhe që kryesit përgjegjës të kundërvajtjes t'i shqiptohet sanksioni kundërvajtës nën kushtet të cilat i parasheh ky ligj dhe në bazë të procedurës së zbatuar sipas ligjit.

#### **Ligjshmëria në shqiptimin e sanksioneve kundërvajtëse**

#### **Neni 87**

Sanksionin kundërvajtës mund ta shqiptojë vetëm gjykata kompetente e cila udhëheq procedurën kundërvajtëse sipas këtij ligji.

Me përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni dënimin me gjobë mund ta shqiptojë:

- 1) komisioni republikan për mbrojtjen e të drejtave në procedurat e prokurimeve publike e cila udhëheq procedurën kundërvajtëse të shkallës së parë në pajtim me ligjin me të cilin rregullohen prokurimet publike;
- 2) organi kompetent, gjegjësisht personi i autorizuar me anë të urdhërit për kundërvajtje në pajtim me ligjin.

### **Parimi akuzues**

#### **Neni 88**

Procedura kundërvajtëse fillohet dhe udhëhiqet në bazë të:

- 1) kërkesës së organit të autorizuar apo të dëmtuarit;
- 2) urdhërit për kundërvajtje, në pajtim me këtë ligj.

### **Dëshmia**

#### **Neni 89**

Provat grumbullohen dhe paraqiten në pajtim me këtë ligj.

Barra e dëshmisë së kundërvajtjes dhe përgjegjësisë kundërvajtëse është në personin që ka bërë kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse.

Gjykata paraqet provat në propozim të palëve.

Pala është e detyruar që të mbledhë prova për paraqitjen e të cilëve ka dhënë propozim.

Me përjashtim, gjykata sipas detyrës zyrtare mund të sigurojë prova nëse i pandehuri nuk është në gjendje që ta bëjë këtë apo kjo është e justifikuar për arsye të dobisë dhe eefikasitetit të udhëheqjes së procedurës.

Gjykata mund të paraqesë prova plotësuese nëse vlerëson se provat e paraqitura janë kontradiktore apo të paqarta dhe se kjo është e domosdoshme që lënda e dëshmisë të diskutohet nga të gjitha anët.

### **Ndihma palës së paditur**

#### **Neni 90**

Gjykata është e detyruar që të kujdeset që mosdija e palëve të mos jetë në dëm të të drejtave të tyre.

### **Ekonomia e procedurës kundërvajtëse**

## **Neni 91**

Gjykata është e detyruar që procedurën ta realizojë pa zvarritje, por ashtu që ajo të mos jetë në dëm të marrjes së vendimit të drejtë dhe të ligjshëm.

## **Vlerësimi i lirë i provave**

### **Neni 92**

Gjykata vlerëson provat sipas bindjes së saj të lirë.

Se cilat fakte do t'i marrë si të dëshmuara, gjykata do të vendosë në bazë të vlerësimit të ndërgjegjshëm dhe të kujdesshëm të secilës provë veçmas, të të gjitha provave së bashku dhe në bazë të rezultateve të procedurës së tërësishme.

## **E drejta e mbrotjes**

### **Neni 93**

Para marrjes së vendimit, të pandehurit duhet t'i jepet mundësia që të deklarohet mbi faktet dhe provat të cilat e ngarkojnë dhe të nxjerrë të gjitha faktet dhe provat të cilat shkojnë në dobi të tij, përveç në rastet e parapara me ligj.

Në procedurës kundërvajtëse i pandehuri duhet që në dëgjimin e parë të informohet mbi kundërvajtjen për të cilën ngarkohet dhe mbi bazat e akuzës, përveç nëse procedura në bazë të këtij ligji realizohet pa dëgjimin e të pandehurit.

Nëse i pandehuri i ftuar në mënyrë të rregullt nuk vjen dhe nuk e arsyeton mungesën apo në kohë të caktuar nuk jep mbrojtje me shkrim, kurse dëgjimi i tij nuk është i domosdoshëm për vërtetimin e fakteve të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, vendimi mund të merret edhe pa dëgjimin e të pandehurit. I pandehuri ka të drejtë që të mbrohet vet apo me ndihmë profesionale të avokatit të cilin e zgjedh vetë. Gjykata është e detyruar që gjatë dëgjimit të parë ta njoftojë të pandehurin për të drejtën në avokat.

## **Përdorimi i gjuhës në procedurën kundërvajtëse**

### **Neni 94**

Gjykata udhëheqë procedurën në gjuhën serbe dhe në atë procedurë përdorë shkrimin qirilik, kurse shkrimin latin në pajtim me ligjin.

Në territoret në të cilat është në pajtim me ligjin, në përdorim zyrtar edhe gjuha e pakicës kombëtare të caktuar, në kërkesë të palës procedura zhvillohet edhe në gjuhën dhe me përdorimin e shkrimit të asaj pakice kombëtare.

Nëse procedura nuk zhvillohet në gjuhën e palës, gjegjësisht të pjesëmarrësve tjerë në procedurë, të cilët janë shtetas të Republikës së Serbisë, përmes përkthyesit do t'i sigurohet përkthimi i asaj procedure në gjuhën e tyre.

Palët dhe pjesëmarrësit tjerë në procedurë të cilët nuk janë shtetas të Republikës së Serbisë kanë të drejtë që rrjedhën e procedurës ta ndjekin përmes përkthyesit dhe në atë procedurë të përdorin gjuhën e tyre.

Mbi të drejtën në përkthim dhe zhvillimin e procedurës në gjuhën e vet apo gjuhën të cilën e kupton do të mësohet personi nga parag. 2 deri 4 i këtij neni, i cili mund të heq dorë nga ajo e drejtë nëse kupton gjuhën në të cilën zhvillohet procedura kundërvajtëse. Në procesverbal do të shënohet se është dhënë udhëzimi dhe deklarata e pjesëmarrësve.

Përkthimin e bën përkthyesi të cilin e cakton gjykata e cila udhëheq procedurën kundërvajtëse nga lista e përkthyesve të gjykatës, kurse nëse kjo nuk është e mundur, përkthimin do ta bëjë personi tjetër me pranimin e palës.

## **Dyshkallëshmëria e procedurës kundërvajtëse**

### **Neni 95**

Kundër vendimit të gjykatës kundërvajtëse dhe vendimit të cilin në procedurën kundërvajtëse e sjellë komisioni nga neni 87 paragrafi 2 pika 1) e këtij ligji, mund t'i deklarohet ankesa gjykatës së shkallës së dytë, gjegjësisht të bëhet vërejtje në pajtim me këtë ligj.

Vendimi i marrë në procedurën kundërvajtëse hyn në fuqi ditën e lëshimit të aktgjykimit të gjykatës kundërvajtëse të shkallës së dytë, nëse me anë të këtij ligji nuk është caktuar ndryshe.

Kundër vendimit të gjykatës kundërvajtëse të shkallës së dytë nuk është e lejuar ankesa.

## **Ndalesa e ndryshimit për më keq**

### **Neni 96**

Nëse ankesa është bërë vetëm në dobi të të pandehurit, aktgjykimi në pjesën e cila ka të bëjë me sanksionin e shqiptuar nuk mund ta ndryshojë në dëm të tij, e as në procedurën e përsëritur nuk mund të merrët aktgjykimi i pafavorshëm për të pandehurin.

## **Kompenzimi i dëmit për personin e dënuar në mënyrë të paarsyeshme dhe të pabazë**

### **Neni 97**

Personi i cili është dënuar pa arsye për kundërvajtje apo ëshë mbajtur në mënyrë të pabazuar, ka të drejtë në kompenzim të dëmit e cila i është shkaktuar me atë, sikur edhe të drejtat tjera të definuara me ligj.

Sipas kërkesës së personit nga paragrafi 1 i këtij neni, ministrria kompetente për punët e drejtësisë, zhvillon procedurën me qëllim të arritjes së marrëveshjes mbi ekzistimin, llojin dhe lartësinë kompenzimit, dhe nëse marrëveshja nuk arrihet brenda afatit prej tre muajve nga parashtrimi i kërkesës, i dëmtuari mund të ngrisë padi për dëmshpërblim tek gjykata kompetente.

## **Ndihma ligjore**

### **Neni 98**

Gjykatat të cilat zhvillojnë procedurën, janë të obliguar që njëri tjetrit dhe gjykatave tjera t'i ofrojnë ndihmë ligjore në punët nga kompetenca e tyre.

Organet e punëve të brendshme, organet tjera të administratës dhe organet tjera dhe organizatat përgjegjëse janë të obliguar që gjykata të cilat zhvillojnë procedurën t'i ofrojnë ndihmë ligjore dhe të kryejnë urdhërat e tyre në punët nga kompetenca e tyre.

Gjykatat janë të detyruara që t'i ofrojnë ndihmë ligjore organeve shtetore dhe tjera përmes dorëzimit të shkresave, korrigjimeve dhe të dhënave tjera, nëse me këtë nuk pengohet rrjedha e procedurës kundërvajtëse.

## **Zbatimi i përshtatshëm i Kodit mbi procedurën kundërvajtëse**

### **Neni 99**

Në procedurën kundërvajtëse në mënyrë të përshtatshme zbatohen dispozitat e Kodit mbi Procedurën Penale, nëse me këtë apo ligj tjetër nuk është caktuar ndryshe.

## **Kreu IX**

## **ORGANET KOMPETENTE PËR ZHVILLIMIN E PROCEDURËS**

### **Kompetenca**

#### **Neni 100**

Procedurën kundërvajtëse në shkallën e parë e zhvillojnë gjykatat kundërvajtëse.

Me përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni procedurën kundërvajtëse të shkallës së parë nga fusha e prokurimeve publike e udhëheq Komisioni Republikan për Mbrojtjen e të Drejtave në Procedurat e Prokurimeve Publike.

Në procedurën kundërvajtëse nga paragrafi 2 i këtij neni në mënyrë të përshtatshme zbatohen dispozitat e këtij ligji, përveç nëse me ligjin i cili rregullon prokurimet publike nuk është caktuar ndryshe.

Procedurën kundërvajtëse sipas ankesave në vendimet e gjykatave kundërvajtëse dhe komisionit nga paragrafi 2 i këtij neni e udhëheq gjykata kundërvajtëse e shkallës së dytë.

Gjykata kundërvajtëse e shkallës së dytë vendosë edhe për konfliktin dhe bartjen e kompetencës lokale të gjykatave dhe kryen punë tjera të caktuara me ligj.

Gjykata kundërvajtëse e shkallës së dytë kontrollon dhe ndjek punën e gjykatave, grumbullon nga gjykatat të dhënat dhe raportet e nevojshme për ndjekjen e praktikës kundërvajtëse, zbatimin e ligjit dhe rregullave tjera, ndjekjen dhe studimin e marrëdhënieve dhe shfaqjeve shoqërore dhe të dhënave mbi çështjet tjera me interes për realizimin e funksionit të tyre.

### **Natyra publike e punës**

#### **Neni 101**

Natyra publike e punës së gjykatës sigurohet përmes: mbajtjen publike të gjykimit, publikimin e vendimeve, dhënien e informacionit personave të interesuar mbi rrjedhën e procedurës kundërvajtëse, njoftimin e publikut mbi punën e vet përmes mjeteve të informimit publik.

Me qëllim të ruajtjes së sekretit, mbrotjes së moralit, interesit të të miturve apo mbrotjes së intereseve të posaçme të komunitetit, mund të përjashtohet publiku nga puna e gjykatës në të gjitha apo vetëm në faza të caktuara të procedurës kundërvajtëse.

### **Përbërja e gjykatës**

#### **Neni 102**

Në procedurën kundërvajtëse të shkallës së parë gjykon dhe vendosë gjyqtari individual.

Gjykata kundërvajtëse e shkallës së dytë gjykon dhe vendosë mbi këshillin e përbërë nga tri gjyqtarë.

### **Kompetenca e përgjithshme territoriale**

#### **Neni 103**

Për zhvillimin e procedurës kundërvajtëse në shkallën e parë territorialisht është kompetente gjykata në territorin e së cilës është kryer apo tentuar kundërvajtja.

Gjykata e cila është kompetente territorialisht për zhvillimin e procedurës kundërvajtëse kundër personit juridik është kompetente edhe për zhvillimin e procedurës kundërvajtëse kundër personit përgjegjës të personit juridik.

Nëse kundërvajtja është bërë në anijen vendore apo aeroplanin vendor, për zhvillimin e procedurës kundërvajtëse në shkallën e parë territorialisht është kompetente gjykata në territorin e së cilës gjendet porta apo qendra pranuese ajrore në të cilën përfundon udhëtimi i kundërvajtësit, kurse nëse kundërvajtësi është anëtar i ekuipazhit, është kompetente gjykata në territorin e së cilës gjendet porta amë e anijes, gjegjësisht qendra ajrore amë.

Nëse kundërvajtja është kryer apo tentuar në territorin e më shumë gjykatave kundërvajtëse, kompetente është ajo gjykatë e cila e para ka filluar procedurën, dhe nëse procedura ende nuk është filluar, gjykata të cilës më së pari i është bërë kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse.

### **Kompetenca territoriale subsidiare**

#### **Neni 104**

Nëse nuk është i ditur vendi i kundërvajtjes, territorialisht është kompetente gjykata në territorin e së cilës i pandehuri ka vendbanim apo vendqëndrim, gjegjësisht është qendra e personit juridik të akuzuar nëse rëndësia e rregullës me të cilën është caktuar kundërvajtja zgjerohet edhe në territorin në të cilin gjindet vendbanimi apo vendqëndrimi i tij, gjegjësisht qendra e personit juridik të akuzuar.

Nëse nuk janë të njohura as vendi i kryerjes së kundërvajtjes dhe as vendbanimi apo vendqëndrimi i të pandehurit, kompetente është gjykata në territorin e së cilës gjindet i pandehuri, gjegjësisht kapet apo vetë dorëzohet.

### **Kumulimi i kompetencës territoriale**

#### **Neni 105**



Nëse personi i njëjtte është akuzuar për më shumë kundërvajtje dhe për zhvillimin e procedurës kundërvajtëse janë kompetente dy apo më shumë gjykata, kompetente është ajo gjykatë e cila sipas kërkesës së organit kompetent e para e ka filluar procedurën, kurse nëse procedura ende nuk ka filluar kompetente është ajo gjykatë e të cilës i është bërë kërkesa e parë për fillimin e procedurës kundërvajtëse.

### **Bashkimi dhe ndarja e procedurës kundërvajtëse**

#### **Bashkimi**

##### **Neni 106**

Në propozim të palëve apo sipas detyrës zyrtare, për shkak të përshtatshmërisë apo arsyeve tjera, gjykata mund të realizojë procedurë kundërvajtëse të posaçme në rastet e ardhshme:

- 1) nëse personi i njëjtte është akuzuar për më shumë kundërvajtje;
- 2) nëse më shumë persona janë akuzuar për një kundërvajtje;
- 3) sipas bashkëvepruesve;
- 4) nëse i dëmtuari njëkohësisht ka kryer kundërvajtje ndaj të pandehurit;
- 5) nëse më shumë persona janë akuzuar për më shumë kundërvajtje mës të cilave ekziston lidhja.

Kundër vendimit me të cilin është caktuar bashkimi i procedurave apo me të cilët është refuzuar propozimi për bashkim, nuk është e lejuar ankesa.

#### **Ndarja**

##### **Neni 107**

Në propozim të palëve apo sipas detyrës zyrtare, për shkak të përshtatshmërisë apo arsyeve tjera të rëndësishme, gjykata mund të vendosë që procedura kundërvajtëse për kundërvajtje të caktuara apo kundër të pandehurve të caktuar të ndahet dhe të përfundohet ndaras.

Kundër vendimit me të cilin është caktuar ndarja e procedurës kundërvajtëse apo është refuzuar propozimi për ndarjen e procedurës, nuk është e lejuar ankesa.

### **Procedura kundër personit juridik dhe personit përgjegjës**

##### **Neni 108**

Kundër personit juridik dhe personit përgjegjës të personit juridik zhvillohet procedurë kundërvajtëse e posaçme, përveç se në rastin kur ekzistojnë arsye ligjore që procedura të zhvillohet kundër njërit prej tyre.

Nëse kundër personit përgjegjës të personit juridik nuk mund të fillohet procedura, procedura do të fillohet edhe reazilohet kundër personit juridik.

Nëse personi juridik ka ndalur së ekzistuari apo ekzistojnë pengesa tjera juridike për zhvillimin e procedurës, procedura do të fillohet dhe zhvillohet kundër personit përgjegjës të personit juridik.

Nëse para përfundimit të procedurës kundërvajtëse personi juridik ka ndalur së ekzistuari, procedura do të vazhdojë sipas trashëgimitarit juridik.

### **Bartja e kompetencës territoriale**

#### **Neni 109**

Kur gjykata kompetente për arsye juridike apo reale është e penguar që të veprojë në lëndën e caktuar, është e detyruar që për këtë ta lajmërojë gjykatën kundërvajtëse të shkallës së dytë e cila do të caktojë gjykatën tjetër kompetente.

Kundër këtij vendimi nga paragrafi 1 i këtij neni nuk është e lejuar ankesa.

### **Veprimi në rastin e moskompetencës**

#### **Neni 110**

Gjykata është e detyruar që sipas detyrës zyrtare të kujdeset se a bie zgjidhja e lëndës në kompetencën gjyqësore dhe në kompetencën e vet reale dhe territoriale dhe nëse e vëren se nuk është kompetente, me anë të vendimit shpallet jokompetente dhe pa vonesë ia dorëzon lëndën gjykatës kompetente apo organit tjetër kompetent.

Nëse gjykata të cilës i është dorëzuar lënda si kompetente, mendon se është kompetente gjykata e cila ia ka dërguar lëndën, do të fillojë procedurën për zgjidhjen e konfliktit të kompetencës.

Kundër vendimit nga paragrafi 1 i këtij neni nuk lejohet ankesa.

### **Zgjidhja e konfliktit të kompetencës**

#### **Neni 111**

Mbi konfliktin e kompetencës mes gjykatave vendosë gjykata kundërvajtëse e shkallës së dytë.

Derisa të mos zgjidhet konflikti i kompetencës mes gjykatave, secili prej tyre është i detyruar që të kryejë ato punë në procedurë për të cilat ekziston rreziku nga vonesa.

Kundër vendimit nga paragrafi 1 i këtij neni nuk është e lejuar ankesa.

## **Kreu X PËRJASHTIMI**

### **Bazat për përjashtim**

#### **Neni 112**

Gjyqtari i cili merr pjesë në procedurën kundërvajtëse do të jetë i përjashtuar nëse:

1) nëse është i dëmtuar me kundërvajtje;

2) nëse i pandehuri është avokati i të pandehurit, përfaqësuesi i të pandehurit personit juridik, kërkesëbërësi për fillimin e procedurës kundërvajtëse, i dëmtuari apo përfaqësuesi i tij ligjor gjegjësisht avokati, bashkëshorti ose familjari sipas gjakut në vijë të drejtë deri në cilëndo shkallë të lidhjes familjare, në vijë anësore deri në shkallën e katërt, kurse sipas ligjit deri në shkallën e dytë;

3) nëse me të pandehurin, përfaqësuesin e personit juridik të pandehur, avokatin e të pandehurit, personin zyrtar i cili në emër të organit kompetent ka bërë kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse apo të dëmtuatit është në raport të kujdestarit, fëmijës së kujdesur, adoptuesit, strehuesit apo fëmijës së strehuar;

4) nëse në të njëjtën lëndë si person zyrtar në emër të organit kompetent ka bërë kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse apo ka marrë pjesë si përfaqësues i personit juridik të pandehur, mbrojtës i të pandehurit, përfaqësues ligjor apo avokat i të dëmtuarit, apo është dëgjuar si dëshmitar apo si ekspert;

5) nëse në të njëjtën lëndë ka marrë pjesë në marrjen e aktgjykimit të shakllës së parë;

6) nëse ekzistojnë rrethana të cilat shkaktojnë dyshim në paanshmërinë e tij.

### **Detyra e gjyqtarit kur ekzistojnë arsyet për përjashtim**

#### **Neni 113**

Gjyqtari i cili merr pjesë në procedurën kundërvajtëse, kur kupton se ekziston ndonjë nga arsyet për përjashtim nga neni 112 paragrafi 1 pika 1) deri 5) i këtij ligji, është i detyruar të ndërpresë punën në atë lëndë dhe për këtë ta njoftojë kryetarin e gjykatës, i cili do të caktojë gjyqtar tjetër. Nëse bëhet fjalë për përjashtimin e kryetarit të gjykatës, ai do t'ia caktojë vetes zëvendësuesin nga gjyqtarit e asaj gjykate.

Nëse kryetari i gjykatës është njëherit edhe gjyqtari i vetëm në atë gjykatë apo nëse për arsye tjera nuk mundet vetes t'i caktojë zëvendës nga gjykata e njëjtë, do të kërkojë nga kryetari i gjykatës kundërvajtëse të shkallës së dytë që të delegojë gjyqtar tjetër.

Nëse gjyqtari mendon se ekzistojnë rrethanat të cilat shkaktojnë dyshim në paanshmërinë e tij (neni 112 paragrafi 1 pika 6), do ta njoftojë për këtë kryetarin e gjykatës kundërvajtëse, dhe nëse bëhet fjalë për rastin nga paragrafi 2 i këtij neni, kryetarin e gjykatës kundërvajtëse të shkallës së dytë, i cili do të vendosë për përjashtimin e tij.

### **Bërja e kërkesës për përjashtim**

#### **Neni 114**

Përjashtimin e gjyqtarit për shkak të ekzistimit të ndonjëres nga arsyet për përjashtim nga neni 112 i këtij ligji mund ta kërkojnë i pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës i autorizuar për fillimin e procedurës kundërvajtëse (në tekstin vijues: palët).

Kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit palët mund ta bëjnë para marrjes së aktgjykimit, gjegjësisht vendimit.

Kërkesën për përjashtimin e kryetarit dhe gjyqtarit të gjykatës së shkallës së dytë mund ta bëjë pala në ankesën kundër aktgjykimit të shkallës së parë.

Pala mund të kërkojë vetëm përjashtim të gjyqtarit të caktuar individual i cili vepron në lëndë.

Pala është e detyruar që në kërkesë të cekë rrethanat për shkak të të cilave e konsideron se ekziston ndonjëra nga bazat ligjore për përjashtim.

### **Veprimi në rastin e bërjes së kërkesës për përjashtim**

#### **Neni 115**

Kur gjyqtari i cili ka marrë pjesë në procedurën kundërvajtëse kupton se është bërë kërkesa për përjashtimin e tij, është i detyruar që menjëherë të ndërprejë çdo punë në lëndë, kurse nëse bëhet fjalë për përjashtimin nga neni 112 paragrafi 1 pika 6) i këtij ligji, deri te marrja e vendimit për përjashtim mund të kryejë vetëm ato punë për të cilat ekziston rreziku nga shtyerja.

### **Përjashtimi i pjesëmarrësve tjerë në procedurë**

#### **Neni 116**

Dispozitat mbi përjashtimin e gjyqtarit aplikohen njëjtë edhe për nëpunësit, përkthyesit dhe ekspertët.

### **Vendimi mbi kërkesën për përjashtim**

#### **Neni 117**

Mbi kërkesën për përjashtim të gjyqtarëve vendosë kryetari i gjykatës.

Nëse kërkohet përjashtimi i kryetarit të gjykatës, vendimi mbi përjashtim e sjellë kryetari i gjykatës kundërvajtëse të shkallës së dytë.

Nëse kërkohet përjashtimi i gjykatës kundërvajtëse të shkallës së dytë, vendimin për përjashtim e sjellë kryetari i gjykatës së njëjtë.

Nëse kërkohet përjashtimi i kryetarit të gjykatës kundërvajtëse të shkallës së dytë, vendimin mbi përjashtimin e sjellë kryetari i Gjykatës Supreme e Kasacionit.

Mbi përjashtimin e nëpunësit, përkthyesit dhe ekspertit vendosë gjyqtari i cili udhëheqë procedurën kundërvajtëse.

Para marrjes së vendimit mbi përjashtimin, do të sigurohet deklarata nga personat përjashtimi i të cilëve kërkohet, dhe sipas nevojës do të realizohen edhe punë tjera.

Kundër vendimit me të cilin aprovohet kërkesa për përjashtim nuk është e lejuar ankesa, kurse vendimi me të cilin kërkesa për përjashtim hidhet poshtë ose refuzohet mund të kontestohet vetëm me ankesë kundër aktgjykimit.

## **I pandehuri dhe të drejtat e tij**

### **Neni 118**

I pandehur është personi kundër të cilit zhvillohet procedura kundërvajtëse.

I pandehuri ka të drejtë që të paraqesë prova, të bëjë propozime dhe të përdorë mjetet ligjore të parapara me këtë ligj.

Për të pandehurin i cili nuk është ligjërisht i aftë punët në procedurë i ndërmerr përfaqësuesi ligjor.

I pandehuri ka të drejtë që të mbrohet vetë apo me ndihmën profesionale të avokatit mbrojtës.

### **Avokati mbrojtës i të pandehurit**

#### **Neni 119**

I pandehuri mund të marrë për mbrojtës avokatin, dhe atë, në pajtim me ligjin, ta zëvendësojë nëpunësi i avokatit.

Mbrojtësin e të pandehurit mund ta marrin edhe përfaqësuesi i tij ligjor, bashkëshorti, familjari sipas gjakut në vijë të drejtë, adoptuesi, i adoptuari, vëllau, motra dhe strehuesi i të pandehurit, si dhe personi me të cilin i pandehuri jeton bashkësi jashtëmartesore apo bashkësi tjetër të përhershme jetësore.

Avokati mbrojtës është i autorizuar që në dobi të të pandehurit të ndërmerr të gjitha punët të cilat mund t'i ndërmerr i pandehuri.

Avokati mbrojtës është i detyruar që t'i dorëzojë gjykatës autorizim me shkrim.

I pandehuri mund t'i japë avokatit mbrojtës edhe autorizim gojor në proçesverbal tek gjykata.

Të drejtat dhe obligimet e avokatit mbrojtës shuhen atëherë kur heq dorë nga autorizimi apo kur i pandehuri e tërheq autorizimin.

### **Personi juridik i pandehur**

#### **Neni 120**

Për personin e pandehur juridik në procedurën kundërvajtëse merr pjesë përfaqësuesi i tij, i cili është i autorizuar që të ndërmarrë të gjitha punët e cilat i ndërmerr i pandehuri.

### **Përfaqësuesi i personit juridik të pandehur**

#### **Neni 121**

Përfaqësuesi i personit juridik të pandehur është personi i autorizuar që të përfaqësojë atë person juridik apo ta përfaqësojë në bazë të ligjit apo aktit tjetër.

Përfaqësuesi i personit juridik të pandehur nga paragrafi 1 i këtij neni, përveç përfaqësuesit ligjor, duhet të ketë autorizim me shkrim të organit i cili e ka caktuar për përfaqësues.

Përfaqësuesi i personit juridik të pandehur mund të jetë vetëm një person.

### **Përfaqësuesi i personit juridik të pandehur të huaj**

#### **Neni 122**

Përfaqësuesi i personit juridik të pandehur të huaj është personi i cili udhëheq me përfaqësinë apo njësinë tjetër punuese të atij personi juridik në Republikën e Serbisë, nëse për përfaqësues të personit juridik nuk caktohet person tjetër.

### **Personat të cilët nuk mund të jenë përfaqësues të personit juridik**

#### **Neni 123**

Përfaqësues i personit juridik nuk mund të jetë personi i cili në të njëjtën çështje është dëshmitar.

Përfaqësues i personit juridik nuk mund të jetë personi përgjegjës kundër të cilit zhvillohet procedura kundërvajtëse ëjtë përveç se në rastin kur ai person është i autorizuar për përfaqësimin e personit juridik të pandehur.

Në rastet nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni gjykata është e detyruar që të ftojë personin juridik që brenda afatit prej tetë ditëve të caktojë përfaqësuesin tjetër.

### **Dënimi për mospërcaktimin e përfaqësuesit**

#### **Neni 124**

Nëse personi i pandehur juridik në ftesë të gjykatës nuk cakton përfaqësuesin e vet apo në afatin nga neni 123 paragrafi 3 i këtij ligji nuk cakton përfaqësuesin tjetër, mund të dënohet me gjobë prej 10.000 deri 30.000 dinarë. Nëse edhe pas shqiptimit të dënimit personi juridik nuk cakton përfaqësuesin e vet, për çdo mospërgjigje në thirrje do të dënohet me gjobë prej 50.000 deri 100.000 dinarë.

Ankesa kundër vendimit nga paragrafi 1 i këtij neni nuk shtyen zbatimin e vendimit.

### **E drejta në avokat mbrojtës**

#### **Neni 125**

Personi juridik dhe personi përgjegjës i atij personi juridik të cilët nuk kanë status të të pandehurve në çështjen e njëjtë mund të jenë secili avokatin e vet mbrojtës apo avokatin mbrojtës të përbashkët.

Avokati mbrojtës i personit juridik dhe personit përgjegjës të atij personi juridik nuk mund të jetë personi i cili në procedurën e njëjtë kundërvajtëse kishte cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik.

## **Kreu XII I DËMTUARI**

#### **Neni 126**

I dëmtuari, në kuptimin e këtij ligji, është personi e drejta pronësore apo personale e të cilit është kërcënuar me anë të kundërvajtjes.

I dëmtuari i cili ka mbushur gjashtëmbëdhjetë vjet mundet vet të bëjë kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse.

I dëmtuari ka të drejtë që vet apo përmes përfaqësuesit të vet ligjor apo avokatit të:

- 1) paraqesë dhe të përfaqësojë kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse;
- 2) të paraqesë prova, të bëjë propozime dhe të bëjë kërkesë pronëso-ro-juridike për dëmshpërblim apo kthim të gjërave;
- 3) deklaron ankesë në aktgjykim, gjegjësisht vendimin e marrë me rastin e kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse;
- 4) paraqet prova në bazë të të cilave gjykata mund t'i caktojë të pandehurit që gjatë procedurës kundërvajtëse nuk guxon ti afrohet të dëmtuarit, objekteve apo vendit ku është kryer kundërvajtja.

Masa procedurale e ndalimit të qasjes nga paragrafi 3 pika 4) e këtij neni mund të zgjasë derisa zgjasin arsyet për shqiptimin e saj, dhe më së shumti deri në përfundimin e prerë të procedurës.

Ankesa në vendim me të cilin shqiptohet ndalimi i qasjes bëhet brenda afatit prej tri ditëve nga dita e dorëzimit dhe nuk e shtyen zbatimin e vendimit.

### Kreu XIII

## PROKURORI PUBLIK DHE ORGANET TJERA KOMPETENTE PËR PARAQITJEN E KËRKESËS PËR FILLIMIN E PROCEDURËS KUNDËRVAJTËSE

### **Prokurori publik si palë në procedurë Neni 127**

Prokurori publik është palë në procedurën kundërvajtëse.

Prokurori publik:

- 1) ndërmerr masa me qëllim të zbulimit, gjetjes dhe sigurimit të provave të nevojshme për ndjekjen e kundërvajtësve dhe zhvillimin e suksesshëm të procedurës kundërvajtëse para gjykatës;
- 2) bën kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse, ankesë apo mjete tjera ligjore të jashtëzakonshme kundër vendimit të gjykatës;
- 3) ndërmerr punë tjera për të cilat është i autorizuar me këtë ligj dhe rregulla të posaçme.

Prokurori publik është njëmend kompetent që të veprojë në procedurën kundërvajtëse nëse ka bërë kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse.

Nëse prokurori publik i pari ka bërë kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse, procedura do të zhvillohet sipas kërkesës së tij, dhe do të vazhdohet sipas kërkesës së të dëmtuarit apo organit tjetër kompetent për paraqitjen e kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse nëse prokurori publik heq dorë nga kërkesa.

Nëse heq dorë nga kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse, prokurori publik është i detyruar që brenda afatit prej tetë ditëve nga dita e heqjes dorë nga kërkesa, të njohojë të dëmtuarin apo personin tjetër të autorizuar për fillimin e procedurës në mënyrë që të vazhdohet procedura.

Nëse i dëmtuari apo organi tjetër për fillimin e procedurës kundërvajtëse tani më ka bërë kërkesë për fillimin e procedurës, procedura do të vazhdohet sipas asaj kërkesë.

### **Organi tjetër i autorizuar për bërjen e kërkesës**

#### **Neni 128**

Kur për bërjen e kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse është kompetent organi tjetër, ai ka të gjitha të drejtat të cilat i ka edhe prokurori publik si palë në procedurë, përveç atyre të cilat i takojnë prokurorit publik, si organ shtetëror.

Organi kompetent nga paragrafi 1 i këtij neni në mënyrë të shkruar do ta informojë të dëmtuarin se a ka bërë kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse.

Nëse organi kompetent nga paragrafi 1 i këtij neni bën kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse për kundërvajtjen për të cilën është caktuar dënimi me burgim, është i obliguar që për këtë ta njoftojë prokurorin publik kompetent i cili do të vendosë mbi marrjen përsipër të përndjekjes.

Prokurori publik kompetent, mbi vendimin nga paragrafi 3 të këtij neni, me shkrim do ta njoftojë organin kompetent nga paragrafi 1 i këtij neni.

## **Kreu XIV PARASHTRESAT DHE PROÇESVERBALET**

### **Parashtresat**

#### **Neni 129**

Kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse, propozimet, mjetet ligjore dhe deklaratat dhe kumtesat tjera (në tekstin vijues: parashtresat) paraqiten në formë të shkruar apo jepen gojarisht në procesverbal.

Parashtresat e shkruara dorëzohen menjëherë apo dërgohen me postë.

Lajmërimet e shkurta dhe urgjente mund të jepen me me telefaks, teleks, telefon, postë elektronike apo në mënyrë tjetër adekuate, mbi të cilën përpilohet shënim zyrtar dhe bashkangjitet në shkrimin e lëndës.

Parashtresat nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të jenë të kuptueshme dhe të përmbajnë gjithcka që është e nevojshme në mënyrë që të veprohet sipas tyre.



Nëse parashtrësia është e pakuptueshme apo nuk përmbanë gjithë atë që është e nevojshme që të veprimet sipas asaj, gjyqtari i cili e udhëheq procedurën kundërvajtëse do ta urdhërojë kërkesëbërësin që brenda afatit të caktuar, dhe më së voni brenda afatit prej pesëmbëdhjetë ditëve, ta përmirësojë parashtrësën, gjegjësisht ta plotësojë, dhe nëse këtë nuk e bën, parashtrësia do të hedhet poshtë si e parregullt.

### **Përpilimi i procesverbalit**

#### **Neni 130**

Mbi secilën punë të ndërmarrë gjatë procedurës kundërvajtëse do të përpilohet procesverbali menjëherë kur të kryhet puna, e nëse ajo nuk është e mundur, menjëherë pas asaj.

Procesverbalin e shkruan procesmbajtësi.

Me përjashtim të paragrafit 2 të këtij neni, kur kontrollohen banesat apo personi apo vepr ndërmerrtet jashtë hapësirave zyrtare të gjykatës kundërvajtëse, kurse procesmbajtësi nuk mund të sigurohet, procesverbalin mund ta shkruajë personi i cili e ndërmerr punën.

Kur procesverbalin e shkruan procesmbajtësi, procesverbali përpilohet në atë mënyrë që ai person i cili e ndërmerr punën zëshëm i flet procesmbajtësit se çfarë të shkruajë në procesverbal.

Personit i cili dëgjohej, mund t'i lejohej që vetëm të diktojë përgjigjet në procesverbal. Në rast të keqpërdorimit, ajo e drejtë mund t'i mohohet.

### **Përmbajtja e procesverbalit**

#### **Neni 131**

Në procesverbal futen emri i gjykatës, vendi ku kryhet puna, dita dhe koha kur është filluar dhe mbaruar puna, emrat personal të personave prezent dhe në cilën cilësi marrin pjesë, si dhe evidentimi i i lëndës kundërvajtëse sipas të cilës ndërmerrtet puna.

Procesverbali duhet të përmbajë të dhëna të rëndësishme mbi rrjedhën dhe përmbajtjen e punës së ndërmarrë. Në procesverbal futet vetëm përmbajtja e rëndësishme e deklaratave të dhëna.

Pyetjet futen në procesverbal vetëm nëse është e rëndësishme që të kuptohet përgjigja. Nëse është e nevojshme, në procesverbal do të shkruhet saktësisht pyetja e shtruar dhe përgjigja e dhënë. Nëse gjatë ndërmarrjes së punës janë marrë gjëra apo shkresa, kjo do të shënohet në procesverbal, kurse gjërat e marra do t'i bashkangjiten procesverbalit apo do të shënohet se ku gjinden.

Në procesverbal do të futet deklarata e të pandehurit se a ka propozime për paraqitjen e provave tjera.

Gjatë kryerjes së punëve siç janë inspektimi i vendit të ngjarjes, kontrollimi i banesës apo personit, apo identifikimi i personit apo sendit, në procesverbal do të futen edhe të dhënat të cilat janë të rëndësishme duke pasur parasysh natyrën e asaj pune apo për caktimin e identitetit të gjërave të caktuara (përshkrimi i masës apo madhësisë së objektit apo shenjave, vendosja e shenjës në objekte etj.), kurse nëse janë bërë skica, vizatime, plane, fotografi, incizime filmike dhe të ngjashme, kjo do të shënohet në procesverbal dhe do t'i bashkangjitet procesverbalit.

## **Rregullsia e procesverbalit**

### **Neni 132**

Procesverballi duhet të shkruhet në mënyrë të rregullt. Në të nuk guxon të fshihet, të shtohet apo të ndryshohet asgjë. Pjesët e hijëzuara duhet të mbesin të lexueshme.

Të gjitha ndryshimet, korigjimet dhe shtesat futen në fund të procesverbalit dhe duhet të vërtetohen nga personat të cilët e nënshkruajnë procesverbalin.

## **Leximi i procesverbalit**

### **Neni 133**

Personi i dëgjuar, personat të cilët domosdoshmërisht marin pjesë në punët në procedurën kundërvajtëse, si dhe i pandehuri, avokati dhe i dëmtuari nëse janë të pranishëm kanë të drejtë që të lexojnë procesverbalin apo të kërkojnë që t'u lexohet. Për këtë është i obliguar t'i paralajmërojë gjyqtari i cili e kryen punën, kurse në procesverbal do të shënohet se a është bërë paralajmërimi dhe a është lexuar procesverballi.

Procesverballi gjithmonë do të lexohet nëse nuk ka pasur procesmbajtës, dhe kjo do të shënohet në procesverbal.

## **Nënshkrimi i procesverbalit**

### **Neni 134**

Procesverbalin e nënshkruan personi i dëgjuar. Nëse procesverballi përbëhet nga më shumë faqe, personi i dëgjuar nënshkruan secilën faqe.

Në fund të procesverbalit do të nënshkruhet përkthyesi nëse ishte prezent, kurse gjatë kontrollimit edhe personi i cili kontrollohet apo banesa e të cilit kontrollohet, si dhe dëshmitarët të cilët kanë marrë pjesë në kontrollim.

Nëse procesmbajtësi nuk shkruan procesverbalin, procesverbalin e nënshkruajnë personat të cilët marrin pjesë në punë. Nëse nuk ka persona të tillë apo nuk janë në gjendje që të kuptojnë përmbajtjen e procesverbalit, procesverbalin e nënshkruajnë dy dëshmitarë.

Personi që nuk di shkrim-lexim në vend të nënshkrimit vendosë shenjajt e gishtit të dorës së djathtë, kurse procesmbajtësi nën shenja nënshkruan emrin dhe mbiemrin e tij. Nëse gjatë pamundësisë që të vendoset shenja e gishtit tregues të dorës së djathtë vendoset shenja e ndonjë gishti tjetër apo shenja e gishtit të dorës së majtë, në procesverbal do të shënohet se nga cili gisht dhe nga cila dorë është marrë shenja.

Nëse personit të dëgjuar i mungojnë të dy duart, do të lexojë procesverbalin, dhe nëse nuk di shkrim-lexim procesverballi do t'i lexohet, dhe kjo do të shënohet në procesverbal.

Nëse personi i dëgjuar refuzon që të nënshkruajë procesverbalin apo të vendosë shenja e gishtit, kjo do të shënohet në procesverbal dhe do të shkruhet arsyeja e refuzimit.

Nëse puna nuk ka mundur të kryhet pa ndërprerje, në procesverbal do të shënohet dita dhe ora kur është bërë ndërprerja, si dhe dita dhe ora kur është vazhduar puna.

Nëse kishte vërejtje për përmbajtjen e procesverbalit, do të shënohen në procesverbal edhe ato vërejtje. Procesverbalin në fund e nënshkruajnë gjyqtari dhe procesmbajtësi.

### **Procesverballi mbi shqyrtimin dhe votimin**

#### **Neni 135**

Mbi shqyrtimin dhe votimin para gjykatës kundërvajtëse të shkallës së dytë përpilohet procesverbal i posaçëm.

Procesverballi mbi shqyrtimin dhe votimin përmbanë rrjedhën e votimit dhe vendimin i cili është marrë. Procesverbalin e nënshkruajnë të gjithë anëtarët e këshillit dhe procesmbajtësi.

Mendimet e ndara do t'i bashkangjiten procesverbalit mbi shqyrtimin dhe votimin nëse nuk janë futur në vet procesverbalin.

Procesverballi mbi shqyrtimin dhe votimin mbyllet në mbështjellës së posaçëm. Këtë procesverbal mund ta shikojë vetëm gjykata e lartë kur bën zgjidhje për mjetin ligjor dhe në atë rast është i detyruar që procesverbalin ta mbyllë përsëri në mbështjellës të posaçëm dhe në mbështjellës të shkruajë se e ka shikuar procesverbalin.

### **Kreu XV**

## **AFATET DHE KTHIMI NË GJENDJEN E MËPARSHME**

### **Afatet**

#### **Neni 136**

Afatet e parapara me këtë ligj nuk mund të zgjaten, përveç se kur është e lejuar me ligj.

Kur deklarata është e lidhur me afat, konsiderohet se është dhënë brenda afatit nëse para se të skadojë afati i është dorëzuar atij i cili është i autorizuar ta pranojë.

Kur deklarata dërgohet përmes postës me dërgesë të regjistruar apo përmes mënyrës telegrafike, dita e dorëzimit në postë konsiderohet ditë e dorëzimit atij kujt i është dërguar.

I pandehuri i cili gjendet në entin për mbajtjen e dënimit me burgim apo burgut për të mitur mund ta japë deklaratën e cila është e lidhur me afat edhe në procesverbal apo t'ia dërgojë administratës së entit. Dita kur është përpiluar ai procesverbal, gjegjësisht kur deklarata i është dorëzuar entit, konsiderohet dita e dorëzimit organit i cili është kompetent që ta pranojë.

Nëse parashtrësja e cila është e lidhur me afat, për shkak të paditurisë apo gabimi i dukshëm i dërguesit, i është dërguar organit kompetent para skadimit të afatit, ndërsa ka arritur pas skadimit të afatit, konsiderohet se është dorëzuar me kohë.

### **Llogaritja e afateve**

#### **Neni 137**

Afatet llogariten në orë, ditë, muaj dhe vite.

Ora ose dita kur është bërë dorëzimi apo shqiptimi, gjegjësisht në të cilin bie ngjarja nga kur duhet llogaritur kohëzgjatjen e afatit nuk llogaritet në afat, por për fillim të afatit merret ora e parë e ardhshme, gjegjësisht dita. Në një ditë llogariten 24 orë, kurse muaji llogaritet sipas kohës kalendarike.

Afatet e caktuara sipas mujave, gjegjësisht viteve përfundojnë me kalimin e asaj dite të muajit të fundit gjegjësisht viti i cili sipas numrit të tij i përgjigjet ditës kur filloi afati. Nëse nuk ekziston ajo ditë në muajin e fundit, afati përfundon ditën e fundit të atij muaji.

Nëse dita e fundit e afatit bie në festën shtetërore apo të dielën apo ndonjë ditë tjetër kur gjykata nuk punon, afati skadon me kalimin e ditës punuese të ardhshme.

### **Afati për kthimin në gjendjen e mëparshme**

#### **Neni 138**

Të pandehurit i cili për arsye të justifikueshme e lëshon afatin për paraqitjen e ankesës në vendim, gjykata e cila zhvillon procedurën kundërvajtëse, me anë të vendimit do të lejojë kthimin në gjendjen e mëparshme me qëllim të paraqitjes së ankesës, nëse brenda afatit prej tetë ditëve nga dita e ndërprerjes së shkaktarit për të cilin është humbur afati, e bën kërkesën për kthimin në gjendjen e mëparshme edhe psë në të njëjtën kohë me kërkesë e bën ankesën.

Pas kalimit të një muaji nga dita e humbjes së afatit nuk mund të kërkohet kthimi në gjendje të mëparshme.

Kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme i bëhet gjykatës kundërvajtëse e cila e ka marrë vendimin e shkallës së parë.

Kërkesa për kthimin në gjendjen e mëparshme nuk ndalon zbatimin e vendimit, por gjykata të cilës i është dorëzuar kërkesa, sipas rrethanave, mund të vendosë që të ndalojë zbatimin e vendimit deri te marrja e vendimit sipas kërkesës.

### **Vendosja mbi kthimin në gjendje të mëparshme**

#### **Neni 139**

Mbi kthimin në gjendje të mëparshme vendosë gjykata për kundërvajtje e shkallës së parë.

Kur gjykata lejon kthimin në gjendje të mëparshme për shkak të lëshimit të afatit për ankesë, ankesën me shkresa të lëndës do t'ia dorëzojë për zgjidhje gjykatës kundërvajtëse të shkallës së dytë.

Kundër vendimit me të cilin lejohet kthimi në gjendjen e mëparshme nuk është e lejuar ankesa. Gjykata nga paragrafi 1 i këtij neni, ankesën kundër vendimit me të cilin nuk lejohet kthimi në gjendjen e mëparshme, me ankesën kundër vendimit dhe shkresat tjera të lëndës ia dorëzon për zgjidhje gjykatës kundërvajtëse të shkallës së dytë.

Nëse gjykata kundërvajtëse e shkallës së dytë lejon kthimin në gjendjen e mëparshme për shkak të afatit të lëshuar për ankesë, me aktvendimin e njëjtë do të vendoset për ankesën e bërë kundër vendimit të shkallës së parë.

## Kreu XVI SHPENZIMET E PROCEDURËS KUNDËRVAJTËSE

### Çfarë përfshijnë shpenzimet

#### Neni 140

Shpenzimet e procedurës kundërvajtëse janë shpenzime të bëra me rastin e e procedurës kundërvajtëse prej fillimit të saj deri te përfundimi.

Shpenzimet e procedurës kundërvajtëse janë:

- 1) shpenzimet për dëshmitarë dhe ekspertë;
- 2) shpenzimet e inspektimit;
- 3) shpenzimet e transportit të pandehurit;
- 4) shpenzimet për sjelljen e detyrimshme të të pandehuriti;
- 5) shpenzimet transportuese dhe shpenzimet e personave zyrtar;
- 6) shpenzimet e domosdoshme të të dëmtuarit si kërkesëbërës, gjegjësisht përfaqësuesin ligjor të tij dhe shpërblimi dhe shpenzimet e domosdoshme të avokatit të tij;
- 7) shpërblimi dhe shpenzimet e domosdoshme të avokatit mbrojtës;
- 8) shpenzimet e përkthimit dhe interpretimit;
- 9) shuma paushalle;
- 10) shpenzimet e zbatimit.

### Obligimi i pagesës së shpenzimeve

#### Neni 141

Shpenzimet e procedurës kundërvajtëse bijnë në barrën e personit i cili është shpallur përgjegjës për kundërvajtje.

Shpenzimet e procedurës për kundërvajtje për të cilën është ndalur procedura apo i pandehuri është liruar nga përgjegjësia, i bartë gjykata.

Me përjashtim të paragrafit 2 të këtij neni, nëse procedura kundërvajtëse është ndalur për shkak të heqjes dorë të të dëmtuarit nga kërkesa e bërë apo i pandehuri është liruar nga përgjegjësia për shkak të kërkesës së pabazë, shpenzimet e procedurës i bartë i dëmtuari.

Me përjashtim nga paragrafi 2 i këtij neni, gjykata nuk do të bartë shpenzimet e procedurës kundërvajtëse nëse procedura është pushuar për shkak të zhvillimit të procedurës kundërvajtëse për veprën penale e cila përfshinë karakteristika të kundërvajtjes në të cilën i pandehuri është shpallur fajtor.

Kërkesa për kompensim të shpërblimit dhe shpenzimeve tjera të nevojshme të avokatit mbrojtës bëhet brenda afatit prej tre muajve nga dita kur i është dorëzuar vendimi i ligjshëm.

Nëse i pandehuri lirohet në procedurën kundërvajtëse gjatë të cilit ka ardhur deri të ndalimi i procedurës kundërvajtëse, afati nga paragrafi 5 i këtij neni fillon nga hyrja në fuqi e aktgjykimit të lirimit në procedurën kundërvajtëse.

## **Vendimi mbi shpenzimet**

### **Neni 142**

Në vendimin mbi shpenzimet do të shënohet kush i bartë shpenzimet e procedurës kundërvajtëse, në cilën shumë dhe në cilin afat është i detyruar t'i paguajë.

Nëse për caktimin e lartësisë së shpenzimeve nuk ka mjaft të dhëna, mbi shpenzimet do të vendoset kur të mblidhen ato të dhëna.

Kur në aktgjykim apo në vendim nuk është vendosur për shpenzimet e procedurës, do të vendoset me vonë, me vendim të posaçëm në të cilin nuk lejohet ankesa.

Afati nga paragrafi 1 i këtij neni nuk mund të jetë më i shkurtë se 15 as më i gjatë se 30 ditë nga dita e hyrjes në fuqi të vendimit.

## **Shpenzimet solidare**

### **Neni 143**

Personi kundër të cilit zhvilluar procedura kundërvajtëse për më shumë kundërvajtje nuk do të bartë shpenzimet për kundërvajtjen procedura kundërvajtëse e të cilit është pushuar apo është liruar nga përgjegjësia, nëse është e mundur ato shpenzime të ndahen nga shpenzimet e përgjithshme.

Në aktgjykimin me të cilin disa të pandehur janë shpallë përgjegjës, gjykata do të caktojë se cilën pjesë të shpenzimeve do ta bartë secili prej tyre, dhe nëse kjo nuk është e mundur, do të vendoset që të gjithë të pandehurit në mënyrë solidare t'i paguajnë shpenzimet. Pagesa e shumës paushalle do të caktohet për secilin të pandehur veçmas.

## **Shpenzimet e zbulimit të kryesit**

### **Neni 144**

Kur me rregull të posaçme është caktuar që shpenzimet e paraqitura me rastin e zbulimit të kundërvajtjes t'i bartë kryesi, në propozim të kërkesëbërësit do të obligohet kryesi që t'i paguajë ato shpenzime.

## **Arsyeja për lirim nga përgjegjësia e kompensimit të shpenzimeve**

### **Neni 145**

Në vendimin me të cilin vendoset mbi shpenzimet gjykata mund të lirojë të pandehurin nga obligimi që tërësisht apo pjesërisht të kompenzojë shpenzimet e procedurës kundërvajtëse, nëse

me pagesën e tyre do të vendoset në pyetje çështja e mirëmbajtjes së të pandehurit apo personit i cili ai është i detyruar ta mirëmbajë sipas ligjit.

### **Shpenzimet e përkthimit dhe interpretimit**

#### **Neni 146**

Shpenzimet e përkthimit apo interpretimit të cilat paraqiten me aplikimin e dispozitave të kushtetutës dhe ligjit me të cilin rregullohet përdorimi zyrtar i gjuhës dhe shkrimit, gjegjësisht interpretimi i të shurdhërve, të verbërve dhe memecëve, bien në barrën e gjykatës e cila zhvillon procedurën.

### **Kompenzimi i pagesës së shpenzimeve**

#### **Neni 147**

Shpenzimet e procedurës kundërvajtëse nga neni 140 paragrafi 2 pika 1) dhe 2) i këtij ligji paguhen paraprakisht nga mjetet e gjykatës kundërvajtëse e cila zhvillon procedurën kundërvajtëse, kurse paguhen më vonë nga personat të cilët janë të obliguar që t'i kompenzojnë sipas dispozitave të këtij ligji.

### **Zbatimi adekuat i rregullave mbi kompenzimin e shpenzimeve në procedurën kundërvajtëse**

#### **Neni 148**

Rregullat mbi kompenzimin e shpenzimeve të dëshmitarëve, ekspertëve dhe interpretuesve si dhe shpenzimeve tjera në procedurën kundërvajtëse do të zbatohen në mënyrë adekuate në procedurën kundërvajtëse.

## **Kreu XVII**

### **KËRKESA PRONËSORO-JURIDIKE**

#### **Diskutimi mbi kërkesën pronësor-juridike**

#### **Neni 149**

Mbi kërkesën pronësor-juridike vendosë gjykata.

Kërkesa pronësor-juridike e cila është paraqitur gjatë kryerjes së kundërvajtjes do të diskutohet në kërkesë të të dëmtuarit apo personit tjetër të autorizuar, sipas rregullës, në procedurën kundërvajtëse përvec nëse me këtë dukshëm nuk zvarritet procedura.

Kërkesa pronësor-juridike mund të lidhet me dëmshpërblimin dhe kthimin e gjërave.

#### **Personat e autorizuar për bërjen e kërkesës**

#### **Neni 150**

Propozimin për realizimin e kërkesës pronësor-juridike në procedurën kundërvajtëse mund ta bëjë personi i cili është i autorizuar që këtë kërkesë ta realizojë në kontest, më së voni deri në marrjen e aktgjykimit të shkallës së parë.

Personi i autorizuar për bërjen e kërkesës pronëso-ro-juridike është i obliguar që kërkesën e tij ta përcaktojë sipas bazës dhe lartësisë si dhe të paraqesë prova.

### **Vendosja mbi kërkesën**

#### **Neni 151**

Nëse provat e paraqitura në procedurën kundërvajtëse nuk japin bazë të sigurt që kërkesa pronëso-ro-juridike në tërësi apo pjesërisht të aprovohet, gjykata do ta udhëzojë të dëmtuarin apo personin tjetër të autorizuar që kërkesën pronëso-ro-juridike, gjegjësisht tepricën e asaj kërkesë mund ta realizojë në kontest.

Nëse kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse është hedhur poshtë me vendim apo procedura kundërvajtëse është pushuar, apo i pandehuri është liruar nga përgjegjësia, i dëmtuari apo personi tjetër i autorizuar do të udhëzohet që kërkesën e tij pronëso-ro-juridike ta realizojë në kontest.

Nëse prona e dëmtuar është në pronësi publike, mbi vendimin nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni informohet avokati kompetent publik.

Kundër vendimit mbi kërkesën pronëso-ro-juridike, i dëmtuari apo personi tjetër i autorizuar i cili e ka bërë kërkesën ka të drejtë ankese.

### **Afati për dëmshpërblim**

#### **Neni 152**

Nëse gjykata pjesërisht apo në tërësi aprovon kërkesën pronëso-ro-juridike, në aktgjykim do të caktohet afatin brenda të cilit i pandehuri është i detyruar të kompenzojë dëmin e shkaktar, gjegjësisht të kthejë gjërat.

Afati për dëmshpërblim dhe kthim të gjërave nuk mund të jetë më i gjatë se 15 ditë nga dita e hyrjes në fuqi të aktgjykimit.

### **Kreu XVIII**

## **APROVIMI DHE SHQIPTIMI I VENDIMEVE**

### **Llojet e vendimeve**

#### **Neni 153**

Në procedurën kundërvajtëse gjykata merr vendime në formë të: aktgjykimeve, aktvendimeve dhe urdhërave.

### **Shqiptimi i vendimeve**

#### **Neni 154**

Vendimet shqiptohen, sipas rregullës, menjëherë pas marrjes.



Vendimet shqiptohen gojarisht përmes shpalljes palëve prezente, të dëmtuarit dhe personave tjerë të cilët kanë të drejtë në ankesë kundër atij vendimi (në tekstin vijues: personat e interesuar), dhe me dërgimin e shkresës së vulosur nëse mungojnë.

Kur vendimi shqiptohet gojarisht, kjo do të shënohet në procesverbal apo në shkresë, kurse personi të cilit i është shqiptuar vendimi gojarisht, do ta konfirmojë më nënshkrimin e vet.

Në kërkesë të personit të interesuar do të lëshohet shkresa e vulosur e vendimit e cila i është shqiptuar gojarisht.

Personat e interesuar të cilët nuk kërkojnë dërgimin e vendimit do të njohtohen mbi të drejtën në ankesë dhe mbi afatin për ankesë.

Kopja e shkruar e vendimit në rastin nga paragrafi 4 i këtij neni do të përgatitet më së voni brenda afatit prej tetë ditëve nga dita e shqiptimit gojor, kurse kopja e shkruar e aktgjykimit menjëherë nëse caktohet zbatimi i aktgjykimit para hyrjes në fuqi.

## **Vendimi i gjykatës së shkallës së dytë**

### **Neni 154a**

Këshilli i gjykatës së shkallës së dytë do të gjykojë vetëm nëse në lëndën e njëjtë vendimi i shkallës së parë është ndërprerë njëherë.

Këshilli i gjykatës së shkallës së dytë vendosë se a do të bëjë kontrollin.

Nëse këshilli vendosë që të bëjë kontrollimin, gjyqtari raportues është kryetari i këshillit.

I pandehuri mundet, brenda afatit prej tetë ditëve nga dita e marrjes së aktgjykimit, të paraqesë ankesë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë nga paragrafi 1 i këtij neni, nëse sipas ankesës së parashtruesit të kërkesës aktgjykimi për lirim apo aktvendimi mbi pushimin e procedurës janë shndërruar në një aktgjykim.

Mbi ankesën e të pandehurit kundër vendimit të këshillit të gjykatës së shkallës së dytë vendosë këshilli tjetër i asaj gjykateje.

## **Rrjedha e mbledhjes së këshillit**

### **Neni 155**

Vendimet e gjykatës kundërvajtëse të shkallës së dytë merren me shqyrtim dhe votim pas raportimit gojor të gjyqtarit mbi gjendjen e gjërave. Vendimi është bërë kur për të kanë votuar shumica e anëtarëve të këshillit.

Kryetari i këshillit udhëheq me shqyrtimin dhe votimin dhe voton i fundit. Ai është i obliguar që të kujdeset që të gjitha pyetjet të shqyrtohet nga të gjitha anët dhe plotësisht.

Nëse nga pikëpamja e çështjeve të caktuara votat ndahen në disa mendime të ndryshme ashtu që asnjëri nga ata nuk e ka shumicën, do të ndahen pyetjet dhe votimi do të përsëritet derisa të mos arrihet shumica. Nëse në atë mënyrë nuk arrihet shumica, vendimi do të merret ashtu që votat të cilat janë më të papërshtatshëm për të pandehurin do të bashkohen votave të cilat janë më pak të papërshtatshme, derisa të mos arrihet shumica.

Anëtarët e këshillit nuk mund të refuzojnë që të votojnë për pyetjet të cilat i bën kryetari i këshillit, por anëtari i këshillit i cili ka votuar që të ndërpritet procedura kundërvajtëse dhe ka mbetur në pakicë nuk është i obliguar që të votojë për dënimin. Nëse nuk voton, konsiderohet se është pajtuar që të japë votën e cila është më e favorshme për të pandehurin.

Shqyrtimi dhe votimi bëhen në seancë të mbyllur.

Në hapësirën në të cilën shqyrtohet dhe votohet mund të jenë prezent vetëm anëtarët e këshillit dhe procesmbajtësi.

## Kreu XIX DORËZIMI I DOKUMENTEVE DHE SHQYRTIMI I SHKRESAVE

### Dorëzimi i dokumenteve

#### Neni 156

Dokumentet dërgohen përmes postës, shërbimit tjetër të autorizuar për dërgim, personit zyrtar të gjykatës apo organit tjetër, gjegjësisht drejtpërdrejt në hapësirat e gjykatës.

Dërgimi mund të bëhet edhe në mënyrë elektronike, në pajtim me rregulla të caktuara nëse për këtë ekzistojnë kushtet.

Dërgimi bëhet çdo ditë në vendin e punës apo në hapësirën e punës gjatë orarit të punës, apo në banesë prej orës 7 deri 22, apo në gjykatë kur personi të cilit duhet t'i bëhet dorëzimi gjendet aty apo kur gjykata e fton me qëllim të dorëzimit.

Dorëzimi mund të bëhet edhe në kohë tjetër dhe në vend tjetër në bazë të vendimit të posaçëm të gjykatës, të cilin dorëzuesi në kërkesë të personit të cilit i bëhet dorëzimi, është i detyruar ta tregojë.

Thirrja për kontrollim gojor apo thirrjet tjera gjykata mund t'ia shqiptojë personit i cili gjendet para tij edhe gojarisht, me udhëzime për pasojat e mosardhjes. Thirrja gojore e tillë do të shënohet në procesverbal të cilin personi i ftuar do ta nënshkruajë, përveç se nëse thirrja është e shënuar në procesverbal mbi kontrollimin, në ç'mënyrë konsiderohet se është bërë dërgesa.

### Dërgimi i detyruar personal

#### Neni 157

Thirrja me qëllim të dëgjimit të të pandehurit, gjegjësisht dhënia e mbrojtjes së shkruar apo për dëgjimin e dëshmitarit, si dhe të gjitha vendimet nga dorëzimi i të cilëve fillon afati për paraqitjen e ankesës dorëzohen personalisht, përveç se në rastin kur me këtë ligj është caktuar ndryshe.

Në mënyrë të njëjtë dorëzohen edhe vendimet për të dëmtuarin, për të cilin nga dita e dorëzimit fillon afati për ankesë.

### Dorëzimi në adresë të banesës

#### Neni 158

Dokumenti për të cilin në këtë ligj është caktuar që të dorëzohet personalisht, i dorëzohet drejtpërdrejt personit të cilit i është adresuar në adresën në të cilën është i lajmëruar apo të cilën ia ka dhënë organit gjatë zbulimit të kundërvajtjes.

Nëse personi të cilit dokumenti duhet t'i dorëzohet personalisht nuk gjendet aty ku duhet të bëhet dorëzimi, dorëzuesi këtë dokument ia dorëzon ndonjërit nga anëtarët madhor të shtëpisë, i cili është detyruar që ta pranojë dhe në atë mënyrë konsiderohet se është kryer dërgesa.

Nëse personi të cilit duhet t'i dorëzohet dokumenti personalisht apo personi madhor i familjes refuzon ta pranojë dokumentin, dorëzuesi do ta shënojë në fletëdërgesë që pranimi është refuzuar, si dhe ditën dhe orën kur është refuzuar pranimi, kurse dokumenti do të lihet në banesë apo në derë të pranuesit dhe në atë mënyrë konsiderohet se dërgesa është kryer.

Nëse personi të cilit duhet t'i bëhet dorëzimi i dokumentit personalisht apo anëtari madhor i shtëpisë nuk gjenden në banesë, dokumenti i dorëzohet personave madhor të cilët gjenden në banesë nëse ata pranojnë dhe në atë mënyrë konsiderohejt se është bërë dërgesa.

### **Dorëzimi në vendin e punës**

#### **Neni 159**

Nëse dorëzimi bëhet në vendin e punës së personit të cilit duhet t'i dorëzohet personalisht dokumenti, kurse ai person nuk gjendet aty, dorëzimi mund të bëhet me dorëzimin e dokumentit personit të autorizuar për pranim të postës apo cilido person tjetër të punësuar tek punëdhënësi i njëjtë në vendin e njëjtë, dhe të cilët janë të detyruar që të pranojnë dokumentin dhe në atë mënyrë konsiderohet se është kryer dorëzimi.

Nëse personi të cilit dokumentin duhet dorëzuar personalisht refuzon që të pranojë dokumentin apo këtë e bën personi nga paragrafi 1 i këtij neni, dorëzuesi do të shënojë në fletëpranim ditën, orën dhe arsyen e refuzimit të pranimit, kurse dokumentin do ta lë në vendin e punës dhe në atë mënyrë konsiderohet se është kryer dorëzimi.

### **Dorëzimi personit që mungon**

#### **Neni 160**

Nëse në adresën ku duhet të bëhet dorëzimi nuk gjendet askush, do të lihet në kutinë postare apo të mbështetet në derë njoftimi personit të cilit i është drejtuar dokumenti se dhet ta marrë në gjykatë brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e dorëzimit të tentuar.

Pas kalimit të afatit nga paragrafi 1 i këtij neni, dokumenti do të vendoset në tabelën e shpalljeve dhe ueb faqen të gjykatës, nëse për këtë ekzistojnë kushtet teknike. Dorëzimi konsiderohet i suksesshëm pas skadimit të afatit prej tetë ditëve nga dita e vendosjes së dokumentit në tabelën e shpalljeve dhe në ueb faqen të gjykatës.

Njoftimi nga paragrafi 1 i këtij neni përmbanë: emrin dhe mbiemrin e personit të cilit i është tentuar dorëzimi, cilësia në procedurë, data dhe ora kur është tentuar dorëzimi, adresa në të cilën është tentuar dorëzimi, shënimin që dokumentin duhet ta marrë në gjykatë dhe në cilin afat, me vërejtje se në rast se nuk e merr dokumentin kopja e tij do të vendoset në tabelën e shpalljeve dhe në faqen e internetit të gjykatës, si dhe që në atë rast pas skadimit të afatit prej tetë ditëve do të konsiderohet se dorëzimi është kryer.

Nëse vërtetohet se personi të cilit është dashur t'i dorëzohet dokumenti mungon apo apo përkohësisht banon në adresë tjetër dhe se për këtë arsye nuk mund t'i dorëzohej dokumenti në kohë, dokumenti do t'i kthehet gjykatës me shënimin se ku gjendet personi që mungon, dhe ku është e mundur t'i dorëzohen dokumentet.

Nëse gjatë përpjekjes së përsëritur dokumenti nuk mund të dorëzohet në kohën dhe vendin e caktuar në mënyrën nga paragrafi 4 i këtij neni, dokumenti do të vendoset në tabelën e shpalljeve dhe ueb faqen e gjykatës nëse pëtitë këto ekzistojnë kushtet teknike. Dorëzimi konsiderohet i kryer pas skadimit të afatit prej tetë ditëve nga dita e vendosje së dokumentit në tabelën e shpalljeve dhe ueb faqen e gjykatës.

Nëse dokumenti nuk mund të dorëzohet në adresën nga neni 158 paragrafi 1 i këtij ligji, gjykata do të verifikojë adresën dhe nëse pas përpjekjes së përsëritur dokumenti nuk mund të dorëzohet në adresën në të cilën është lajmëruar personi, do të vepohet në mënyrën e paraparë në paragrafin 2 të këtij neni.

### **Dorëzimi mbrojtësit, përfaqësuesit dhe avokatit**

#### **Neni 161**

Nëse i pandehuri ka avokat mbrojtës, të gjitha vendimet nga dorëzimi i të cilëve fillon afati për ankesë, do t'i dorëzohen vetëm mbrojtësit, kurse nëse janë më shumë vetëm njërit prej tyre dhe në atë mënyrë dorëzimi të pandehurit konsiderohet i kryer.

Nëse i dëmtuari ka përfaqësues ligjor apo avokat, vendimet nga paragrafi 1 i këtij neni do t'i dërgohen atij, e nëse janë më shumë vetëm njërit prej tyre.

### **Vërtetimi mbi dorëzimin**

#### **Neni 162**

Vërtetimin mbi dorëzimin e realizuar (fletëpranimin apo fletëkthimin) e nënshkruajnë pranuesi dhe dorëzuesi.

Pranuesi në fletëpranim apo fletëkthim vetë do të shënojë datën e pranimit. Dita dhe muaji i pranimit shënohen me shkronja dhe numra.

Nëse pranuesi nuk di shkrim dhe lexim apo nuk është në gjendje që të nënshkruhet, dorëzuesi do të nënshkruhet për pranuesin, do të shënojë datën e pranimit dhe vërejtje pse është nënshkruar në vend të tij.

Nëse pranuesi refuzon të nënshkruajë fletëpranimin apo fletëkthimin, dorëzuesi do ta shënojë këtë në fletëpranim dhe do të shkruajë datën e dorëzimit dhe në atë mënyrë dorëzimi është kryer.

Të dhënat mbi konfirmimin për dorëzimin e realizuar duhet të jenë qartë të plotësuar.

Dorëzimi përmes postës elektronike konsiderohet i kryer nën kushtin që me atë mënyrë të dorëzimit është e mundur të sigurohet informacion kthyes që personi e ka pranuar dokumentin.

Vërtetimi mbi pranimin e dokumentit të dorëzuar përmes postës elektronike paraqet shkresë të shtypur elektronike mbi datën dhe orën kur pajisja për bartjen elektronike të të dhënave e ka

regjistruar që dokumenti i është dorëzuar pranuesit, emrin e dërguesit dhe pranuesit dhe emrin e dokumentit.

### **Dorëzimi i dokumenteve personave ushtarak, anëtarëve të policisë dhe personave tjerë**

#### **Neni 163**

Personave ushtarak, anëtarëve të policisë, anëtarëve të rojës në entet për zbatimin e sanksioneve penale dhe të punësuarve në komunikacionin tokësor, lumor, detar dhe ajror, dorëzimi i thirrjeve mund të bëhet edhe përmes komandës së tyre, gjegjësisht kujdestarit apo udhëheqësit të drejtpërdrejt, kurse sipas nevojës në atë mënyrë mund t'i bëhet edhe dorëzimi i dokumenteve tjera.

Personave të burgosur dorëzimi i bëhet përmes administratës së entit ku janë të vendosur.

Personave të cilët gëzojnë imunitet në Republikën e Serbisë, nëse nuk është caktuar ndryshe me marrëveshje ndërkombëtare, dorëzimi i bëhet përmes organit kompetent për punë të jashtme.

### **Dorëzimi i dokumenteve organeve shtetërore, personave juridik dhe ndërmarrësve**

#### **Neni 164**

Organit shtetëror vendimet dhe dokumentet tjera i dërgohen me anë të dorëzimit në zyrën e gjendjes civile. Kur dorëzohen vendimet tek të cilat afati fillon që nga dita e dorëzimit, dita e dërgesës konsiderohet dita kur është dorëzuar në zyrën e gjendjes civile.

Dërgimi personave juridik dhe ndërmarrësve bëhet me dorëzimin e dokumenteve personit të autorizuar për pranimin e dokumenteve, e nëse kjo nuk është e mundur, dokumenti do t'i dorëzohet cilido të punësuar i cili gjendet në hapësirën e pranuesit dhe në këtë mënyrë dorëzimi konsiderohet i kryer.

Nëse personi nga paragrafi 2 i këtij neni refuzon të pranojë dokumentin, dorëzuesi do të shënojë në fletëpranim që pranimi është refuzuar, kush e ka refuzuar si dhe ditën dhe orën kur është refuzuar pranimi, kurse dokumenti do të lihet në hapësirën punuese të pranuesit dhe kështu konsiderohet se dërgesa është kryer.

Nëse dorëzimi ndërmarrësit nuk është i mundur të bëhet në kuptimin e paragrafit 2 të këtij neni, dorëzimi do të bëhet në adresën e banesës së tij nëse është e njohur në mënyrën e caktuar me nenin 158 të këtij ligji.

Nëse ndërmarrësi mungon, kurse dorëzimi nuk mund të bëhet në adresën e banesës së tij, dorëzimi do të bëhet në mënyrën e paraparë me nenin 160 të këtij ligji.

### **Ndryshimi i adresës dhe vendosja e dokumentit në tabelën e shpalljeve**

#### **Neni 165**

Kur i pandehuri apo përfaqësuesi i tij ligjor dhe i dëmtuari pas njoftimit për procedurën e ndryshojnë vendbanimin e tyre apo adresën e banesës, janë të detyruar që mbi këtë, menjëherë pas bërjes së ndryshimit, ta njoftojnë gjykatën tek e cila zhvillohet procedura.

Nëse nuk e bëjnë këtë, gjykata do të caktojë që të gjitha dërgesat e ardhshme në procedurë për atë palë, të bëhen me vendosjen e dokumenteve në tabelën për shpallje dhe në faqen e internetit të gjykatës, me përjashtim nëse është fjala për dorëzimin e aktgjykimit me të cilin është shqiptuar dënimi me burgim.

Dorëzimi do të bëhet në mënyrën nga paragrafi 2 i këtij neni dhe në rastin kur gjykata merr vendim mbi ndërprerjen e procedurës për shkak të parashtrimit, tek i cili ka ardhur për shkak të pamundësisë së dorëzimit të vendimit nga neni 246 paragrafi 1 i këtij ligji.

Dorëzimi konsiderohet i kryer pas skadimit të tetë ditëve nga dita e vendosjes së dokumenteve në tabelën e shpalljeve dhe faqen e internetit të gjykatës.

Nëse avokati mbrojtës i të pandehurit apo avokati i të dëmtuarit si parashtrues i kërkeës gjatë procedurës ndryshojnë adresën e tyre, dhe nuk e informojnë gjykatën për këtë, dorëzimi do të bëhet sikur që i pandehuri të mos ketë mbrojtës gjegjësisht i dëmtuari nuk ka avokat.

### **Shqyrtimi dhe përshkrimi i shkresës**

#### **Neni 166**

Parashtruesi i kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse, i pandehuri, mbrojtësi i të pandehurit, përfaqësuesi gjegjësisht avokati i personit juridik të pandehur, i dëmtuari dhe përfaqësuesi i tij ligjor, gjegjësisht avokati, kanë të drejtë që të shqyrtojnë dhe përshkruajnë shkresat e lëndës.

Shqyrtimi dhe përshkrimi i shkresës mund t'i lejohet edhe personave tjerë të cilët kanë interes ligjor për këtë, në pajtim me ligjin.

Kur zhvillohet procedura kundërvajtëse, shqyrtimin dhe përshkrimin e shkresës e lejon gjyqtari i cili e udhëheq procedurën kundërvajtëse, kurse pas përfundimit të procedurës, shqyrtimin dhe përshkrimin e shkresës e lejon kryetari i gjykatës apo personi zyrtar të cilin ai e cakton.

Shqyrtimi dhe përshkrimi i shkresës, përveç të pandehurit, mbrojtësit të tij dhe përfaqësuesit të personit juridik të pandehur, mund të ndalohet vetëm nëse në atë mënyrë do të pengohet zhvillimi i procedurës kundërvajtëse apo nëse përjashtohet publiku nga procedura.

Pas procedurës dëshmuese të përfunduar, gjegjësisht kontrollimit gojor të përfunduar të personit i cili ka interes të arsyetuar, nuk mund të ndalohet shqyrtimi dhe përshkrimi i shkresës.

Kundër vendimit mbi ndalimin e shqyrtimit dhe përshkrimit të lëndës, është e lejuar ankesa e cila nuk ndalon zbatimin e vendimit.

### **Kreu XX**

## **FILLIMI I PROCEDURËS KUNDËRVAJTËSE**

#### **Neni 167**

Procedura kundërvajtëse fillon me vendimin e gjykatës në bazë të:

1) kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse;

2) urdhërin e lëshuar për kundërvajtje me ç'rast është bërë kërkesa për vendimin e gjykatës.

## **1. Urdhëri për kundërvajtje**

### **Kushtet për lëshimin e urdhërit për kundërvajtje**

#### **Neni 168**

Urdhëri për kundërvajtje lëshohet kur për kundërvajtje, me ligj apo me rregull tjetër, nga sanksionet kundërvajtëse është paraparë vetëm dënimi me gjobë në shumë fikse.

Për kundërvajtjet nga paragrafi 1 i këtij neni nuk mund të bëhet kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse.

Për secilin kundërvajtës lëshohet urdhër i posaçëm për kundërvajtje.

Urdhëri për kundërvajtje nuk mund t'i lëshohet të miturit.

Nëse me këtë ligj nuk ka kushte për lëshimin e urdhërit për kundërvajtje në raport me personin juridik apo përgjegjës, kundër të dy personave do të bëhet kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse.

### **Mënyra e lëshimit të urdhërit për kundërvajtje**

#### **Neni 169**

Organi i autorizuar, gjegjësisht personi i autorizuar do të lëshojë urdhërin për kundërvajtje nëse kundërvajtjen nga kompetenca e vet e ka zbuluar në njërin nga mënyrat e ardhshme:

- 1) vërejtjen e drejtpërdrejt të zyrtarit të policisë apo personit të autorizuar gjatë kontrollimit, mbikqyrjes dhe ekzaminimit, si edhe shikimit në evidencën e organit kompetent;
- 2) qasjes në të dhënat të cilat janë marrë me ndihmën e pajisjeve për mbikqyrje apo matje;
- 3) gjatë mbikqyrjes inspektuese apo tjetër, përmes kontrollimit të dokumentacionit, hapësirës dhe mallit apo në ndonjë mënyrë tjetër të rregulluar me ligj.

### **Përmbajtja e urdhërit për kundërvajtje**

#### **Neni 170**

Urdhëri për kundërvajtje lëshohet në formë të shkruar dhe përmbanë:

- 1) titullin: urdhër për kundërvajtje;
- 2) emrin e organit të autorizuar i cili e ka lëshuar;
- 3) numrin identifikues të urdhërit, të caktuar nga ana e organit të autorizuar;
- 4) emrin personal dhe cilësinë e personit zyrtar i cili e ka lëshuar;
- 5) datën e lëshimit dhe datën e dorëzimit;

- 6) emrin personal të personit fizik, kryesit të kundërvajtjes, adresën e vendbanimit të tij, gjegjësisht vendqëndrimin, numrin personal, të dhënat mbi punësimin, për të huajt numrin e pasaportit, gjegjësisht letërnjoftimit, kurse për personin përgjegjës të personit juridik edhe funksionin të cilin e kryen në atë person juridik, kurse për ndërmarrësin edhe emrin dhe qendrën e biznesit;
- 7) emrin dhe qendrën e personit juridik kundër të cilit është lëshuar urdhëri për kundërvajtje, si dhe numrin e tij identifikues tatimor dhe numrin personal;
- 8) përshkrimi faktik i veprës nga e cila del cilësia ligjore e kundërvajtjes, si dhe koha dhe vendi i kryerjes së kundërvajtjes;
- 9) kualifikimin ligjor të kundërvajtjes;
- 10) dënimin e shqiptuar me gjobë;
- 11) udhëzimin mbi mënyrën e pagesës së dënimit me gjobë me llogarinë adekuate në të cilën duhet të bëhet pagesa;
- 12) nënshkrimi i personit zyrtar dhe vula e organit kompetent;
- 13) Vendi për nënshkrim, gjegjësisht nënshkrimi dhe vula e personit kundër të cilit është lëshuar urdhëri për kundërvajtje;
- 14) Udhëzime dhe paralajmërime për personin kundër të cilit është lëshuar urdhëri për kundërvajtje;
- 15) Me rastin e kundërvajtjes së njëjtë a i lëshohet personit tjetër urdhëri për kundërvajtje;
- 16) Vendi për shënime.

Nëse kundërvajtja është bërë me automjet në komunikacion, urdhëri për kundërvajtje përmbanë edhe:

- 1) Numrin regjistruar të automjetit dhe numrin e lejes për vozitje
- 2) Numrin e lejes për vozitje të vozitësit, nëse është i njohur. Urdhëri për kundërvajtje mund të lëshohet edhe në formë elektronike.

Nëse me këtë ligj nuk është caktuar ndryshe, në përpilimin, formën, kopjimin, vërtetimin, dorëzimin dhe ruajtjen e urdhërit për kundërvajtje të lëshuar në formë elektronike, aplikohet ligji i cili rregullon dokumentin elektronik.

### **Udhëzimet dhe vërejtjet në urdhërin për kundërvajtje**

#### **Neni 171**

Urdhëri për kundërvajtje përmbanë udhëzimet dhe vërejtjet vijuese:

- 1) Që personi kundër të cilit është lëshuar urdhëri për kundërvajtje, nëse pranon përgjegjësinë dhe brenda afatit prej tetë ditëve nga dita e pranimit të urdhërit për



kundërvajtje të paguajë gjysmën e dënimit të shqiptuar në pajtim me nenin 173 paragrafi 1 i këtij ligji, lirohet nga pagesa e pjesës së dytë të dënimit me gjobë;

- 2) Që personi kundër të cilit është lëshuar urdhëri për kundërvajtje mund të pranojë përgjegjësinë për kundërvajtje dhe pas skadimit të afatit prej tetë ditëve nga pranimi i urdhërit për kundërvajtje, nëse para procedurës së zbatimit vullnetarisht paguan shumën e plotë të dënimit të shqiptuar me gjobë, në pajtim me nenin 173 paragrafi 4 i këtij ligji;
- 3) Që personi kundër të cilit është lëshuar urdhëri për kundërvajtje, i cili nuk pranon përgjegjësinë për kundërvajtje ka të drejtë që brenda afatit prej tetë ditëve nga dita e pranimi të urdhërit për kundërvajtje, të bëjë kërkesë për vendimin e gjykatës ashtu që personalisht apo përmes postës do t'ia dorëzojë urdhërin për kundërvajtje gjykatës kundërvajtëse, me shënimin e gjykatës të cilës i bëhet kërkesa, në pajtim me nenin 174 paragrafi 1 i këtij ligji;
- 4) Që personi kundër të cilit është lëshuar urdhëri për kundërvajtje të jetë i detyruar që përveç pagesës së dënimit me gjobë të caktuar me urdhër për kundërvajtje, të kompenzojë shpenzimet e gjyqimit në rast se kërkon vendimin e gjykatës kurse gjykata vërteton se është fajtor për kundërvajtje në pajtim me nenin 174 paragrafi 7 i këtij ligji;
- 5) Që urdhëri për kundërvajtje të jetë përfundimtar dhe zbatues pas kalimit të afatit prej tetë ditëve nga dita e pranimi, nëse personi kundër të cilit është lëshuar urdhëri për kundërvajtje brenda atij afati nuk e paguan dënimin me gjobë apo nuk kërkon vendimin e gjykatës mbi urdhërin për kundërvajtje në pajtim me nenin 173 paragrafi 2 i këtij ligji;
- 6) Që personi kundër të cilit është lëshuar urdhëri për kundërvajtje në rastin e zbatimit të detyrueshëm të dënimit me gjobë, do të jetë i detyruar që të kompenzojë shpenzimet e zbatimit të caktuara me vendimin mbi pagesën e detyruar në pajtim me nenin 318 paragrafi 6 i këtij ligji;
- 7) Që personit fizik, ndërmarrësit dhe personit përgjegjës të personit juridik kundër të cilit është lëshuar urdhëri për kundërvajtje, dënimi me gjobë të cilin nuk e ka paguar do t'i zëvendësohet me dënim me burgim apo punë të interesit publik në pajtim me nenin 41 të këtij ligji.

Dispozitat e paragrafit 1 pika 1) deri 7) e këtij ligji janë pjesë përbërëse e urdhërit për kundërvajtje, si udhëzime dhe paralajmërime për personin kundër të cilit është lëshuar urdhëri për kundërvajtje, në kuptimin e nenit 170 paragrafi 1 pika 14) e këtij ligji.

Ministri kompetent për punët e drejtësisë cakton me rregull të posaçme formën e urdhërit për kundërvajtje.

### **Dorëzimi i urdhërit për kundërvajtje**

#### **Neni 172**

Urdhëri për kundërvajtje përbëhet nga origjinali dhe dy kopje. Origjinali i jepet personit kundër të cilit lëshohet urdhëri për kundërvajtje, kurse kopjen e ruan organi i cili e lëshon urdhërin për kundërvajtje.

Urdhëri për kundërvajtje i jepet personit prezent për të cilin mendohet se ka kryer kundërvajtje në momentin e zbulimit të kundërvajtjes. Personi kundër të cilit është lëshuar urdhëri për kundërvajtje me nënshkrimin në vendin adekuat në urdhër e konfirmon pranimin e tij.

Personit nga paragrafi 2 i këtij neni mund t'i dorëzohet edhe kopja e shtypur e urdhërit për kundërvajtje të lëshuar në formë elektronike.

Në kërkesë të gjykatës, personi të cilit i lëshohet urdhëri apo përfaqësuesi i tij, lëshuesi i urdhërit është i detyruar që të lëshojë kopjen e vërtetuar të urdhërit për kundërvajtje.

Nëse personi për të cilin mendohet se ka kryer kundërvajtje mungon dhe kur rrethanat e zbulimit apo natyra e kundërvajtjes e kërkojnë këtë, dorëzimi i urdhërit për kundërvajtje do të kryhet përmes postës apo shërbimit dërgues të organit kompetent, në pajtim me dispozitat mbi dorëzimin nga ligji i cili rregullon procedurën e përgjithshme administrative.

Nëse personi prezent kundër të cilit lëshohet urdhëri kundërvajtës refuzon që të pranojë urdhërin, personi zyrtar do ta paralajmërojë për pasojat e refuzimit të pranimit, do të shënoj në urdhër shënimin mbi refuzimin e pranimit, ditën dhe orën kur është refuzuar pranimi në ç'mënyrë konsiderohet se urdhëri është dorëzuar.

Nëse personi kundër të cilit lëshohet urdhëri kundërvajtës deklaron se do të kërkojë vendimin gjyqësor mbi urdhërin, organi i cili lëshon urdhërin, në marrëveshje me gjykatën kompetente, gjatë lëshimit të urdhërit mund të caktojë datën e kontrollit.

Organi është përgjegjës që të shënoj në urdhër shënimin mbi kontrollin e caktuar dhe menjëherë, e më së voni ditën e ardhshme punuese do ta njoftojë për këtë gjykatën kompetente.

Do të konsiderohet që i pandehuri ka hequr dorë nga kërkesa për vendim gjyqësor, në kuptimin e nenit 175 të këtij ligji, nëse nuk paraqitet në kontrollim dhe nëse nuk e arsyeton mungesën e vet.

## **Marrja e përgjegjësisë**

### **Neni 173**

Personi kundër të cilit është lëshuar urdhëri kundërvajtës pranon përgjegjësinë për kundërvajtje me pagesën e gjysmës së dënimit të shqiptuar brenda afatit prej tetë ditëve nga dita e pranimit të urdhërit për kundërvajtje, në ç'mënyrë lirohet nga pagesa e pjesës së dytë të dënimit të shqiptuar.

Nëse personi kundër të cilit është dhënë urdhëri për kundërvajtje brenda afatit prej tetë ditëve nga dita e marrjes së urdhërit nuk paguan dënimin e shqiptuar apo nuk bën kërkesë për vendim gjyqësor mbi urdhërin kundërvajtës, do të konsiderohet se e ka marrë përgjegjësinë me anë të lëshimit, kurse urdhëri për kundërvajtje do të bëhet final dhe zbatues.

Urdhëri për kundërvajtje me konstatimin e finalitetit dhe shënimin se dënimi me gjobë nuk është paguar, organi kompetent i dorëzon gjykatës kundërvajtëse që dënimin me gjobë ta venodos në regjistër dhe të zbatojë procedurën e zbatimit në pajtim me këtë ligj.

Personi kundër të cilit është lëshuar urdhëri kundërvajtës mund të marrë përgjegjësi për kundërvajtje edhe pas skadimit të afatit prej tetë ditëve nga pranimi i urdhërit kundërvajtës nëse para procedurës së zbatimit vullnetarisht e paguan shumën e plotë të dënimit të shqiptuar me gjobë.

## **Procedura sipas kërkesës për vendim nga ana e gjykatës**

### **Neni 174**

Personi kundër të cilit është lëshuar urdhëri për kundërvajtje nëse nuk pranon përgjegjësinë e vet, mundet gjykatës kompetente brenda afatit prej tetë ditëve nga pranimi i urdhërit përkundërvajtje, personalisht apo përmes postës, t'ia dorëzojë urdhërin e nënshkruar për kundërvajtje, i cili sipas këtyre kushteve paraqet kërkesë për vendimin e gjykatës mbi urdhërin e kundërvajtjes (në tekstin vijues: kërkesa për vendimin e gjykatës).

Personi kundër të cilit është lëshuar urdhëri për kundërvajtje, me dorëzimin e kërkesës për vendimin gjyqësor gjykatës kompetente, fiton cilësinë e të pandehurit në procedurën kundërvajtëse (në tekstin vijues: i pandehuri).

Nëse i pandehuri i bën gjykatës kërkesë personale për vendim gjyqësor, gjykata është e detyruar që menjëherë pas pranimit të kërkesës ta regjistrojë lëndën, të pandehurit t'i japë vërtetim për pranimin e kërkesës, ta analizojë kërkesën dhe të marrë vendim mbi fillimin e procedurës, kurse të pandehurin e dëgjon apo i cakton kontrollimin.

Nëse i pandehuri gjykatës i dorëzon kërkesën për vendim gjyqësor përmes postës, me urdhërin kundërvajtës të nënshkruar, mund ta bashkangjesë edhe mbrojtjen e vet të shkruar dhe të paraqesë apo të propozojë prova.

Gjykata është e obliguar që menjëherë pas regjistrimit të lëndës ta analizojë kërkesën për vendimin gjyqësor, të marrë vendim për fillimin e procedurës kundërvajtëse dhe të ftojë organin i cili e ka lëshuar urdhërin për kundërvajtje që brenda afatit prej tetë ditëve të deklarohet dhe të paraqesë apo të propozojë provat mbi kundërvajtjen e kryer.

Kur gjykata të marrë vendim mbi fillimin e procedurës kundërvajtëse, konsiderohet se vendimi mbi dënimin me gjobë nga urdhëri për kundërvajtje nuk është shqiptuar, përveç në rastin nga neni 175 i këtij ligji.

Nëse gjykata vërteton se i pandehuri i cili kërkonte vendimin gjyqësor është përgjegjës për kundërvajtje, me vendimin e tij do ta detyrojë që dënimin me gjobë nga urdhëri kundërvajtës ta paguajë në shumën e plotë si dhe të kompenzojë shpenzimet gjyqësore.

## **Heqja dorë e të pandehurit nga kërkesa për vendim gjyqësor**

### **Neni 175**

I pandehuri i cili ka bërë kërkesë për vendim gjyqësor, nga ajo ankesë mund të heq dorë më së voni në seancën gjyqësore të parë.

Do të konsiderohet së i pandehuri ka hequr dorë nga kërkesa për vendim gjyqësor nëse i pandehuri i ftuar me rregull nuk vjen në seancën e parë gjyqësore dhe as nuk e arsyeton mungesën e tij.

Në rastin nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij ligji gjykata me anë të vendimit do të vërtetojë se urdhëri kundërvajtës është final dhe i zbatueshëm dhe i pandehuri obligohet që të paguajë shpenzimet e paraqitura të procedurës kundërvajtëse, kurse dënimin me gjobë do ta fusë në regjistrin e dënimeve me gjobë.

Kundër vendimit nga paragrafi 3 i këtij neni i pandehuri ka të drejtë që të ankohet në afatin prej tetë ditëve. Ankesa nuk e shtyen zbatimin e vendimit.

### **Analiza e kërkesës për vendim gjyqësor**

#### **Neni 176**

Gjykata me anë të vendimit do të hedhë poshtë kërkesën e vonuar apo të pa nënshkruar për vendim gjyqësor.

Kundër vendimit nga paragrafi 1 i këtij neni i pandehuri ka të drejtë të ankohet brenda tetë ditëve. Ankesa nuk e shtyen zbatimin e vendimit.

Me anë të vendimit me të cilin gjykata hedh poshtë kërkesën për vendim gjyqësor për shkak të arsyeve nga paragrafi 1 i këtij neni, urdhëri kundërvajtës bëhet final dhe i zbatueshëm, kurse dënimin e shqiptuar me gjobë gjykata do ta fusë në regjistrin e sanskioneve kundërvajtëse.

Nëse urdhëri për kundërvajtje të cilin e ka bërë i pandehuri si kërkesë për vendim gjyqësor, është i palexueshëm apo nuk përmbanë të gjitha të dhënat e nevojshme për veprimin e gjykatës, e sidomos nëse nuk është precizuar përshkrimi faktik i veprës nga e cila del karakteristika ligjore e kundërvajtjes, koha dhe vendi i kundërvajtjes, gjykata para marrjes së vendimit mbi fillimin e procedurës do të kërkojë nga organi i cili e ka lëshuar urdhërin për kundërvajtje që brenda afatit prej tetë ditëve ta rregullojë.

Nëse organi i autorizuar në afatin e dhënë nuk vepron sipas kërkesës së gjykatës dhe nuk eliminon mungesat, gjykata do të veprojë sikur me kërkesën e parregullt për fillimin e procedurës kundërvajtëse nga neni 182 i këtij ligji.

### **Fillimi i procedurës në bazë të urdhërit të lëshuar për kundërvajtje**

#### **Neni 177**

Nëse gjykata kërkesën e të pandehurit për vendim gjyqësor në bazë të urdhërit për kundërvajtje nuk e hedh poshtë, atëherë do të sjellë vendim mbi fillimin e procedurës kundërvajtëse.

Gjykata kundërvajtëse është e detyruar që dhënësin e urdhërit oër kundërvajtje ta njoftojë se është filluar procedura kundërvajtëse, dhe nga i njëjti të kërkojë që për kundërvajtjen e kryer të japë të gjitha provat me të cilat disponon.

### **Personat të cilët nuk kanë vendqëndrim në territorin e Republikës së Serbisë**

#### **Neni 178**

Kundërvajtësit i cili nuk mund të dëshmojë identitetin e vet apo nuk ka vendqëndrim, apo nuk jeton në adresën në të cilën është lajmëruar, apo nëse ka vendqëndrim jashtë shtetit apo nëse shkon jashtë shtetit me qëllim të qëndrimit, të cilit i është lëshuar urdhëri për kundërvajtje në kohën e punës së bankës apo postës, do të urdhërojë që dënimin e shqiptuar ta paguajë menjëherë përmes bankës apo postës.

Nëse kundërvajtësit i është këshuar urdhëri për kundërvajtje jashtë orarit të punës së bankës apo postës apo nëse kundërvajtja është bërë jashtë vendbanimit, dënimi me gjobë do t'i paguhet aty për aty me dhënien e vërtetimit në të cilin është shënuar shuma e shërbimit postal të cilin

kundërvajtësi është i detyruar ta paguajë menjëherë, kurse zyrtari i autorizuar ditën e parë të ardhshme punuese do të paguajë shumën përmes postës.

Nëse kundërvajtësi nuk e paguan dënimin me gjobë, do të konsiderohet se ka bërë kërkesë për vendim gjyqësor dhe menjëherë do të sillet para gjykatës kompetente.

Nëse nuk është e mundur që kundërvajtësi menjëherë të sillet para gjykatës, atëherë përfaqësuesi i organit kompetent mund të ndërmarrë masat nga neni 199 paragrafi 1 i këtij ligji.

## **2. Kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse**

### **Neni 179**

Kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse e bën organi kompetent ose i dëmtuari (në tekstin vijues: parashtruesi i kërkesës).

Organet kompetente nga paragrafi 1 i këtij neni janë organe e administratës, inspektorët e autorizuar, prokurori publik dhe organet tjera dhe organizatat, të cilat bëjnë autorizime publike në kompetencën e të cilave bje zbatimi i drejtpërdrejt apo mbikqyrja e zbatimit të rregullave në të cilat janë paraparë kundërvajtjet.

### **I dëmtuari si parashtrues i kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse**

#### **Neni 180**

I dëmtuari është i autorizuar që të bëjë kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse gjithmonë përveç nëse me ligj nuk është caktuar që për fillimin e procedurës kundërvajtëse është i autorizuar vetëm organi nga neni 179 paragrafi 2 i këtij ligji.

I dëmtuari i cili ka bërë kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse ka pozitën e palës në procedurë.

Nëse në rastin nga paragrafi 1 i këtij neni organi i autorizuar nuk e bën kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse, i dëmtuari mundet, në pajtim me dispozitat e këtij ligji, të bëjë kërkesë të atillë.

Nëse kërkesën për fillimin e procedurës e ka bërë organi kompetent para se të fillojë procedura në kërkesë të të dëmtuarit, do të vepohet sipas kërkesës për fillimin e procedurës së organit kompetent.

Akuza kundërvajtëse e të dëmtuarit e cila i është dorëzuar organit kompetent nën kushtet nga ky ligj do të konsiderohet si kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse nëse organi i autorizuar vet nuk e inicon fillimin e procedurës kundërvajtëse.

Në rastin e paragrafit të mëparshëm, organi kompetent është i detyruar që brenda afatit prej tetë ditëve nga dita e bërjes së akuzës kundërvajtëse, me shkrim të njoftojë të dëmtuarin se si ka vepruar me akuzën kundërvajtëse.

I dëmtuari mundet gjatë procedurës të marrë përsipër ndjekjen nga prokurori publik i cili heq dorë nga kërkesa për fillimin e procedurës. I dëmtuari mund të ruajë kërkesën e mëhershme apo ta ndryshojë.

## Përmbajtja e kërkesës

### Neni 181

Kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse bëhet në formë të shkruar dhe përmbanë:

- 1) Emrat dhe qendrën e parashtruesit të kërkesës gjegjësisht emrin dhe mbiemrin e personit i cili e bën kërkesën;
- 2) Emrin e gjykatës të cilës i bëhet kërkesa;
- 3) Të dhënat kryesore mbi personin fizik, ndërmarrësin dhe personin përgjegjës kundër të cilit bëhet kërkesa: emrin personal, numrin personal të qytetarit, profesionin, vendin dhe adresën e banimit, vendin dhe adresën e punësimit dhe shtetësinë gjegjësisht emrin dhe qendrën e personit juridik, si dhe numrin identifikues tatimor (në tekstin vijues: PIB) dhe numrin amë, kurse për ndërmarrësin edhe emrin dhe qendrën e biznesit, kurse për personin përgjegjës të personit juridik edhe funksionin të cilin e kryen në atë person juridik;
- 4) Përshkrimin e gjendjes fatike nga e cila del cilësia ligjore e kundërvajtjes, koha dhe vendi i kundërvajtjes dhe rrethanat tjera të nevojshme që kundërvajtja të definohet sa më saktë;
- 5) Rregulla mbi kundërvajtjen e cila duhet zbatuar;
- 6) Propozimin mbi provat të cilat duhet paraqitur, me shënimin e emrave personal dhe adresave të dëshmitarëve, shkresat të cilat duhet lexuar dhe objektet të cilat shërbejnë si dëshmi;
- 7) Të dhënat mbi atë se a është filluar procedura penale apo procedura për shkeqje tregtare për pjesën e cila përfshinë karaktersitikat e kundërvajtjes e cila është lëndë e kërkesës;
- 8) Nënshkrimi i personit zyrtar, gjegjësisht të dëmtuarit si parashtruesit të kërkesës dhe vula e organit të autorizuar i cili e bën kërkesën.

Nëse janë të qasur në kërkesë do të shënohen edhe të dhënat mbi personin kundër të cilit bëhet kërkesa: vendi dhe data e lindjes, numri i telefonit, adresa e e-mailit, numri i telefonit në vendin e punës, numrat e llogarive punuese të personave juridik dhe ndërmarrësve.

Kërkesa nga paragrafi 1 i këtij neni mund të përmbajë edhe propozimin për shqiptimin e masës së ndalesës së qasjes nga neni 126 paragrafi 3 pika 4) e këtij ligji.

Kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse e bën personi fizik si i dëmtuar, nuk duhet të përmbajë rregullën për kundërvajtje e cila duhet të zbatohet, as numri personal i qytetarit i personi kundër të cilit bëhet kërkesa.

Kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse të cilën e bën personi fizik si i dëmtuar kundër personi juridik dhe personit përgjegjës të personit juridik dhe ndërmarrësit, duhet të përmbajë emrin dhe qendrën e personit juridik, emrin, mbiemrin dhe funksionin e personit përgjegjës të atij personi juridik gjegjësisht emrin dhe mbiemrin, emrin dhe qendrën e biznesit të ndërmarrësit.

Kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse të cilën e bën personi fizik si i dëmtuar kundër personit përgjegjës në organin shtetror, organin e autonomisë territoriale dhe njësisë së qeverisë

lokale apo poseduesve tjerë të autorizimeve publike duhet të përmbajë emrin personal të të pandehurit, emrin dhe qendrën e organit dhe funksionin, gjegjësisht punët të cilat i kryen personi në organ.

Personi fizik në cilësi të të dëmtuarit mund t'i bëjë kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse gjykatës kundërvajtëse kompetente dhe gojarisht në proçesverbal.

Kërkesëbërësi është i detyruar, që menjëherë pas njoftimit, dhe deri në përfundimin ligjor të procedurës të lajmërojë gjykatën kundërvajtëse se kundër të pandehurit, për shkak të ngjarjes së njëjtë, zhvillohet procedurë penale apo procedurë për shkelje tregtare.

### **Kërkesa e parregullt**

#### **Neni 182**

Kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse bëhet në aq kopje sa ka të pandehur dhe një kopje për gjykatën. Nëse kërkesa nuk përmban të gjitha të dhënat nga neni 181 i këtij ligji, do të kërkohet nga parashtruesi i kërkesës që ta plotësojë brenda afatit të caktuar.

Afati nga paragrafi 1 i këtij neni nuk mund të jetë më i gjatë se 15 ditë.

Në rast se parashtruesi i kërkesës nuk i eliminon mungesat në kohë të caktuar, do të konsiderohet se ka hequr dorë nga kërkesa dhe kërkesa do të anulohet me anë të vendimit.

### **Analiza e kushteve për fillimin e procedurës**

#### **Neni 183**

Kur gjykata kompetente pranon kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse, do të shikojë se a ka kushte për fillimin e procedurës kundërvajtëse dhe vendose për rrjedhën e mëtejshme të procedurës.

Kur kërkesa përmban të dhëna mbi atë për të njëjtën ngjarje është filluar procedura penale apo procedura për shkelje tregtare, gjykata kundërvajtëse shkresat e lëndës do t'ia dërgojë gjykatës kompetente për veprim të mëtejshëm dhe për këtë do ta informojë kërkesëbërësin.

Në mënyrën nga paragrafi 2 i këtij neni gjykata do të veprojë kur gjatë procedurës kupton se për ngjarjen e njëjtë është duke u zhvilluar procedurë penale apo procedurë për shkelje tregtare.

### **Anulimi i kërkesës**

#### **Neni 184**

Kur gjykata vërteton se nuk ekzistojnë kushte për fillimin e procedurës kundërvajtëse, kërkesën për fillimin e procedurës do ta anulojë me anë të vendimit.

Nuk ekzistojnë kushte për fillimin e procedurës kundërvajtëse:

- 1) Kur vepra e përshkruar në kërkesë nuk është kundërvajtje;
- 2) Kur gjykata nuk është në të vërtetë kompetente për zhvillimin e procedurës kundërvajtëse;

- 3) Kur ekzistojnë bazat të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë për kundërvajtjen e të pandehurit;
- 4) Kur paraqitet parashtrimi për fillimin e procedurës kundërvajtëse;
- 5) Kur kërkesën e ka bërë organi i paautorizuar, gjegjësisht personi i paautorizuar;
- 6) Kur ekzistojnë arsye tjera ligjore për të cilat nuk mund të fillojë procedura.

Vendimi nga paragrafi 1 i këtij neni do t'i dërgohet kërkesëbërësit, kurse i dëmtuari do të udhëzohet që kërkesën pronëso- juridike mund ta realizojën në seancën gjyqësore.

Kundër këtij vendimi kërkesëbërësi për fillimin e procedurës ka të drejtë ankese brenda afatit prej tetë ditëve, nga dita e dorëzimit të vendimit.

### **Vendimi mbi fillimin e procedurës kundërvajtëse**

#### **Neni 185**

Nëse gjykata nuk e anulon kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse, do të marrë vendim për fillimin e procedurës kundërvajtëse.

Vendimi nga paragrafi 1 i këtij neni përmbanë karakteristikat e personit kundër të cilit fillohet procedura kundërvajtëse dhe kualifikimin ligjor të kundërvajtjes.

Nëse kërkesa është bërë kundër më shumë personave apo për më shumë kundërvajtje, në vendim duhet të shënohen të gjithë personat dhe kualifikimet ligjore për të gjitha kundërvajtjet. Vendimi mbi fillimin e procedurës kundërvajtëse nuk i dërgohet parashtruesit të kërkesës dhe as të pandehurit.

Kundër vendimit mbi fillimin e procedurës kundërvajtëse nuk është e lejuar ankesa.

Procedura zhvillohet vetëm në shikimin e asaj kundërvajtje dhe kundër atij të pandehuri me të cilin ka të bëjë vendimi mbi fillimin e procedurës kundërvajtëse përveç në rastin nga neni 247 paragrafi 4 i këtij ligji.

Gjykata nuk është e lidhur me kualifikimin ligjor të dhënë në kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse, gjegjësisht në vendimin mbi fillimin e procedurës kundërvajtëse.

### **Kreu XXI**

## **MASAT PËR SIGURIMIN E PRANISË SË TË PANDEHURIT**

### **Llojet e masave**

#### **Neni 186**

Masat të cilat mund të ndërmerren për sigurimin e pranisë së të pandehurit dhe për zhvillimin e suksesshëm të procedurës kundërvajtëse janë: thirrja, sjellja, garanca dhe mbajtja.

Gjatë vendosjes se cilën nga masat e cekura do t'i aplikojë, gjykata do t'i përmbahet kushteve të caktuara për zbatimin e masave të caktuara, duke u kujdesur që të mos aplikohet masa e rëndë nëse qëllimi i njëjtë mund të arrihet me masë më të butë.



## **Thirrja e të pandehurit**

### **Neni 187**

Prania e të pandehurit gjatë kryerjes së punëve në procedurën kundërvajtëse sigurohet me thirrjen e tij. Thirrjen të pandehurit ia bën gjykata.

I pandehuri i cili duhet personalisht të marrë pjesë në kryerjen e punëve në procedurën kundërvajtëse, gjegjësisht vetë të marrë pjesë në kryerjen e tyre, thirret me thirrje me shkrim.

Thirrja bëhet me dërgimin e thirrjes së shkruar të mbyllur e cila përmbanë: emrin e gjykatës, emrin personal të të pandehurit, kualifikimin ligjor të kundërvajtjes e cila e ngarkon, vendin ku i pandehuri duhet të vijë, ditën dhe orën kur duhet të vijë i pandehuri, shënimin që thirret në cilësinë e të pandehurit, vulën zyrtare dhe nënshkrimin e gjyqtarit. Në thirrje me të cilën i pandehuri thirret shënohet se a duhet të vijë personalisht që të dëgjohet apo mbrojtjen e tij mund ta japë edhe në formë të shkruar.

Kur i pandehuri thirret herën e parë, bashkë me thirrjen i dërgohet edhe kopja e kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse.

Kur i pandehuri thirret herën e parë, do të udhëzohet në thirrje mbi të drejtën që të marrë avokat dhe që avokati mund të marre pjesë në dëgjimin e tij.

Kur i pandehuri thirret që personalisht të marre pjesë sepse dëgjimi i tij është i domosdoshëm, në thirrje do të paralajmërohet se në rast se nuk vjen do të sillet.

Nëse për vërtetimin e gjendjes faktike nuk është e nevojshme prania e të pandehurit, në thirrje do të shënohet se në rast të mosardhjes së tij do të merret vendimi pa dëgjimin e tij.

Dispozitat e këtij neni do të zbatohen edhe në thirrjen e përfaqësuesit të personit juridik të pandehur.

## **Sjellja e të pandehurit**

### **Neni 188**

Nëse i pandehuri i thirrur në mënyrë të rregullt nuk i përgjigjet thirrjes kurse mungesën e tij nuk e arsyeton apo nëse nuk është mundur të bëhet dorëzimi i rregullt i thirrjes, dhe nga rrethanat del se i pandehuri po i shmanget pranimit të thirrjes, gjykata do të urdhërojë sjelljen e tij nëse gjendja faktike në mënyrë tjetër nuk mund të vërtetohet në mënyrë tjetër dhe të plotë.

Sjellja e të pandehurit mund të urdhërohet vetëm nëse në thirrje ishte shënuar se do të sillet në mënyrë të detyruar nëse nuk i përgjigjet thirrjes.

Nëse përfaqësuesi i personit juridik të pandehur, i thirrur në mënyrë të rregullt, nuk i përgjigjet thirrjes, dhe nuk e arsyeton mungesën e tij, do të urdhërohet sjellja e tij.

## **Urdhëri për sjellje**

### **Neni 189**

Urdhëri për sjellje lëshohet me shkrim. Urdhëri duhet të përmbajë: emrin e njësisë organizative të administratës policore të cilës i drejtohet, të dhënat personale të nevojshme për identifikimin e të pandehurit i cili duhet të sillet, arsyeja pse është urdhëruar sjellja, vula zyrtare dhe nënshkrimi i gjyqtarit i cili urdhëron sjelljen.

Urdhërin për sjellje e zbatojnë zyrtarët e autorizuar policor.

Personi të cilit i është besuar zbatimi i urdhërit ia dorëzon urdhërin të pandehurit gjegjësisht përfaqësuesit të personit juridik të pandehur dhe fton që të shkojë me të. Nëse i ftuari refuzon, atë do ta sjellin në mënyrë të detyruar.

Kundër anëtarëve të policisë, personit ushtarak profesional, apo anëtarit të rojës së entit për zbatimin e sanksioneve penale në të cilat zbatohet dënimi nuk do të lëshohet urdhër për sjellje, por do të kërkohet nga komanda e tyre, gjegjësisht enti, që t'i sjellin.

Shpenzimet e sjelljes i bartë personi i sjellur.

### **Lëshimi i urdhërit të përgjithshëm për sjellje**

#### **Neni 189a**

Lëshimi i urdhërit të përgjithshëm për sjellje mund të urdhërohet nga gjykata nëse i pandehuri kundër të cilit është filluar procedura kundërvajtëse gjendet në arrati apo ekzistojnë rrethana tjera të cilat tregojnë se qartë po i shmanget sjelljes sipas urdhërit ë lëshuar nga gjykata për sjellje, i cili nuk është zbatuar për shkak të ekzistimit të këtyre rrethanave.

Urdhërin e përgjithshëm për sjellje gjykata ia dorëzon organeve të policisë me qëllim të organizimit të kërkimit.

Kërkimin e organizon organi i policisë kompetent sipas vendit të gjykatës para të cilit zhvillohet procedura kundërvajtëse.

Nëse personi i gjetur sipas urdhërit të përgjithshëm për lëshuar për sjellje nuk mund të sillet në gjykatë menjëherë, zyrtari i autorizuar i policisë në pajtim me nenin 190, paragrafi i këtij ligji, mund ta mbajë më së shumti 24 orë nga koha kur është gjetur.

Gjykata e cila ka urdhëruar lëshimin e urdhërit të përgjithshëm për sjellje është i detyruar që menjëherë ta tërheqë pas gjetjes së personit të kërkuar apo kur paraqitet parashtrimi i zhvillimit të procedurës kundërvajtëse apo zbatimit të sanksioneve kundërvajtëse apo arsye tjera për të cilat kërkimi më nuk është i nevojshëm.

### **Sjellja e të dyshuarit për kryerjen e kundërvajtjes para fillimit të procedurës**

#### **Neni 190**

Zyrtarët e autorizuar të policisë munden edhe pa urdhër të gjykatës ta sjellin personin e gjetur duke kryer kundërvajtje:

- 1) Nëse identiteti i atij personi nuk mund të vërtetohet apo ekziston nevoja e vërtetimit të identitetit;
- 2) Nëse nuk ka vendbanim apo vendqëndrim;

- 3) Nëse me shkuarjen jashtë shtetit mund t'i shmanget përgjegjësisë për kundërvajtje, kurse bëhet fjalë për kundërvajtje për të cilat nuk mund të lëshohet urdhëra për kundërvajtje;
- 4) Nëse më sjellje pengohet në vazhdimin e kryerjes së kundërvajtjes, gjegjësisht nëse ekziston rreziku që do të vazhdojë me kundërvajtje, të përsërisë kundërvajtjen apo t'i shmanget procedurës kundërvajtëse.

Sjellja e të dyshuarit në rastet nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të kryhet pa vonëse.

Nëse në rastet nga paragrafi 1 i këtij neni i dyshuari është gjetur duke kryer kundërvajtje dhe nuk mund të dërgohet në gjykatë menjëherë, kurse ekzistojnë dyshime të bazuara se do të ikë apo rreziku që do të vazhdojë me kryerjen e kundërvajtjes, zyrtari i autorizuar policor mund ta mbajë të dushuarin më së shumti 24 orë.

Në rastin nga paragrafi 3 i këtij neni, zyrtari i autorizuar policor është i detyruar që pa vonesë mbi arrestin ta njoftojë personin sipas zgjedhjes së personit të arrestuar, si dhe përfaqësuesin diplomatiko-konzular të shtetit, shtetasi i të cilit është arrestuar, gjegjësisht përfaqësuesin e organizatës ndërkombëtare adekuate nëse personi i arrestuar është refugjat apo person pa shtetësi.

Me përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni masa e arrestit mund t'i shqiptohet të miturit vetëm me urdhërin e gjykatës.

Mbi sjelljen e të dyshuarit merret vendim mbi arrestin.

Kundër vendimit mbi arrestimin i pandehuri dhe avokati i tij kanë të drejtë të ankohet brenda afatit prej katër orëve nga koha e dorëzimit të vendimit mbi arrestimin.

Mbi ankesën vendosë gjyqtari individual i gjykatës kundërvajtëse me kompetencë territoriale brenda afatit prej katër orëve nga koha e pranimit të ankesës.

Ankesa nuk ndalon zbatimin e vendimit.

Dispozitat e paragrafit 6 deri 9 të këtij neni aplikohen edhe në arrestimin e personave nën ndikimin e alkoolit apo substancave tjera psikoaktive.

## **Mbajtja e të pandehurit në arrest**

### **Neni 191**

Në procedurën kundërvajtëse i pandehuri mund të mbahet në arrest me vendimin e gjykatës në rastet e ardhshme:

- 1) Nëse nuk mund të vërtetohet identiteti i tij apo vendbanimi, gjegjësisht vendqëndrimi, kurse ekziston dyshimi se do të ikë;
- 2) Nëse me shkuarjen jashtë shtetit mund t'i shmanget përgjegjësisë për kundërvajtjen për të cilën është i paraparë dënimi me burgim;
- 3) Nëse është gjetur duke kryer kundërvajtje, dhe mbajtja në arrest është e nevojshme që të pengohet kryerja e mëtejshme e kundërvajtjes.

Gjyqtari do t'i informojë anëtarët e familjes së personit të arrestuar apo personat tjerë përgjegjës për kujdesjen e të miturit nëse ndaj tij është caktuar arresti.

### **Urdhëri për mbajtje në arrest**

#### **Neni 192**

Mbi mbajtjen e të pandehurit në arrest gjykata merr urdhër në të cilin shënon datën dhe orën kur është urdhëruar mbajtja në arrest, si dhe bazën ligjore të arrestit. Mbajtja në arrest nuk mund të zgjasë më shumë se 24 orë.

Urdhëri mbi mbajtjen në arrest i shqiptohet të pandehurit me nënshkrim.

Të pandehurit i cili është mbajtur në arrest pa vonesë i lejohet që për arrestimin ta njoftojë personin e zgjedhjes së vet, si dhe përfaqësuesin diplomatik-konzular të shtetit shtetas i të cilit është, gjegjësisht përfaqësuesin e organizatës ndërkombëtare adekuate nëse është në pyetje refugjati apo personi pa shtetësi apo avokatin, nëse avokati nuk ishte prezent gjatë dëgjimit të tij.

### **Mbajtja në arrest i personit nën ndikimin e alkoolit apo substancave tjera psikoaktive**

#### **Neni 193**

Personi nën ndikimin e alkoolit apo substancave tjera psikoaktive i gjetur në kryerjen e kundërvajtjes sipas urdhërit të gjykatës apo në bazë të vendimit të zyrtarit të autorizuar të policisë mund të mbahet në arrest nëse ekziston rreziku se do të vazhdojë të kryejë kundërvajtje.

Arrestimi i personit në rastin nga paragrafi 1 i këtij neni mund të zgjasë deri tek kthjellja e tij, e më së shumti 12 orë.

Nëse personi nga paragrafi 1 i këtij neni, është vozitës i automjetit dhe ka më shumë se 1,20 mg/ml alkool në gjak apo është nën ndikimin e mjeteve tjera dehëse, mbajtja në arrest është e domosdoshme.

Mbajtja në arrest është e domosdoshme edhe kur personi nga paragrafi 1 i këtij neni refuzon që t'i nënshtrohet testimit të pranisë së alkoolit apo mjeteve tjera dehëse.

Nëse është e mundur, në rastin nga paragrafi 1 i këtij neni gjyqtari do të njoftojë anëtarët e familjes së personit të arrestuar apo personat tjerë përgjegjës për kujdesjen ndaj të miturit nëse ndaj tij është caktuar mbajtja në arrest.

### **Kushtet për garancë**

#### **Neni 194**

Kur procedura kundërvajtëse është filluar kundër të pandehurit i cili nuk ka vendqëndrim të përhershëm në Republikën e Serbisë apo i cili përkohësisht qëndron jashtë shtetit, si dhe në disa raste tjera kur ekziston rreziku që me arratisje mund t'i shmanget përgjegjësisë për kundërvajtje, mund të kërkohet që ai vet apo dikush tjetër për të japë garancë që deri në fund të procedurës kundërvajtëse nuk do të ikë, dhe që vet i pandehuri premtion se nuk do të fshehet dhe se pa leje nuk do ta lëshojë vendqëndrimin e tyre.

Garanca nuk mund të caktohet para se i pandehuri të dëgjohet dhe as pa pajtimin e tij.

Kur e cakton garancën, gjykata e cila e udhëheq procedurën kundërvajtëse do të kërkojë nga i pandehuri që të caktojë avokatin e tij apo avokatin për pranimin e dokumenteve.

### **Përmbajtja dhe lartësia e garancës**

#### **Neni 195**

Garanca gjithmonë nënkupton shumën e parave.

Garanca përbëhet nga dhënia e parave të gatshme, letrave me vlerë, thesareve apo gjërave tjera lëvizëse të vlerës së madhe të cilat lehtë mund të shndërrohen në para dhe të ruhen, apo në obligimin personal të njërit apo më shumë qytetarëve që në rastin e arratisjes së të pandehurit do të paguajnë shumën e caktuar të garancës.

Lartësia e garancës caktohet deri tek shuma e dënimit më të lartë në para, të caktuar për kundërvajtje për të cilin zhvillohet procedura, e rritur për shpenzimet e pritura të procedurës kundërvajtëse.

Nëse kundër të pandehurit të njëjtë zhvillohet procedura për më shumë kundërvajtje, garanca do të caktohet në lartësinë e dënimit e cila mund të shqiptohet për kundërvajtjen në procedurë.

Në rastet nga paragrafi 3 dhe 4 i këtij neni, garanca mund të rritet për shumën e kërkesës pronëso-ro-juridike të të dëmtuarit.

Lartësinë e garancës e cakton gjyqtari i cili e zhvillon procedurën kundërvajtëse edhe atë në pajtim me peshën e kundërvajtjes, lartësinë e dëmit të shkaktuar, kushtet personale dhe familjare dhe gjendjen pronësore të të pandehurit.

### **Garanca për rastin e shkuarjes jashtë shtetit**

#### **Neni 196**

Nëse kundërvajtjen e ka bërë personi i cili nuk ka vendbanim në Republikën e Serbisë dhe dëshiron të lëshojë territorin e saj para hyrjes në fuqi të vendimit gjyqësor, në propozim të të pandehurit mund të caktohet garanca pavarësisht kushteve nga neni 194 paragrafi 1 i këtij ligji ku lartësia e garancës caktohet në shumën e dënimit më të lartë më gjorbë e cila mund të shqiptohet për kundërvajtje për të cilën zhvillohet procedura, e rritur për shumën e kërkesës pronëso-ro-juridike e të dëmtuarit dhe shpenzimet e pritura të procedurës kundërvajtëse.

### **Lëshimi i territorit të Republikës së Serbisë dhe garanca**

#### **Neni 197**

Nëse i pandehuri ikë apo lëshon territorin e Republikës së Serbisë, me vendim do të caktohet që vlera e dhënë si garancë do të futet si e hyrë në buxhetin e Republikës së Serbisë.

### **Veprimi me garancën**

#### **Neni 198**

Garanca ruhet, sipas rregullës, deri në marrjen e aktgjykimit të prerë.

Nëse është marrë aktgjykimi i prerë për lirim apo vendimi mbi ndalimin e procedurës kundërvajtëse është pushuar garanca e dhënë kthehet.

Nëse i dënuari sipas aktgjykimit të prerë nuk paguan dëmshpërblim apo shpenzimet e procedurës kundërvajtëse, shuma e caktuar do të paguhet nga garanca e dhënë, dhe nëse shuma e dhënë nuk mjafton, nga ajo së pari so të kompenzohet shuma e dëmit.

Nëse i dënuari nuk e paguan dënimin me gjobë, gjegjësisht shumën e caktuar të fitimit pronësor, pas pagesës së dëmit dhe shpenzimeve të procedurës kundërvajtëse do të paguhet dënimi me gjobë në tërësi, kurse për shumën e mbetur fitimi i caktuar pronësor.

Nëse i dënuari nuk e mban dënimin me burgim apo zbatimin të masës mbrojtëse, mbetja e garancës në tërësi do të ruhet dhe paguhet si e hyrë në buxhetin e Republikës së Serbisë.

### **Mbajtja e dokumentit personal**

#### **Neni 199**

Gjykata mund ta mbajë dokumentin e udhëtimit apo dokumentin tjetër të identifikimit të të pandehurit deri në përfundimin e aktgjykimit, nëse gjen se personi i dënuar vendbanimi i të cilit është jashtë shtetit mund ta pengojë zbatimin e aktgjykimit me shkuarjen nga territori i Republikës së Serbisë.

Mbajtjen e dokumentit gjykata e cakton në propozim të kërkesëbërësit apo sipas detyrës zyrtare.

Mbi mbajtjen e dokumentit jepet vërtetimi.

## **Kreu XXII DËGJIMI I TË PANDEHURIT**

### **Mënyra e dëgjimit**

#### **Neni 200**

I pandehuri dëgjohe sipas rregullës gojarisht.

I pandehuri mund të dëgjohe në mungesë të avokatit nëse avokati mungon pa arsye edhe pse është njoftuar për dëgjimin apo nëse për dëgjimin e parë i pandehuri nuk ka siguruar avokat dhe nëse i pandehuri deklaron se mbrojtjen do ta japë pa avokat.

Deklaratat e të pandehurit mbi arsyet e mungesës së avokaktit futen në procesverbal.

Nëse i pandehuri deklaron se nuk ka qenë i paralajmëruar për të drejtën që të marrë avokat sipas zgjedhjes së tij apo të dëgjohe në prani të avokatit, atëherë nuk mund të bazohet vendimi.

Kur i pandehuri dëgjohe për herë të parë, do të pyetet për emrin, nëse e ka, emrin personal të njërit prind, vendin dhe datën e lindjes, numrin personal të qytetarit, shtetësinë, profesionin, adresën e banimit dhe punës, adresën e postës elektronike, kushtet familjare, shkallën e arsimimit, gjendja pronësore, numrin e llogarisë në dinarë dhe llogarisë devizore, a ka qenë i gjykuar më parë apo i dënuar dhe për çfarë, a është dukë u zhvilluar procedurë penale apo kundërvajtëse kundër tij dhe për cilën vepër, dhe nëse është i mitur kush është përfaqësuesi i tij ligjor.

Për dhënien e të dhënave të pasakta dhe të paplota nga paragrafi 5 i këtij neni gjykata mund ta dënojë të pandehurin më gjatë deri në 50.000 dinarë.

Nëse pas vendimit mbi dënimin nga paragrafi 6 i këtij neni i pandehuri jep të dhëna të sakta gjyqtari mund ta anulojë vendimin mbi dënimin.

Pas marrjes së të dhënave personale, të pandehurit do t'i lexohet se për çfarë akuzohet dhe do të thirret që të tregojë gjithë atë që ka në mbrojtje të tij.

Gjatë dëgjimit të pandehurit do t'i mundësohet që në deklaratë të papenguar të shprehet për të gjitha rrethanat të cilat e ngarkojnë dhe të deklarojë të gjitha faktet të cilat i shërbejnë për mbrojtje.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron të përgjigjet apo nuk dëshiron të përgjigjet në pyetjen e caktuar, do të njoftohet së në atë mënyrë mund të vështirësojë grumbullimin e fakteve për mbrojtjen e vet.

Kur i pandehuri mbaron deklaratën, do t'i shtrohen pyetje nëse është e nevojshme që të plotësohen zbrazëirat apo të hiqen kontradiktat dhe paqartësitë në deklaratën e tij.

Dispozitat mbi dëgjimin e të pandehurit do të aplikohen gjatë dëgjimit të personit përgjegjës të personit juridik dhe ndërmarrësit.

### **Dëgjimi i përfaqësuesit të personit juridik të pandehur**

#### **Neni 201**

Kur përfaqësuesi i personit juridik të pandehur dëgjohe për herë të parë, do të pyetet për emrin dhe qendrën e personit juridik të pandehur, emrin personal të përfaqësuesit dhe funksionin, gjegjësisht punët të cilat i kryen në personin juridik, numrat e llogarive punuese të personit juridik, PIB dhe numrin amë të personit juridik, dhe a është gjykuar personi juridik për vepër penale, shkelje tregtare apo kundërvajtje.

Dispozitat mbi dëgjimin e të pandehurit do të aplikohen gjatë dëgjimit të përfaqësuesit të personit juridik të pandehur.

### **Respektimi i personalitetit të të pandehurit**

#### **Neni 202**

I pandehuri dëgjohe me respekt të plotë të personalitetit të tij.

Ndaj të pandehurit nuk guxon të përdoret dhuna, kërcënimi, mashtrimi, premtimi, zhvatja, shtrëngimi apo mjetet tjera të ngjashme në mënyrë që të arrihet deri te deklaratata e tij apo pranimi apo ndonjë vepër tjetër e cila do të mund të përdorej kundër tij si dëshmi.

### **Mbrojtja me shkrim**

#### **Neni 203**

Nëse gjykata gjen se dëgjimi i drejtpërdrejt gojor nuk është i nevojshëm duke marrë parasysh rëndësinë e kundërvajtjes dhe të dhënat me të cilat disponon, në thirrje mund të udhëzohet i pandehuri që mbrojtjen e tij mund ta japë në formë të shkruar. Në atë rast i pandehuri mbrojtjen e vet mund të japë në formë të shkruar apo personalisht të paraqitet që të dëgjohej.

### **Ndihma ligjore**

#### **Neni 204**

Kur i pandehuri ka vendbanim apo vendqëndrim jashtë territorit të gjykatës para së cilit zhvillohet procedura, në kërkesë të asaj gjykateje, mund të dëgjohej edhe para gjykatës në territorin e së cilës i pandehuri ka vendbanim apo vendqëndrim.

### **Përballja**

#### **Neni 205**

I pandehuri mund të përballlet me dëshmitarin dhe bashkëvepruesin tjetër nëse deklaratat e tyre nuk përputhen në pikëpamjen e fakteve të rëndësishme dhe nëse ky mospajtim nuk mund të eliminohet në mënyrë tjetër.

Të përballurit do të vendosen njëri ndaj tjetrit dhe nga ata do të kërkohet që njëri tjetrit t'ia përsërisin deklaratat e tyre mbi çdo rrethanë kontestuese dhe të diskutojnë mbi saktësinë e deklaratave të tyre. Rrjedha e përballjes dhe deklaratat me të cilat të përballurit kanë mbetur, gjykata do ti fusë në procesverbal.

### **Dëgjimi përmes intepretuesit dhe përkthyesit**

#### **Neni 206**

Nëse i pandehuri është i shurdhër, do t'i shtrohen pyetje në formë të shkruar, dhe nëse është memec, do të ftohet që të japë përgjigje me shkrim. Nëse dëgjimi nuk mund të realizohet në atë mënyrë, do të ftohet si interpretues personi i cili mund të kuptohet më të pandehurin.

Nëse i pandehuri nuk e kupton gjuhën e procedurës, do t'i shtrohen pyetje përmes përkthyesit.

## **Kreu XXIII DËGJIMI I DËSHMITARËVE**

### **Cilësia e dëshmitarit**

#### **Neni 207**

Si dëshmitarë ftohet personat për të cilët është e sigurtë se mund të japin informacione mbi kundërvajtjen dhe vepruesin si dhe për rrethana tjera të rëndësishme.

I dëmtuari mund të dëgjohej si dëshmitar.

### **Detyra e dëshmisë**

#### **Neni 208**



Secili person i cili ftohet si dëshmitar është i detyruar që t'i përgjigjet ftesës, dhe nëse me këtë ligj nuk është caktuar dhe nëse me këtë ligj nuk është caktuar ndryshe, është i detyruar edhe të dëshmojë.

### **Thirrja e dëshmitarit**

#### **Neni 209**

Dëshmitarit i dërgohet ftesë e shkruar, në të cilën shënohet emri personal dhe profesioni i të ftuarit, koha dhe vendi i ardhjes, lënda kundërvajtëse për të cilën ftohet, shënimi që ftohet si dëshmitar dhe paralajmërimi mbi pasojat e mosardhjes së paarsyeshme.

Dëshmitari ftohet përmes palës e cila ka propozuar dëshminë e tij, dhe nëse kjo nuk është e mundur gjykata do ta ftojë drejtpërdrejt.

Kur i dëmtuari ftohet si dëshmitar, në ftesë do të shënohet kjo.

Personi i mitur i cili nuk i ka mbushur gjashtëmbëdhjetë vjet ftohet që si dëshmitar përmes përfaqësuesit ligjor, gjegjësisht kujdestarit, përveç se nëse kjo nuk është e mundur për shkak të nevojës së të veprohet urgjentisht apo për shkak të rrethanave tjera.

Dëshmitarët të cilët për shkak të moshës, sëmundjes apo mangësive të rënda trupore nuk mund t'i përgjigjen ftesës, mund të dëgjohen në shtëpinë e tyre.

### **Ndalimi i dhënies së dëshmisë**

#### **Neni 210**

Nuk mund të dëgjohet si dëshmitar:

- 1) personi i cili me deklaratën e vet do të shkelte detyrën e ruajtjes së sekretit zyrtar apo ushtarak, deri sa organi kompetent të mos e lirojë nga ajo detyrë;
- 2) avokati i të pandehurit mbi atë që ia ka treguar në besim i pandehuri, përveç se në rastin kur këtë e kërkon i pandehuri.

### **Lirimi nga detyra e dhënies së dëshmisë**

#### **Neni 211**

Janë të liruar nga dhënia e dëshmisë:

- 1) bashkëshorti i të pandehurit;
- 2) familjarët e të andehurit në lidhje gjaku, familjarët në vijën anësore deri në shkallën e tretë, si dhe familjarët sipas ligjit, deri në shkallën e dytë;
- 3) i adoptuari dhe adoptuesi;
- 4) i besuari fetar mbi atë që ia ka thene në besim i pandehuri.

Gjyqtari i cili e zhvillon procedurën kundërvajtëse është i detyruar që personat nga paragrafi 1 i këtij neni, para dëgjimit të tyre apo pasi të kuptojë raportin e tyre me të pandehurin, t'i njoftojë që nuk duhet të japin dëshmi. Njoftimi dhe përgjigja futen në procesverbal.

Personi i mitur i cili duke pasur parasysh moshën dhe zhvillimin shpirtëror nuk është i aftë që të kuptojë rëndësinë e së drejtës që të mos dëshmojë nuk mund të dëgjohej si dëshmitar, përveç se në rastin kur i pandehuri e kërkon vet këtë.

Personi i cili ka baza që të ndërpresë dëshminë ndaj njërit nga të pandehurit, është i liruar nga dhënia e dëshmisë dhe ndaj të pandehurve tjerë nëse deklarata e tij ndaj natyrës së gjërave nuk mund të kufizohet vetëm në të akuzuarit tjerë.

## **Pasoja e shkeljes së rregullave mbi dhënien e dëshmisë**

### **Neni 212**

Nëse si dëshmitar është dëgjuar personi i cili nuk mund të dëgjohej si dëshmitar (neni 210) apo personi i cili është liruar nga detyra e dëshmisë (neni 211), por nuk është njoftuar për këtë apo nuk ka hequr dorë nda ajo e drejtë, apo nëse njoftimi apo heqja dorë nuk është futur në procesverbal, apo nëse është dëgjuar i mituri i cili nuk mund të kuptojë rëndësinë e së drejtës që nuk duhet të dëshmojë, ose nëse deklarata e dëshmitarit është marrë me dhunë, kërcënim apo mjet tjetër të ndaluar, në aso deklarate nuk mund të bazohet vendimi.

## **Mospërgjigja në pyetje të caktuara**

### **Neni 213**

Dëshmitari nuk është i detyruar që të përgjigjet në pyetje të caktuara nëse është e mundur që në atë mënyrë do ta vendoste veten apo ndonjë të afërm në turp të madh, dëm të madh material apo ndjekje penale.

## **Mënyra e dëgjimit të dëshmitarit**

### **Neni 214**

Dëshmitari dëgjohej para gjykatës e cila zhvillon procedurën kundërvajtëse, dhe nëse dëshmitari ka vendbanim gjegjësisht vendqëndrim jashtë territorit të saj, mund të dëgjohej para gjykatës, në territorin e të cilës dëshmitari ka vendbanim gjegjësisht vendqëndrim.

Dëshmitarët dëgjohej veçmas dhe pa praninë e dëshmitarëve tjerë.

Dëshmitari është i detyruar që deklaratën dhe përgjigjet në pyetjet e shtruara t'i japë gojarisht.

Dëshmitari paraprakisht do të paralajmërohet se është i detyruar të flasë të vërtetën dhe nuk guxon të mbajë fshehtë asgjë, dhe pastaj do të paralajmërohet se dhënia e dëshmisë së rrejshme paraqet vepër penale.

Dëshmitari do të paralajmërohet edhe se nuk është i detyruar të dëshmojë nëse ekzistojnë rrethana nga neni 211 i këtij ligji, dhe ky paralajmërim do të futet në procesverbal.

Gjatë dëgjimit dëshmitari së pari pyetet për emrin personal, emrin personal të një prindi, moshën, vendin e lindjes, vendbanimin, porfesionin dhe raportin e tij me të pandehurin dhe të dëmtuarin.

Pas pyetjeve të përgjithshme dëshmitari do të ftohet që të flasë për gjithçka që është e njohur për të nga lënda, e pastaj do t'i shtrohen pyetje me qëllin të vërtetimit, plotësimit dhe sqarimit.

Dëshmitari gjithmonë do të pyetet prej nga i ka të njohura gjërat për të cilat dëshmon.

Nëse dëshmitari është shurdh apo memec, do të dëgjohej në mënyrën e paraparë në nenin 206 të këtij ligji.

Nëse nuk e kupton gjuhën në të cilën zhvillohet procedura, dëshmitari dëgjohej në prani dhe me ndihmën e përkhtyesit i cili e njeh gjuhën të cilën e flet dëshmitari.

## **Ballafaqimi i dëshmitarëve**

### **Neni 215**

Dëshmitarët mund të përbyllen nëse deklaratat e tyre nuk përputhen me pikëpamjen e fakteve të rëndësishme. Të ballafaqarit do të flasin veçmas për secilën rrethanë e cila nuk përputhet në deklaratat e tyre dhe përgjigja e tyre do të futet në procesverbal.

Në të njëjtën kohë mund të përballen vetëm dy dëshmitarë.  
Në përballjen e dëshmitarëve aplikohen dispozitat e nenit 205 paragrafi 2 i këtij ligji.

Personi i mitur i cili nuk i ka mbushur katërbëdhjetë vjet, dhe i cili dëgjohej si dëshmitar, nuk mund të përballlet me të pandehurin dhe dëshmitartin tjetër.

Personi i mitur më i madh se katërbëdhjetë vjet, dhe më i ri se tetëmbëdhjetë vjet, i cili dëgjohej si dëshmitarë, nuk mund të përballlet me të pandehurin dhe dëshmitarin tjetër nëse për shkak të natyrës së kundërvajtjes, pasojave dhe rrethanave tjera ky person është shumë i ndieshëm apo gjendet në gjendje psikike shumë të rëndë.

## **Mosardhja dhe refuzimi i dhënies së dëshmisë**

### **Neni 216**

Nëse dëshmitari i cili është ftuar në mënyrë të rregullt nuk vjen, kurse mungesën e tij nuk e arsyeton, apo pa leje apo arsye largohet nga vendi ku është dashur të dëgjohej, mund të urdhërohet që të sillet detyrimisht, dhe mund të dënohet me gjobë prej 10.000 deri 50.000 dinarë.

Nëse personi zyrtar i organit kompetent i cili ka bërë kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse nuk i përgjigjet thirrjes së gjykatës që të dëgjohej në cilësinë e dëshmitarit, dhe mungesën e tij nuk e arsyeton, gjykata mund të heqë dorë nga dëgjimi i tij.

Dispozitat mbi sjelljen e të pandehurit (neni 188) njëjtë zbatohen edhe në sjelljen e dëshmitarit.

Nëse dëshmitari pas njoftimit mbi pasojat e refuzimit të dhënies së dëshmisë nuk dëshiron të dëshmojë pa arsye ligjore, mund të dënohet me gjobë deri në 10.000 dinarë, dhe nëse edhe pas kësaj refuzon të dëshmojë, mund të dënohet me gjobë deri në 50.000 dinarë.

Vendimi mbi dënimin me gjobë të dëshmitarit futet në procesverbal.

Ankesa më vendimin mbi dënimin me gjobë nuk ndalon zbatimin e vendimit.

Nëse dëshmitari pranon që të dëshmojë menjëherë pas shqiptimit të dënimit me gjobë, dënimi do të anulohet.

Nëse për arsyet nga parag. 1 dhe 3 të këtij neni janë shkaktuar shpenzime procedurale, dëshmitari mund të detyrohet që t'i bartë shpenzimet.

Në rast se personi i dënuar nuk e paguan dënimin me gjobë dhe shpenzimet e procedurës, do të detyrohet t'i paguajë.

## Kreu XXIV INSPEKTIMI DHE EKSPERTIZA

### **Inspektimi**

#### **Neni 217**

Nëse për vërtetimin apo sqarimin e ndonjë fakti të rëndësishëm është e nevojshme vërejtja e drejtpërdrejt e gjyqtarit i cili zhvillon procedurë kundërvajtëse, në propozim të palëve do të bëhet inspektimi.

Me përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni gjykata sipas detyrës zyrtare mund të bëjë inspektimin, nën kushtin nga neni 89 paragrafi 5 i këtij ligji.

Inspektimi mund të kryhet në praninë e ekspertëve.

Gjyqtari i cili e zhvillon procedurën do të caktojë se cilat persona do t'i ftojë që të marrin pjesë në inspektim.

Për inspektimin mbahet procesverbal. Në procesverbal shënohet emri i gjykatës, gjegjësisht organit i cili e bën inspektimin, të dhënat mbi personat e pranishëm, rezultatet e inspektimit dhe fajteve tjera të rëndësishme.

### **Ekspertiza**

#### **Neni 218**

Ekspertiza caktohet në propozim të palës kur për vërtetim apo vlerësim të ndonjë fakti të rëndësishëm është e domosdoshme që të sigurohen rezultati dhe mendimi nga personat të cilët disponojnë me njohuri profesionale, me të cilën gjykata nuk disponon.

Me përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni gjykata mund të caktojë ekspertizën sipas detyrës zyrtare, nën kushtin nga neni 89 paragrafi 5 i këtij ligji.

Ekspertizën e cakton me urdhër të shkruar gjykata e cila zhvillon procedurën kundërvajtëse. Në urdhër do të shënohet se në bazë të cilave fakte bëhet ekspertiza dhe kujt i besohet. Sipas rregullës caktohet një ekspert, dhe nëse ekspertiza është e ndërlikuar, dy apo më shumë ekspertë.

Ekspertiza mund t'i besohet entit adekuat profesional, organit shtetror apo ekspertit, fillimisht nga lista e ekspertëve gjyqësor të përhershëm, dhe organet tjera apo personat mund të caktohen vetëm nëse ekziston rreziku nga vonesa, nëse ekspertët e përhershëm janë të penguar apo nëse këtë e kërkojnë rrethanat tjera.

Të pandehurit dhe të dëmtuarit do t'i shqiptohet emri i ekspertit në kërkesë të tyre.

### **Personat të cilët nuk mund të jenë ekspertë**

#### **Neni 219**

Për ekspert nuk mund të merret personi i cili nuk mund të dëgjohet si dëshmitar (neni 210) apo personi i cili është liruar nga detyra e dhënies së dëshmisë (neni 211), dhe as personi i dëmtuar me anë të kundërvajtjes, dhe nëse personi i tillë është marrë për ekspert, në rezultatit dhe mendimin e tij nuk mund të bazohet aktgjykimi.

### **Kërkesa për përjashtimin e ekspertit**

#### **Neni 220**

Palët mund të kërkojnë përjashtimin e ekspertit për arsye të rregulluara në nenin 112 të këtij ligji.

### **Rrjedha e ekspertizës**

#### **Neni 221**

Para fillimit të ekspertizës do të ftohet eksperti që ta shqyrtojë me kujdesë lëndën e ekspertizës, që saktë të shënojë të gjitha ato që i vëren de gjenë dhe të japë mendimin e tij të paanshëm dhe në pajtim me rregullat e shkencës dhe aftësisë. Ai posaçërisht do të paralajmërohet se dhënia e deklaratës së rrejshme paraqet vepër penale.

#### **Neni 222**

Ekspertit mund t'i jepen sqarime shtesë, kurse sipas nevojës do të njoftohet me gjendjen në shkresa. Sipas propozimit të bazuar të ekspertit mund të paraqiten prova të reja në mënyrë që të vërtetohen rrethanat e rëndësishme për ekspertizën.

Eksperti shikon lëndët e ekspertizën në prani të gjykatësit i cili zhvillon procedurën kundërvajtëse dhe procesmbajtësit, përveç se në rastin kur për ekspertizë janë të nevojshme studime më të gjata ose hulumtimet të bëhen në ente gjegjësisht organin shtetëror.

Nëse dyshohet në aftësinë mendore të të pandehurit, do të caktohet ekspertiza psikiatrike me anë të kontrollimit në entin shëndetësor.

### **Rezultati dhe mendimi i ekspertit**

#### **Neni 223**

Eksperti jep gjetjen dhe mendimin e tij, sipas rregullës, në formë të shkruar brenda afatit të cilit e cakton gjykata.

Nganjëherë, ekspertit mund t'i lejohet që gjetjen dhe mendimin e tij ti japë gojarisht në procesverbal. Mospajtimi dhe paqartësitë në gjetjen dhe mendimin e ekspertit do të eliminohen me dëgjimin e tij apo përsëritjen e ekspertizës përmes ekspertit të njëjtë apo tjetër.

Palëve në procedurë do t'i dorëzohet gjetja e shkruar dhe mendimi i ekspertit rreth të cilit mund të deklarohen brenda afatit prej 15 ditëve.

### **Dënimi i ekspertit**

#### **Neni 224**

Personi i cili ftohet si ekspert është i detyruar që t'i përgjigjet thirrjes dhe të japë gjetjen dhe mendimin e tij.

Nëse eksperti i cili është ftuar në mënyrë të rregullt nuk i përgjigjet ftesës dhe nuk e arsyeton mosardhjen e tij apo nëse pa arsye refuzon të bëjë ekspertizën, mund të urdhërohet që të kompenzojë shpenzimet e shkaktuara, dhe mund të dënohet me gjobë prej 10.000 deri 50.000 dinarë.

Vendimi mbi dënimin futet në procesverbal, kurse vendimi i shkruar mbi dënimin i dërgohet ministrisë kompetente për punët e drejtësisë.

Ankesa kundër dënimit të ekspertit nuk e shtyen zbatimin e vendimit.

Në rast se eksperti nuk paguan dënimin e shqiptuar me gjobë, do të jetë i detyruar që ta paguajë.

#### **Neni 225**

Dispozitat e këtij ligji të cilat kanë të bëjnë me ekspertët aplikohen njëjtë edhe për interpretuesit.

### **Kreu XXV**

## **KONTROLLIMI I HAPËSIRAVE DHE PERSONAVE**

### **Bazat e kontrollimit**

#### **Neni 226**

Banesa dhe hapësirat tjera, si dhe personat mund të kontrollohen nëse është e sigurtë që në banesë, hapësirat tjera, gjërat apo tek personat e caktuar do të gjenden sende apo shenja të cilat do të mund të ishin të rëndësishëm procedurën kundërvajtëse, apo me anë të kontrollimit të banesës apo hapësirave tjera do të gjendet i pandehuri.

Kontrollimi i personave, hapësirave dhe gjërave të cilat i takojnë personave të cilët gëzojnë imunitet sipas te drejtës ndërkombëtare, nuk është i lejuar.

### **Urdhëri për kontrollim**

#### **Neni 227**

Kontrollimi caktohet me urdhër të shkruar të gjykatës.

Urdhëri mbi kontrollimin i dorëzohet, para fillimit të kontrollimit, personit tek i cili apo të cilit do t'i bëhet kontrollimi. Para kontrollimit do të ftohet personi me të cilin ka të bëjë urdhëri për kontrollim, që vullnetarisht të dorëzojë personin gjegjësisht gjërat të cilat kërkohen.

Urdhërin për kontrollim e zbaton policia.

## **Mënyra e kontrollimit**

### **Neni 228**

Në kontrollim marrin pjesë dy qytetarë të moshës madhore.

Pronari i banesës apo hapësirës do të ftohet që të marrë pjesë në kontrollim, dhe nëse ai mungon, do të ftohet që të marrë pjesë në kontrollim njëri nga anëtarët e rritur të shtëpisë apo fqiu.

Kontrollimi në hapësirat e personave juridik mund të bëhet vetëm me praninë e përfaqësuesit të atij personi juridik.

Kontrollimin e personave e bëjnë dhe në cilësi të dëshmitarëve marrin pjesë personat e gjinisë së njëjtë dhe personi i cili kontrollohet.

Hapësirat e mbyllura, mobiljet dhe gjërat tjera do të hapen me dhunë vetëm nëse mbajtësi i tyre apo avokati nuk është prezent apo nuk dëshiron t'i hapë vullnetarisht. Në këtë mënyrë do të shmanget dëmtimi i panevojshëm.

## **Procesverbali mbi kontrollimin**

### **Neni 229**

Për secilin kontrollim të banesës gjegjësisht personit, do të përpilohet procesverbali në të cilin do të shkruhet urdhëri në bazë të të cilit realizohet kontrollimi, përshkrimi i hapësirës gjegjësisht personit i cili kontrollohet gjegjësisht objektit apo shenjave që janë gjetur.

Procesverbalin e nënshkruan personi tek i cili është bërë kontrollimi apo i cili është kontrolluar dhe personi prania e të cilit është e detyruar.

Personit tek i cili është bërë kontrollimi, apo i cili është kontrolluar, do t'i jepet kopja e procesverbalit.

## **Veprimi me gjërat e gjetura**

### **Neni 230**

Nëse gjatë kontrollimit gjendejt gjëra të cilat janë përdorur për kryerjen e kundërvajtjes apo janë siguruar përmes kundërvajtjes, apo gjërat të cilat mund të shërbejnë si provë në procedurën kundërvajtëse, ato gjëra do të merren përkohësisht.

## **Marrja e përkoshme e gjërave**

### **Neni 231**

Gjërat të cilat mund të merren sipas këtij ligji mund të merren përkohësisht edhe para marrjes së aktgjykimit.

Marrja e përkoshme e gjërave caktohet nga gjykata me urdhër të shkruar. Urdhëri përmbanë arsyetim të shkurtër për marrjen e përkoshme të gjërave.

Me ligj mund të autorizohen edhe persona zyrtar të organeve inspektuese, zyrtarë të shërbimit doganor dhe zyrtarë të autorizuar të policisë që përkohësisht të marrin gjërat nga paragrafi 1 i këtij neni kur në kryerjen e detyrës zyrtare kuptojnë për kundërvajtjen. Organet e cekura janë të detyruar që ta informojnë gjykatën mbi marrjen e përkohshme të gjërave dhe të kujdesen për ato gjëra, nëse me ligj nuk është caktuar ndryshe.

Personi nga i cili merren gjërat i dorëzohet urdhëri dhe i lëshohet vërtetimi më shënimin e saktë të gjërave të marra.

Nëse është fjala për gjërat të cilat mund të prishen apo nëse ruajtja e tyre kërkon shpenzime të mëdha, gjykata do të caktojë që ato gjëra të shiten, kurse paratë e marra të dorëzohen për ruajtje në bankë apo organizatë tjetër financiare.

## **Veprimi me gjërat e marra përkohësisht**

### **Neni 232**

Gjërat e marra përkohësisht, gjegjësisht paratë e fituara nga shitja e gjërave do t'i kthehen pronarit pas përfundimit të procedurës kundërvajtëse me aktgjykim, me të cilin i pandehuri shpallet përgjegjës, përveç se kur këtë e kërkojnë intereset e sigurisë së përgjithshme apo arsyet e moralit, mbi të cilat gjykata do të marrë vendim të posaçëm.

Nëse nuk dihet pronari, dhe brenda afatit prej një viti të shpalljes askush nuk lajmërohet për objektin, gjegjësisht për paratë e fituara nga shitja e objektit, do të merret vendimi që objekti të bëhet pronë publike, apo që paratë të futen në buxhetin e Republikës së Serbisë. Me këtë vendim nuk shkelet e drejta e pronarit që në seancën gjyqësorë të realizojë të drejtat e tij pronësore.

## **Kreu XXVI**

## **MARRËVESHJA MBI PRANIMIN E FAJËSISË**

### **Arritja e marrëveshjes**

### **Neni 233**

Kur procedura për kundërvajtje udhëhiqet për një kundërvajtje apo për më shumë kundërvajtje në rastësishme, parashtruesi i autorizuar i kërkesës, me gojë apo me mënyrë të shkruar mund t'i propozojë të pandehurit apo mbrojtësit të tij konkludimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë (në tekstin e mëtutjeshëm: marrëveshja mbi pranimin), përkatësisht i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund që parashtruesit të autorizuar të kërkesës t'i propozojë konkludimin e kësaj marrëveshje.

Kur dërgohet propozimi nga paragrafi 1 i këtij neni, palët apo mbrojtësi mund të negociojnë rreth kushteve të pranimit të fajësisë për të cilën i pandehuri ngarkohet.

Marrëveshja mbi pranimin e fajit mund të konkludohet dhe t'i dërgohet gjykatës deri në marrjen e vendimit të shkallës së parë.

Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë nuk mund të konkludohet në lidhje me kundërvajtjen e për të cilën lëshohet urdhëri për kundërvajtje.

### **Përmbajtja e marrëveshjes**



## **Neni 234**

Marrëveshja mbi pranimin përmban:

- 1) përshkrimi i kundërvajtjes për të cilin i pandehuri ngarkohet;
- 2) pranimi i të pandehurit që ka kryer kundërvajtje nga pika 1 e këtij paragrafi;
- 3) marrëveshja mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, përkatësisht rreth sanksioneve tjera kundërvajtjese;
- 4) deklaratën e parashtruesit të autorizuar rreth tërheqjes nga ndjekja ligjore për kundërvajtjet të cilat nuk janë të përfshira në marrëveshjen e pranimi;
- 5) marrëveshja mbi harxhimet e procedurës për kundërvajtje, rreth konfiskimit të fitimit të pronës të siguruar përmes kundërvajtjes, mbi kthimin e lëndës së kundërvajtjes dhe kërkesës ligjore të pronës, po nëse është paraqitur;
- 6) deklaratën mbi dorëheqjen e palëve dhe mbrojtësve nga e drejta në ankesë kundër vendimit të gjykatës të sjellur në bazë të pranimi të marrëveshjes mbi fajësinë;
- 7) nënshkrimi i palëve dhe mbrojtësve.

Në marrëveshjen e pranimi parashtruesi i autorizuar i kërkesës dhe i pandehuri mund të deklarojnë rreth shqiptimit të dënimit i cili nuk mund të jetë nën minimumin të përcaktuar në ligjin 39, paragrafi 1, i këtij ligji.

I pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës mund të mirren vesh që masat mbrojtëse të përcaktuara për kundërvajtje për të cilën ngarkohet i pandehuri, të shqiptohen në formën e vogël apo të mos shqiptohen.

## **Vendosja për marrëveshjen**

### **Neni 235**

Për marrëveshjen mbi pranim vendos gjykata, të cilën marrëveshje mund ta hedhë poshtë, ta miratojë apo ta refuzoj.

Gjykata marrëveshjen për pranim e hedhë poshtë po nëse është dorëzuar pas marrjes së vendimit të shkallës së parë. Kundër vendimit mbi hedhjen poshtë të marrëveshjes mbi pranim, ankesa nuk është e lejuar.

## **Vendimi mbi marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë**

### **Neni 236**

Gjykata me aktgjykim do të miratojë marrëveshjen mbi pranim, po nëse në bazë të marrëveshjes vërtetohet:

- 1) se i pandehuri me vetëdije dhe vullnet pranon kundërvajtjen, përkatësisht kundërvajtjet të cilat janë lëndë e kërkesës dhe kur është hequr mundësia e pranimi të pandehurit në hamendje;

2) se marrëveshja është arritur në përputhje me rregullat e nenit 234 të këtij ligji;

3) se i pandehuri plotësisht është i vetëdijshëm për të gjitha pasojat e marrëveshjes së arritur, ndërsa posaçërisht që plotësisht të kuptoj se me marrëveshjen hiqet dorë nga e drejta në gjykim dhe dorëzimin e ankesës kundër aktgjyqimit të gjykatës të arritur në bazë të vendimit mbi miratimin e marrëveshjes;

4) që me marrëveshjen mbi pranim nuk janë shkelur të drejtat e të dëmtuarit.

Kur nuk është plotësuar një apo më shumë kushte nga ky nen, gjukata do të sjell vendim me të cilin rrefuzohet marrëveshja mbi pranim. Pranimi i të pandehurit i dhënë në marrëveshje i cili nga gjykata nuk është njohur, nuk mund të jetë fakt në procedurën penale.

Kur vendimi nga paragrafi i mëparshëm i këtij ligji behët i plotëfuqishëm, marrëveshja dhe të gjitha shkresat të cilat janë të lidhura, ndahen në shkresa të veçanta dhe anulohen pranë gjykatës, rreth të cilës përpilohet shënim zyrtar në këtë lëndë të posaçme.

Vendimi i gjykatës rreth marrëveshjes mbi pranim i dorëzohet parashtruesit të autorizuar të kërkesës dhe të pandehurit, përkatësisht mbrojtësit po nëse ka.

### **Ankesa kundër vendimit mbi marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë**

#### **Neni 237**

Kundër vendimit të gjykatës mbi rrefuzimin e marrëveshjes mbi pranim, ankesën në afat prej tetë ditëve nga dita kur vendimi iu është dorëzuar, mund ta dërgojnë tek parashtruesi i kërkesës dhe mbrojtësi i tij.

Kundër aktgjyqimit të gjykatës mbi miratimin e marrëveshjes së pranimit nuk lejohet ankesa.

### **Aktgjykimi mbi miratimin e marrëveshjes mbi pranimin e kundërvajtjes**

#### **Neni 238**

Me aktgjykim me të cilin miratohet marrëveshja mbi pranim, gjykata të pandehurin e deklaron përgjegjës dhe i shqipton denimin, përkatësisht saksionin e dytë kundërvajtjes dhe vendos për të gjitha çështjet të parapara në marrëveshjen mbi pranim.

Aktgjykimi duhet t'i përshtatet përmbajtjes së marrëveshjes mbi pranim dhe duhet të përmbaj edhe të dhënat nga neni 251, i këtij ligji.

Aktgjykimi nga paragrafi 1, i këtij ligji i dorëzohet personave nga neni 256 i këtij ligji. Po nëse marrëveshja mbi pranim është paraparë tërheqja e parashtruesit të autorizuar të kërkesës nga ndjekja kundërvajtëse për kundërvajtjet të cilat nuk janë të përfshira në marrëveshjen mbi pranim, gjykata në bazë atyre kundërvajtjeve sjellë aktgjykimin nga neni 253, i këtij ligji.

## **Kreu XXVII BASTISJA**

### **Përcaktimi i bastisjes**

## **Neni 239**

Bastisja caktohet kur gjykata vlerëson se ajo është e nevojshme për arsye të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike.

Në bastisje ftohet i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, i dëmtuari, parashtruesi i kërkesës për nisjen e procedurës dhe pjesëtarët tjerë të procedurës. Po nëse i pandehuri është person juridik në bastisje ftohet përfaqësuesi i personit juridik.

Në ftesën për bastisje i pandehuri do të paralajmrohet se në rast të mos përgjigjes së ftesës do të urdhërohet arrestimi i tij.

Po nëse në bastisje nuk vjen rregullisht i pandehuri dhe mosardhjen e tij nuk e arsyeton, gjykata do të shtyjë bastisjen dhe do të jap urdhër për arrestim, po nëse nuk egzistojnë kushtet që bastisja të bëhet edhe pa prezencën e të pandehurit.

## **Mosardhje e të pandehurit**

### **Neni 240**

Gjykata mund të vendos që bastisja të mbahet në mungesën e të pandehurit i cili në mënyrë të rregullt është ftuar po nëse ai është dëgjuar, ndërsa gjen se prania e tij nuk është e nevojshme për konfirmimin të drejtë të gjendjes faktike.

Nën të njëjta kushte bastisja mund të mbahet edhe në munges të përfaqësuesit që është ftuar në mënyrë të rregullt, përkatësisht mbrojtësit të personit juridik të akuzuar.

Bastisja mund të kryhet pa praninë e parashtruesit të kërkesës.

Bastisja do të kryhet po nëse nuk vjen në mënyrë të rregullt mbrojtësi i të pandehurit i cili mosardhjen nuk e arsyeton, ndërsa i pandehuri me këtë është dakorduar.

## **Publiku**

### **Neni 241**

Bastisja është publike.

Gjykata mund ta përjashtoj publikun për tërë bastisjen apo njërën pjesë të saj po nëse këtë e kërkojnë interesat e përgjithshme apo arsyet morale.

Po nëse procedura udhëhiqet kundër personit të mitur, bastisja do të kryhet pa pjesëmarrjen e publikut.

Në rastin nga paragrafi 2 dhe 3, i këtij ligji gjykata do të paralajmroj personat të cilët marrin pjesë në bastisje në të cilin publiku është përjashtuar, se janë të detyruar që si sekret të ruajnë të gjithë atë që në bastisje e kanë mësuar dhe të tregojnë zbulimi i sekreteve paraqet vepër penale.

## **Rrjedha e bastisjes**

### **Neni 242**

Gjykata pikë sëpari kryen verifikimin e pjesëmarrjes së të ftuarve dhe vërtetimin e identitetit të tyre.

Bastisja fillon me paraqitjen e përmbajtjes së kërkesës për nisjen e procedurës për kundërvajtje, pas së cilës vazhdon ndëgjimi i të pandehurit. Po nëse i pandehuri është person juridik dhe personi përgjegjës në personin juridik, sëpari ndëgjohe përfaqësuesi i personit juridik, ndërsa pas tij edhe personi përgjegjës. Dëshmitarët nuk mund të marrin pjesë në dëgjimin e pandehurit, përfaqësuesit të personit juridik, ndërsa pas tij personi përgjegjës. Pas dëgjimit të të pandehurit kalohet në sjelljen e fakteve me dëgjimin dëshmitarëve dhe ekspertëve dhe paraqitjen e provave tjera.

Gjykata për egzekutimin e provave me dëgjimin e dëshmitarëve, ekspertëve dhe provave tjera sjellë vendim.

Radhën e egzekutimit të provave e përcakton gjykata.

Gjykata gjatë procedurës mund të riapeloj vendimin e sjellur mbi egzekutimin e provës së caktuar.

Rreth punës në bastisje mbahet procesverbal në të cilin shënohet e gjithë rrjedha e bastisjes.

Procesverbalin mbi bastisjen e nënshkruajnë palët e pranishme, mbrojtësi, gjykatësi dhe procesmbajtësi.

## **E drejta e palëve në bastisje**

### **Neni 243**

Parashtruesi i kërkesës, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, përfaqësuesi dhe mbrojtësi i personit juridik dhe i dëmtuari kanë të drejtë që gjatë bastisjes të propozojnë prova dhe të japin propozime tjera, ndërsa me miratimin e gjykatësit i cili udhëheq procedurën mund të parashtrohen pyetje personave të cilat ndëgjohe.

Përfaqësuesi i autorizuar i parashtruesit të kërkesës ka të drejtë që në bastisje të ndryshoj përmbajtjen e kërkesës në shikimin e përkrahimit faktik të kundërvajtjes.

Në rastin nga paragrafi 2, i këtij neni gjykata me vendim do të shtyj bastisjen në mënyrë që i pandehuri të njihet me ndryshimet e kërkesës dhe që të përgadis mbrojtjen.

Pas procedurës së kryer të provave palët dhe mbrojtësi mund të japin fjalën përfundimtare me vlerësimin e vet mbi realizimin e provave. Fjala përfundimtare gjithmonë i përket të pandehurit, përkatësisht përfaqësuesit të personit juridik.

Po nëse gjykata gjenë se bastisja nuk duhet të shtyhet për arsye të plotësimit të procedurës apo për arsye të përgaditjes së mbrojtjes së të pandehurit në bazë të kërkesës së ndryshuar, do të përfundojnë bastisjen, dhe mund të sjellin aktgjykimin dhe publikisht ta shqiptojnë aktgjykimin së bashku deklaratën e shkurtë të arsyeve.

Kur në rastin nga paragrafi 5, i këtij neni, i pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës deklarojnë që nuk kërkojnë që t'i dorëzohet aktgjykimi i përpiluar në mënyrë të shkruar dhe se nuk do të ankohen, të pandehurit do t'i dorëzohet, ndërsa parashtruesit të kërkesës do t'i dorëzohet vetëm kopja e shkruar e shqiptimit të aktgjykimit.

## KREU XXVIII MBAJTJA E RENDIT

### Kujdesi mbi mbajtjen e rendit

#### Neni 244

Detyra e gjykatësit është që të kujdeset për mbajtjen e rendit gjatë kohës së egzekutimit të punës në procedurën për kundërvajtje.

Po nëse pala në procedurë përkatësisht personi i dytë prezent pengon rendin apo nuk i bindet urdhërave për mbajtjen e rendit, gjykatësi do ta paralajmroj, ndërsa po nëse vërejtja është e pasuksesshme mund të urdhëroj që ai person të largohet, gjë që do të konstatohet në procesverbal.

Po nëse vërejtja është e pasuksesshme, personi nga paragrafi 2, i këtij neni, mund të dënohet me denim në të holla prej 10.000 deri 50.000 dinarë. Vendimi i gjyqit i cili i përket mbajtjes së rendit vendoset në procesverbal.

Autorizuesit apo mbrojtësit i cili pas dënimit vazhdon ta prish rendin, me vendim mund t'i mohohet përfaqësimi, përkatësisht mbrojtja.

Nëse personi i dënuar nuk e paguan denimin në afat të caktuar, denimin do ta paguaj në mënyrë të detyrueshme.

Ankesa kundër vendimit të dënimit nga paragrafi 2 deri 4, i këtij neni nuk përmban egzekutimin e vendimit.

## KREU XXIX NDËRPRERJA E PROCEDURËS

#### Neni 245

Gjykata me vendim do ta ndërpres procedurën:

- 1) nëse nuk e di qëndrimin e të pandehurit apo kur ai është në arrati, apo nuk iu është qasur organeve shtetërore, apo gjendet jashtë vendit për kohë të pacaktuar;
- 2) nëse tek i pandehuri ka ndodhur sëmundje e përkohshme mendore apo çrregullim i përkohshëm mendor.

Para se të ndërpritet procedura, do të mblidhen të gjitha provat rreth kundërvajtjes dhe përgjegjësisë së të pandehurit deri tek cilët mund të arrihet.

Procedura e ndërprerë do të vazhdohet kur të ndërpritet pengesat të cilat kanë nxitur shkaktuar ndërprerjen.

Rreth ndërprerjes dhe vazhdimit të procedurës do të njoftohet edhe parashtruesi i kërkesës, ndërsa në procedurën për kundërvajtje nga fusha e veprimtarisë doganore, tregëtisë së jashtme dhe devizore edhe i dëmtuari.

**Kreu XXX**  
**AKTGJYKIMI DHE VENDIMET TJERA**

**Sjellja e aktgjykimit dhe vendimeve tjera**

**Neni 246**

Procedura për kundërvajtje përfundohet me sjelljen e aktgjykimit akuzues dhe lirues, vendimi me të cilin procedura ndërpritet apo vendimi me të cilin kryerësit të mitur të kundërvajtjes i shqiptohet masa edukative.

Aktgjykimi i shkruar, përkatësisht vendimi do të përpilohet në afat prej tetë ditëve nga dita e përmbylljes së të gjitha punëve në procedurën për kundërvajtje të cilat paraprijnë sjelljen e aktgjykimit, përkatësisht vendimit.

Aktgjykimi, përkatësisht vendimi bazohet në provat dhe faktet e realizuara të cilat janë vërtetuar në procedurë.

**Identiteti objektiv dhe subjektiv**

**Neni 247**

Vendimi në procedurën për kundërvajtje i referohet vetëm personit i cili me kërkesë për fillimin e procedurës për kundërvajtje ngarkohet vetëm për kundërvajtjen e cila është lëndë e kërkesës së parashtruar.

Gjykata është e obliguar që në mënyrë të plotë të vendos për kërkesën e parashtruar.

Gjykata nuk është e lidhur për shembujt dhe vlerësimin në pikpamjen e kualifikimit ligjor të kundërvajtjes.

Po nëse pas fillimit të procedurës për kundërvajtje personi juridik kundër të cilit udhëhiqet procedura, ndërpret së egzistuari, parashtruesi i kërkesës për fillimin e procedurës mund ta drejtoj kërkesën kundër pasardhësit të tij ligjor.

**Vendimi mbi pezullimin e procedurës për kundërvajtje**

**Neni 248**

Procedura për kundërvajtje përfundohet me vendim mbi pezullimin atëherë kur gjykata vërteton:

- 1) se procedura për kundërvajtje është udhëhequr pa kërkesë, përkatësisht që parashtruesi i kërkesës për fillimin e procedurës për kundërvajtje nuk ka qenë i autorizuar për parashtrimin e saj;
- 2) që gjykata realisht nuk është kompetente për udhëheqjen e procedurës për kundërvajtje;
- 3) që i pandehuri për të njëjtin veprim tashmë është dënuar plotëfuqishëm, është liruar nga detyrimi në procedurën për kundërvajtje apo procedura për kundërvajtje në mënyrë të plotëfuqishme është pezulluar, por jo përshkak të moskompetencës;

4) që i pandehuri në procedurën penale, përkatësisht në procedurën sipas kundërvajtjes ekonomike në mënyrë të plotëfuqishme është liruar apo është shpallur fajtor për të njejtën ngjarje e cila përfshin edhe cilësinë e kundërvajtjes;

5) që i pandehuri të ketë imunitet diplomatik;

6) që të ketë filluar vjetrimi për udhëheqjen e procedurës për kundërvajtje;

7) që i pandehuri vdes gjatë procedurës për kundërvajtje, përkatësisht që i personi juridik i pandehur pushon së egzistuari dhe nuk ka pasardhës juridik;

8) që parashtruesi i autorizuar ka hequr dorë nga kërkesa për fillimin e procedurës për kundërvajtje para vendimit të plotëfuqishëm.

Procedura për kundërvajtje do të pezullohet edhe në rastet tjera të caktuara ligjore.

Në arsyetimin e vendimit theksohen shkurt arsyet për të cilat është pezulluar procedura dhe rregulla në bazë të cilës është bërë ajo.

### **Sjellja e aktgjykimit me të cilin i pandehuri shpallet përgjegjës**

#### **Neni 249**

Aktgjykimi me të cilin i pandehuri shpallet përgjegjës për kundërvajtjen sjellet kur në procedurën për kundërvajtje vërtetohet egzistimi i përgjegjësisë së të pandehurit për atë shkelje.

### **Sjellja e aktgjykimit me të cilin i pandehuri lirohet nga përgjegjësia**

#### **Neni 250**

Aktgjykimi me të cilin i pandehuri lirohet nga përgjegjësia, gjykata mund ta sjellë:

1) po nëse për veprën për të cilën ngarkohet sipas rregullave nuk është kundërvajtje;

2) po nëse ka rrethana të cilat përjashtojnë përgjegjësinë për kundërvajtje të të pandehurit;

3) po nëse nuk është argumentuar se i pandehuri ka kryer kundërvajtje për të cilën kundër saj është parashtruar kërkesa për fillimin e procedurës për kundërvajtje.

### **Përmbajtja e shqiptimit të aktgjykimit me të cilin i pandehuri shpallet përgjegjës për kundërvajtje**

#### **Neni 251**

Nëse i pandehuri shpallet përgjegjës për kundërvajtje, shqiptimi i aktgjykimit përmban:

1) kundërvajtjen për të cilën i pandehuri shpallet përgjegjës, sëbashku me kuptimin e fakteve dhe rrethanave të cilat e cilësojnë kundërvajtjen dhe prej të cilave varet zbatimi i rregullave të caktuara për kundërvajtje;

2) rregullat të cilat janë zbatuar;

- 3) vendimin mbi sanksionet e shqiptuara;
- 4) vendimin mbi konfiskimin e pasurisë;
- 5) vendimin mbi llogaritjen e mbajtjes në dënimin e shqiptuar;
- 6) vendimin mbi kërkesën pasurore juridike;
- 7) vendimin mbi harxhimet e procedurës për kundërvajtje.

Nëse i pandehuri është dënuar me dënim në të holla, në aktgjykim do të caktohet afati i pagesës së dënimit.

Nëse masat e shqiptuara mbrojtëse të konfiskimit të lëndës, në shqiptimin e aktgjykimit do të caktohen edhe se si të sillen me lëndët e konfiskuara.

Kur me masat e shqiptuara të konfiskimit të lëndës nuk janë të përfshira lëndët përkohësisht të konfiskohen sipas nenit 232, të këtij ligji, në shqiptimin e aktgjykimit dhe se ato lëndë t'i kthehen pronarit.

### **Publikimet e aktgjykimit**

#### **Neni 252**

Aktgjykimi shpallet gojarisht nëse i pandehuri është prezent, ndërsa aktgjykimi i përpiluar me shkrim me arsyetimin i dorëzohet të pandehurit dhe parashtruesit të kërkesës vetëm nëse atë e kërkojnë.

Nëse aktgjykimi shpallet, në procesverbal shënohet vetëm shqiptimi i aktgjykimit dhe konstatohet se aktgjykimi gojarisht është kumtuar, që është dhënë arsyetim i shkurtër i aktgjykimit dhe udhëzimi rreth mjeteve juridike.

Nëse i pandehuri kërkon që t'i dorëzohet aktgjykimi i shkruar, gjykata është e obliguar që ta dorëzojë në afat prej tetë ditësh nga dita e paraqitjes.

Të pandehurit prezent do t'i dorëzohet, ndërsa parashtruesit të kërkesës do t'i dorëzohet vetëm kopja e shqiptimit të aktgjykimit nëse:

- 1) i pandehuri deklaron se nuk kërkon që t'i dërgohet aktgjykimi i shkruar;
- 2) kur i pandehurit i hiqet e drejta në ankesë.

Deklarata mbi dorëheqjen nga e drejta në ankesë jepet në procesverbal dhe duhet të përmbajë nënshkrimet e të pandehurit dhe gjykatësit.

Gjykata është e obliguar që me kërkesë të parashtruesit të kërkesës të përpilojë dhe dërgojë aktgjykimin e shkruar me arsyetim. Afati për ankesë të parashtruesit të kërkesës fillon nga pranimi i aktgjykimit të shkruar me arsyetim.

### **Aktgjykimi për shumë kundërvajtje**

#### **Neni 253**



Nëse procedura për kundërvajtje udhëhiqet për shkak të shumë kundërvajtjeve, në aktgjykim theksohet se për cilat kundërvajtje i pandehuri shpallet përgjegjës, ndërsa për cilat lirohet nga përgjegjësia apo procedura pezullohet.

### **Përmbajtja e aktgjykimit të shkruar**

#### **Neni 254**

Aktgjykimi i shkruar nga neni 252, paragrafi 6 i këtij ligji përmban: hyrjen, shqiptimin, arsyetimin dhe udhëzimin për të drejtën në ankesë, si edhe numri, data, nënshkrimi i gjykatësit dhe vulën zyrtare.

Hyrja në aktgjykim përmban: kuptimin se aktgjykimi miratohet në emër të popullit, emrin e gjykatës e cila e ka miratuar aktgjykimin, emrin personal të gjykatësit, emrin personal të të pandehurit, vendbanimin e të pandehurit, përkatësisht emrin dhe selinë e personit juridik të pandehur, kualifikimin ligjor të kundërvajtjes e cila është lëndë e kërkesës së parashtruar, ditën e miratimit të aktgjykimit dhe arsyen sipas cilës është miratuar aktgjykimi.

Shqiptimi i aktgjykimit përmban të dhënat kryesore mbi të pandehurin nga neni 181, paragrafi 1, pika 3, vendimin me të cilin i pandehuri shpallet fajtor apo lirohet nga përgjegjësia, përshkrimin e arsyeshem dhe kualifikimin juridik të kundërvajtjes.

Në arsyetimin e aktgjykimit në mënyrë të shkurt shënohet përmbajtja e kërkesës për fillimin e procedurës për kundërvajtje, faktet e konfirmuara të gjendjes përmes theksimit të provave në bazë të cilës disa fakte janë dëshmuar, nga të cilat arsye gjykata i merr si të dëshmuara dhe jo të dëshmuara, nga cilat arsye nuk kanë vlejtur propozimet e caktuara të palëve, rregullat në të cilat bazohet aktgjykimi dhe arsyet për secilën pikë të aktgjykimit.

Në udhëzimin mbi të drejtën e ankesës jepet udhëzimi rreth asaj se kujt ankesa i deklarohet, kujt i dorëzohet, në cilin afat, që ankesa duhet të dorëzohet në formën e shkruar, si edhe se mundet të dorëzohet drejtëpërdrejtë apo të dërgohet me postë të rekomanduar.

### **Korrigjimi i aktgjykimit dhe vendimeve tjera**

#### **Neni 255**

Gabimet në shkrimin e emrave dhe numrave dhe gabimeve tjera të dukshme në shkrim, llogaritje dhe përshkrimin në aktgjykim dhe vendimet tjera përmirësohen sipas detyrës zyrtare apo me propozim të palëve apo të dëmtuarit.

Korrigjimet do të kryhen me vendim të posaçëm, të cilat bëhen pjesë përbërse e aktgjykimit apo vendimit tjetër i cili korrigjohet.

Nëse shqiptimi i vendimit gjyqësor përmban gabimet nga paragrafi 1, i këtij ligji, gjykata është e detyruar që kopjen e përmirësuar të shkruar të vendimit t'ia dorëzoj personave të cilat kanë të drejtë në ankesë. Afati për ankesë fillon nga dita e dorëzimit të vendimit të korrigjuar.

### **Dorëzimi i aktgjykimit pjesëmarrësve në procedurë**

#### **Neni 256**

Aktgjykimi i shkruar i dorëzohet parashtruesit të kërkesës dhe të pandehurit sipas rregullave për dorëzim të këtij ligji.

Aktgjykimi dorëzohet personit të dëmtuar i cili nuk është parashtrues i kërkesës nëse është vendosur rreth kërkesës pronësore ligjore, personit të cili iu është marrë lënda me atë aktgjykim, si edhe personit kundër të cilit është shqiptuar masa e konfiskimit të pasurisë.

### **Dorëzimi i njoftimit me gojë të aktgjykimit ndaj të pandehurit**

#### **Neni 257**

Nëse i pandehuri kërkon që t'i dorëzohet kopja e aktgjykimit, gjykatësi është i detyruar që kopjen e aktgjykimit t'ia dorëzoj në afat prej tetë ditëve nga dita e përpilimit të aktgjykimit.

Kërkesa e të pandehuri në aspektin e paragrafit 1, të këtij neni, shënohen në procesverbal sëbashku me nënshkrimin e tij.

## **KREU XXXI MJETI I RREGULLT JURIDIK**

### **Parashtrimi i ankesës**

#### **Neni 258**

Kundër aktgjykimit dhe vendimit të gjykatës për kundërvajtje mund të parashtrohet ankesa në gjykatën për kundërvajtje të shkallës së dytë. Ankesa dorëzohet në gjykatën e cila ka miratuar vendimin e shkallës së parë.

Ankesa dorëzohet në afat prej tetë ditësh nga dita e dorëzimit të aktgjykimit apo vendimit.

### **Personat e autorizuar për parashtrimin e ankesës**

#### **Neni 259**

Ankesën mund ta parashtron i pandehuri, mbrojtësi apo parashtruesi i kërkesës.

Ankesa mund të parashtrohet gjithmonë në aktgjykim, ndërsa vendimet e sjellura në procedurën për kundërvajtje vetëm nëse e drejta në ankesë me ligj nuk është përjashtuar.

Në favor të pandehurit ankesën mund ta parashtroj partneri bashkëshortor, i afërmi në bazë të gjakut në vijë të drejtë, vllau, motra, përfaqësuesi ligjor, i adoptuari, ushqyesi dhe personi me cilin jeton në bashkësinë jashtëmartesore apo në bashkësinë tjetër të përhershme jetësore.

Afati për ankesë fillon nga dita kur i pandehuri e dorëzon shembullin e aktgjykimit, ndërsa i pandehuri ka mbrojtës nga dita kur atij iu është dorëzuar shembulli i aktgjykimit.

Në favor të personit të pandehur juridik ankesën mund ta parashtroj përfaqësuesi ligjor, si edhe përfaqësuesi i personit juridik.

Nëse është shqiptuar masa mbrojtëse e konfiskimit të lëndës pronar i të cilit nuk është i pandehuri, pronari i lëndës mund të parashtroj ankesën vetëm në aspektin e vendimit në këtë masë.

## **Efekti suspensiv i ankesës**

### **Neni 260**

Parashtrimi me kohë i ankesës shtyen egzekutimin e vendimit, përveç në rastet kur me këtë ligj është caktuar ndryshe.

## **Heqja dore dhe tërheqja nga ankesa**

### **Neni 261**

I pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës mund të heqin dorë nga ankesa sepse vendimi është kumtuar, ndërsa nga parashtrimi i ankesës mund të tërheqet deri sa të miratohet aktgjykimi i shkallës së dytë.

Heqja dorë dhe tërheqja nga e drejta në ankesë nuk mund të riapeloher.

Heqja dorë e të miturit nga e drejta në ankesë nuk ka efekt juridik.

## **Përmbajtja e ankesës**

### **Neni 262**

Ankesa duhet të përmbaj:

- 1) përcaktimi i vendimit kundër të cilit ankesa parashtrrohet;
- 2) gjendja në të cilën parashtruesi i ankesës nuk është i kënaqur me vendimin;
- 3) nënshkrimi i parashtruesit të ankesës.

Në ankesë mund të paraqiten fakte të reja dhe të propozohen dëshmi të reja. Duke u thirrur në faktet e reja parashtruesi i ankesës është i obliguar që të paraqes provat në të cilat tregojnë ato fakte.

Nëse parashtruesi i ankesës në ankesë jep dëshmi të reja, është i obliguar që të theksoj se pse ato dëshmi më herët nuk i ka dhënë, si edhe faktet në të cilat i dëshmon ato prova.

## **Bazat përshkak të cilave aktgjykimi dhe vendimi mund të kontestohen**

### **Neni 263**

Aktgjykimi dhe vendimi mund të kontestohen:

- 1) përshkak të shkeljes esenciale të rregullave të procedurës për kundërvajtje;
- 2) përshkak të shkeljes së rregullave të drejtës materiale;
- 3) përshkak të gjendjes së vëreteuar faktike të gabuar dhe jo të plotë;

4) përshkak të vendimit mbi sanksionet kundërvajtëse, konfiskimin e pasurisë, harxhimet e procedurës për kundërvajtje dhe kërkesës së drejtës pronësore.

### **Shkeljet esenciale të rregullave të procedurës esenciale**

#### **Neni 264**

Shkeljet esenciale të rregullave të procedurës esenciale gjithmonë egzistojnë nëse:

1) procedurën për kundërvajtje e ka udhëhequr edhe aktgjykimin apo vendimin e ka miratuar gjykatësi, i cili me vendim të plotëfuqishëm është liruar nga udhëheqja e procedurës dhe vendimarrjes;

2) procedurën për kundërvajtje e ka udhëhequr dhe vendimin e ka sjellur gjykatësi, i cili është dashur të skualifikohet (neni 112, paragrafi 1, pika 1) deri 5);

3) i pandehuri është udhëzuar mbi të drejtën e përdorimit të gjuhës, ose atij apo mbrojtësit të tij kundër kërkesës së tij iu është shkurtuar e drejta që në seancën gojore apo gjatë veprimeve tjera në procedurën për kundërvajtje përdoret gjuha e tij dhe në gjuhën e tij të ndjek vazhden e senacës me gojë, përkatësisht procedurën (neni 94);

4) kundër ligjit ka qenë e përjashtuar publiku në seancën gojore;

5) gjykata ka përjashtuar kërkesën për fillimin e procedurës për kundërvajtje kundër rregullave të nenit 184, të këtij ligji;

6) gjykata me vendim ka pezulluar procedurën për kundërvajtje në kundërshtim me rregullat e nenit 248, të këtij ligji apo ka sjellur aktgjykimin me të cilin i pandehuri lirohet nga përgjegjësia kundër rregullat e nenit 250, të këtij ligji;

7) aktgjykimin apo vendimin e ka sjellur gjykata e cila përshkak të moskompetencës reale nuk ka mundur të gjykojë për këtë çështje (neni 110);

8) aktgjykimi i kumtuar me gojë nuk është shënuar në procesverbal (neni 252, paragrafi 2);

9) gjykata nuk ka vendosur në plotshmëri për kërkesën për fillimin e procedurës për kundërvajtje (neni 247, paragrafi 2);

10) gjykata ka vendosur jashtë kërkesës për nisjen e procedurës për kundërvajtje;

11) aktgjykimi apo vendimi bazohet në faktin në të cilën sipas rregullave të këtij ligji nuk mund të bazohet, përveç nëse, duke marrë parasysh dëshmit tjera, në mënyrë të qartë edhe pa atë dëshmi do të miratohet e njëjti vendim;

12) aktgjykimi apo vendimi bazohet në deklaratën e të pandehurit i cili nuk ka qenë i paralajmruar në drejtën që të merr mbrojtës sipas zgjedhjes së tij apo të dëgjohet në prani të mbrojtësi;

13) është shkelur rregulla e nenit 96, e këtij ligji;

14) shqiptimi i aktgjykimit dhe vendimit nuk kuptohet.

Shkelja esenciale e rregullave të procedurës për kundërvajtje e cila ka ndikuar apo ka mundur të jetë nga ndikimi në sjelljen e aktgjykimit ligjor dhe të rregulltë apo vendimi egziston edhe nëse:

- 1) i pandehuri në procedurën për kundërvajtje nuk është dëgjuar para sjelljes së vendimit përveç në rastet nga neni 93, paragrafi 3 dhe neni 187, paragrafi 7, i këtij ligji;
- 2) shqiptimi është kontradiktor për arsyet e aktgjykimit apo vendimi;
- 3) aktgjykimi apo vendimi fare nuk ka arsye apo nuk janë cekur arsyet mbi faktet vendimtare, apo ato arsye janë plotësisht të paqarta, apo në masë të madhe kontradiktore, apo nëse mbi faktet vendimtare egziston kontradiktim i rëndësishëm në mes asaj që në arsyet e vendimit theksohet, rreth përmbajtjes së dokumenteve apo procesverbalit mbi deklaratat e dhëna në procedurë, dhe në vet ato dokumente dhe procesverbale, përveç në rastin nga neni 252, paragrafi 4, i këtij ligji;
- 4) Gjykata gjatë procedurës për kundërvajtje apo me rastin e miratimit të vendimit nuk ka zbatuar apo gabimisht ka zbatuar ndonjë rregull të këtij ligji, apo gjatë procedurës për kundërvajtje ka shkelur të drejtën për mbrojtje.

### **Shkelja e drejtës materiale**

#### **Neni 265**

Shkelja e drejtës materiale për kundërvajtje egziston kur gjykata nuk ka zbatuar apo gabimisht ka zbatuar rregullat me të cilat përcaktohet:

- 1) se veprimi për të cilin i pandehuri ndjeket është kundërvajtje;
- 2) se a ka rrethana të cilat përjashtojnë përgjegjësinë për kundërvajtje;
- 3) se a ka rrethana të cilat përjashtojnë nisjen dhe udhëheqjen e procedurës për kundërvajtje, ndërsa veçanërisht se a ka ndodhur vjetrimi apo çështja vetëm se është gjykuar në mënyrë të plotëfuqishme;
- 4) se në aspektin e kundërvajtjes e cila është lëndë e kërkesës për nisjen e procedurës për kundërvajtje është zbatuar ligji apo ndonjë rregull tjetër e cila nuk mund të zbatohet;
- 5) se me vendim të denimit, masës mbrojtëse, sanksionit të tjetër për kundërvajtje apo mbi konfiskimin e pronësisë është tejkaluar autorizimi të cilin gjykata e ka sipas ligjit;
- 6) se a janë shkelur rregullat rreth llogaritjes së mbajtjes dhe denimit të kryer.

### **Vërtetimi i gabueshëm apo jo i plotë i gjendjes faktike**

#### **Neni 266**

Vendimi mund të kontestohet përshkak të gjendjes së vërtetuar faktike të gabuar apo jo të plotë, kur gjykata ndonjë vendim kyç gabimisht e vërteton apo nuk e vërteton.

Mënyra e vërtetuar e gjendjes faktike egziston edhe kur për ëtë tregohen faktet e reja apo dëshmi të reja.

### **Kontestimi i aktgjykimit dhe vendimit përshkak të vendimit mbi sanksionin dhe arsyeve tjera**

## **Neni 267**

Vendimi mund të kontestohet përshkak të vendimit mbi sanksionin për kundërvajtje kur me këtë vendim nuk është tejkualuar autorizim ligjor (neni 265, paragrafi 1, pika 5), por gjykata në mënyrë të parregullt ka mbatur dënimin me qëllim të rrethanave të cilat ndikojnë që dënimi të jetë më i madh apo më i vogël.

Vendimi mbi dënimin mund të kontestohet edhe përshkak të asaj që gjykata ka zbatuar apo nuk ka zbatuar dispozitat mbi zbutjen e dënimit, mbi lirimin e dënimit, apo përshkak se nuk ka shqiptuar paralajmrimin edhe pse për këtë kanë egzistuar kushtet ligjore.

Vendimi mbi masat mbrojtëse, sanksionet tjera të kundërvajtjes apo mbi konfiskimin e pasurisë mund të kontestohet nëse nuk egziston shkelja nga neni 265, paragrafi 1, pika 5), e këtij ligji dhe gjykata në mënyrë të padrejtë ka sjellur këtë vendim apo nuk ka shqiptuar masën mbrojtëse përkatësisht konfiskimin e pasurisë edhe pse për këtë kanë egzistuar kushtet ligjore.

Vendimi mbi kërkesën ligjore pronësore si edhe vendimi mbi harxhimet e procedurës për kundërvajtje, mund të kontestohet kur gjykata rreth kësaj sjell vendimin në kundërshtim me ligjin.

## **Procedura sipas ankesës**

### **Neni 268**

Parashtrimin me vonesë, të palejuar apo të personit të paautorizuar të ankesës së paraqitur gjykata mund ta pezulloj me vendim.

Parashtrimin me kohë, të lejuar apo nga personi i autorizuar i ankesës gjykata për kundërvajtje me shkresat e lëndës do t'ia dërgoj gjykatës së shkallës së dytë për kundërvajtje në afat prej tri ditëve.

## **Vendimet e gjykatës për kundërvajtje të shkallës së dytë**

### **Neni 269**

Gjykata për kundërvajtje e shkallës së dytë vendimet i sjell në formën e aktgjykimeve apo vendimeve.

Me aktgjykim konfirmohet apo amendohet aktgjykimi i gjykatës për kundërvajtje të shkallës së dytë.

Me vendim refuzohet ankesa e shqiptuar në aktgjykim apo vendim, vendoset sipas ankesës në vendim apo largohet aktgjykimi i gjykatës për kundërvajtje.

Me vendim amendohet aktgjykimi apo vendimi për arsye të rregulluara në nenin 248, të këtij ligji.

## **Mënyra vendimarrjes sipas ankesës**

### **Neni 270**

Duke vendosur sipas ankesës në aktgjykimin apo vendimin e gjykatës për kundërvajtje, gjykata e shkallës së dytë për kundërvajtje mund:

- 1) ta refuzoj ankesën;
- 2) ankesën ta refuzoj si të pa bazë dhe të konfirmoj vendimin e shkallës së dytë;
- 3) ankesën ta miratoj, ndërsa vendimin e shkallës së parë ta amendoj apo ta shfuqizojë.

### **Refuzimi i ankesës nga ana e gjykatës së shkallës së dytë**

#### **Neni 271**

Gjykata e shkallës së dytë për kundërvajtje do ta refuzoj me vendim si të parashtruar me vonesë, të palejuar apo të paraqitur nga ana e personit të pautorizuar, nëse vërtetohet se gjykata e cila ka udhëhequr procedurën ka lëshuar që këtë ta bëjë.

### **Kufijtë e hulumtimit të vendimit të shkallës së parë**

#### **Neni 272**

Gjykata e shkallës së dytë për kundërvajtje shqyrton vendimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën kontestohet ankesa, por duhet gjithmonë sipas detyrës zyrtare të shqyrtohet:

- 1) se a egziston shkelja e dispozitave të procedurës për kundërvajtje nga neni 264, paragrafi 1, pika 1) dhe pika 6) deri 14) e këtij ligji;
- 2) se a është në dëm të pandehurit është shkelur e drejta materiale (neni 265).

Nëse ankesa është paraqitur në favor të pandehurit nuk përmban bazën për kontestimin e vendimit (neni 263), gjykata e shkallës së dytë për kundërvajtje do të kufizoj në shqyrtimin e shkeljeve nga paragrafi 1, i këtij ligji, si edhe në shqyrtimin e vendimit mbi sanskionit të kundërvajtjes dhe konfiskimin e pasurisë (neni 267).

### **Konfirmimi i vendimit të shkallës së parë**

#### **Neni 273**

Gjykata e shkallës së dytë për kundërvajtje me aktgjykim e refuzon ankesën si të pa bazë dhe konfirmon vendimin e shkallës së dytë që nuk egzistojn arsyet përshkak të cilës vendimet kontestohen dhe as shkeljet e ligjit nga neni 272, i këtij ligji.

### **Amendimi i vendimit të shkallës së parë**

#### **Neni 274**

Gjykata e shkallës së dytë për kundërvajtje do të miratoj ankesën dhe me aktgjykim të amendoj vendimin e shkallës së parë nëse vërteton se:

- 1) se faktet vendimtare në procedurën e shkallës së parë në mënyrë të drejtë janë vërtetuar dhe duke marrë parasysh gjendjen e vërtetuar faktike sipas zbatimit të drejtë të ligjit duhe të sjellë vendim tjetër;

2) egzistojnë shkelje të tilla të ligjit të cilat mund të largohen me amendimin e vendimit të shkallës së parë;

3) me rastin e matjes së dënimit, përkatësisht të shqiptimit të masës mbrojtëse nuk janë marrë parasysh të gjitha rrethanat të cilat i përkasin matjes së drejtë të dënimit në shqiptimin ligjor të masave mbrojtëse;

4) rrethanat të cilat janë marrë parasysh nuk janë vlerësuar në mënyrë të drejtë;

5) gjykata e cila e udhëheq procedurën për kundërvajtje gabimisht ka vlerësuar dokumentet dhe faktet të cilat nuk i ka sjellur vet, ndërsa vendimi apo aktgjykimi është bazuar në ato dëshmi.

### **Shfuqizimi i vendimit të shkallës së parë**

#### **Neni 275**

Gjykata e shkallës së dytë për kundërvajtje ankesën do ta miratoj dhe me vendim ta shfuqizoj vendimin e shkallës së parë dhe lëndën ta kthej gjykatës në rigjykim:

1) nëse egziston shkelja esenciale e dispozitave të procedurës për kundërvajtje e cila ka ndikuar në vendimarrje ligjore;

2) nëse gjykata në kundërshtim të dispozitave të këtij ligji gabimisht apo në mënyrë jo të plotë vërteton gjendjen faktike përshkak të cilës duhet të plotësohet apo të realizohet procedurë e re;

3) Nëse procedura për kundërvajtje është pezulluar apo është sjellur aktgjykimi me të cilin të pandehurit lirohen nga përgjegjësia përshkak të vlerësimit të gabuar të fakteve apo të zbatimit të gabuar të drejtave materiale.

Nga arsyet në paragrafin 1, të këtij neni, mund që vendimi i shkallës së parë edhe pjesërisht të shfuqizohet nëse disa pjesë të caktuara të vendimit mund të ndahen pa u cënuar gjykimi i drejtë.

### **Arsyetimi i shkallës së dytë të vendimit**

#### **Neni 276**

Në arsyetimin e vendimit të shkallës së dytë të gjykatës për kundërvajtje do të vlerësohet të pohimet e ankesës dhe të tregohen shkeljet e ligjit i cili ka marrë parasysh në bazë të detyrës zyrtare.

Kur vendimi i shkallës së parë të shfuqizohet përshkak të shkeljes së dispozitave të procedurës për kundërvajtje në arsyetim do të theksohet se dispozitat janë të vërtetuara dhe në çka reflektohet aktgjykimi.

Kur vendimi i shkallës së parë të largohet përshkak të gjendjes faktike të gabuar apo jo të plotë do të cekën mungesat, përkatësisht përse dëshmit e reja dhe faktet e reja janë të rëndësishme për sjelljen e vendimeve të drejta.

Kur vendimi i shkallës së parë shfuqizohet në rastet nga paragrafi 2 dhe 3, i këtij ligji, gjykata e shkallës së dytë do të jap urdhëra mbi trajtimin e gjykatës për kundërvajtje në rigjykim.



## **Efektet e ankesës në dobi të bashkë të pandehurit**

### **Neni 277**

Kur gjykata e shkallës së dytë për kundërvajtje me rastin e se cilat ankesa janë të paraqitura kundër vendimit të i vërtetoj se arsyet përshkak të cilave është sjellur aktgjykimi apo vendimi në favor të pandehurit janë të dobishme edhe për shkak prej bashkë të pandehurit i cili nuk ka paraqitur ankesën apo nuk ka paraqitur në atë drejtim, do të veproj sipas detyrës zyrtare se ankesa të tilla nuk egzistojnë.

## **Dorëzimi i vendimit të shkallës së dytë**

### **Neni 278**

Gjykata e shkallës së dytë për kundërvajtje do të kthej të gjitha shkresat gjykatës së shkallës së parë me numrin e mjaftueshëm të shembujve të vërtetuara të aktgjykimeve dhe vendimeve të saj për arsye të dorëzimit për të pandehurin, parashtruesit të kërkesës dhe personave tjerë të interesuar.

## **Detyrimet e gjykatës për kundërvajtje**

### **Neni 279**

Gjykata për kundërvajtje është e detyruar që të realizoj të gjitha veprimet dhe të shqyrtoj të gjitha çështjet e diskutueshme në të cilat i ka cekur gjykata e shkallës së dytë për kundërvajtje në vendimin në të cilin është shfuqizuar vendimi i shkallës së parë.

Para miratimit të vendimit të ri, gjykata është e lidhur me ndalesën e paraparë në nenin 96, të këtij ligji.

## **Kreu XXXII**

### **MJETET E JASHTËZAKONSHME JURIDIKE**

#### **1. Kërkesën për përsëritjen e procedurës për kundërvajtje**

##### **Arsyet për përsëritjen e procedurës**

### **Neni 280**

Procedura për kundërvajtje i kryer me vendim të plotëfuqishëm mund të përsëritet nëse:

- 1) dëshmohet se vendimi është i bazuar në dokumentet e rrejshme apo në dëshminë e rrejshme të dëshmitarëve apo ekspertëve;
- 2) dëshmohet se vendimi është sjellur përshkak të veprës penale të gjykatësit apo personit tjetër juridik i cili ka marrë pjesë në procedurë;
- 3) kur vërtetohet se personi i cili vetëm se është dënuar për kundërvajtje, delikt ekonomik apo vepër penale;
- 4) paraqiten faktet e reja apo shënohen dëshmitë e reja të cilat secili për vete apo në lidhje me dëshmitë e hershme kanë sjellur deri tek vendimet e tjera në mënyrë që të njoftohen në procedurën e hershme;

5) i pandehuri arrin mundësinë që të përdor vendimin e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut me të cilin vërtetohet shkelja e drejtave të njeriut, ndërsa kjo ka mundur të jetë nga ndikimi në miratimin e vendimit më të favorshëm sipas të pandehurit;

6) Gjykata Kushtetuese, në procedurën sipas ankesës kushtetuese, ka konfirmuar shkeljen apo cënimin e drejtave të njeriut apo të pakicave kombëtare dhe lirive të garantuara me kushtetutë në procedurën për kundërvajtje, ndërsa kjo ka mundur të ndikoj në miratimin e vendimit më të përshtatshëm sipas të pandehurit.

Arsyet nga paragrafi 1, pika 1) deri 3) e këtij neni tregon vendimin e plotëfuqishëm gjyqësor.

Nëse procedura kundër personit nga paragrafi 1, pika 1) deri 3), të këtij neni nuk mund të realizohet përshkak se ka vdekur apo egzistojnë rrethanat të cilat përjashtojnë ndjekjen penale, faktet nga paragrafi 1, pika 1) dhe 2), e këtij neni mund të vërtetohen edhe me dëshmi të tjera.

### **Dorëzimi i kërkesës për përsëritjen e procedurës**

#### **Neni 281**

Kërkesën për përsëritjen e procedurës për kundërvajtje mund ta parashtroj i dënuari. Në favor të personit të dënuar, kërkesa mund të parashtrohet edhe nga personi nga neni 259, paragrafi 3 i këtij ligji.

Kërkesën për përsëritjen e procedurës parashtrohet në afat prej 60 ditëve nga dita kur pala ka marrë vesh për egzistimin e fakteve dhe rrethanave nga neni 280, pika 1) deri 6) e këtij ligji.

Kërkesa për përsëritjen e procedurës nuk mund të parashtrohet pas kalimit të afatit prej dy viteve nga dita kur vendimi me rastin e të cilit kërkohet përsëritja e procedurës të bëhet e plotëfuqishme.

### **Procedura sipas kërkesës**

#### **Neni 282**

Rreth kërkesës për përsëritjen e procedurës për kundërvajtje vendos gjykata e cila ka miratuar vendimin e shkallës së parë.

Në kërkesë duhet të ceket se në bazë të cilës kërkohet përsëritja e procedurës dhe me cilat fakte mbështeten faktet në të cilat kërkesa bazohet.

Nëse kërkesa nuk i përmban ato të dhëna, do të refuzohet me vendim.

Kërkesa do të refuzohet edhe kur gjykata në bazë të kërkesës dhe fakteve nga shkresa e lëndës nga procedura e mëhershme vërteton se kërkesën e ka parashtruar personi i paautorizuar apo që kërkesa nuk është parashtruar me kohë apo që nuk ka kushte ligjore për përsëritjen e procedurave apo që faktet dhe dëshmitë në cilat kërkesa bazohet qartazi nuk janë përshtatshëm që në bazë të tyre të lejohet përsëritja.

Kundër vendimit me të cilin refuzohet kërkesa për përsëritjen e procedurës mund të deklarohet ankesa në afat prej tetë ditëve nga dita e dorëzimit.

Kërkesa për përsëritjen e procedurës për kundërvajtje në favor të të dënuarit mund të dorëzohet edhe pasi që vendimi është konkluduar.

### **Vendimet me rastin e kërkesës për përsëritjen e procedurës**

#### **Neni 283**

Nëse gjykata për kundërvajtje nuk refuzon kërkesën për përsëritjen e procedurës, do të përsëritet procedura në formën të cilën është e nevojshme që të vërtetohen faktet për të cilat kërkesa është parashtruar.

Varësisht nga rezultati i përsëritjes së procedurës, kërkesa do të refuzohet me vendim apo me vendim të ri do të hiqet e kaluara në mënyrë të plotë apo pjesërisht.

Kundër vendimit me të cilin refuzohet kërkesa për përsëritjen e procedurës mund të deklarohet ankesa në afat prej tetë ditëve nga dita e dorëzimit.

Nëse lejohet përsëritja e procedurës, në rigjykim gjykata është e lidhur me ndalesën e përcaktuar në nenin 96, të këtij ligji.

Kundër vendimit me të cilin lejohet përsëritja e procedurës nuk është e lejuar ankesa.

### **Shtyerja e egzekutimit të vendimit**

#### **Neni 284**

Kërkesa për përsëritjen e procedurës për kundërvajtje nuk shtyen egzekutimin e vendimit, por nëse gjykata vlerëson se kërkesa mund të jetë e vlefshme, mund të vendoset që të shtyhet egzekutimi deri sa të mos vendoset për kërkesën për përsëritjen e procedurës.

Vendimi me të cilin lejohet përsëritja e procedurës shtyhet egzekutimi i vendimit kundër të cilit përsëritja është e lejuar.

## **2. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë**

### **Parashtrimi i kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë**

#### **Neni 285**

Kundër aktgjykimit mund të parashtrohet kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nëse:

- 1) është shkelur ligji apo rregull mbi kundërvajtjet;
- 2) ligji i zbatuar për të cilin me vendim të Gjykatës Kushtetuese është vërtetuar se nuk është në përputhje me kushtetutën, me rregullat e përgjithshme të pranuar të drejtës ndërkombëtare dhe kontratat e ratifikuara ndërkombëtare.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e parashtron Prokurori Publik Republikan në afat prej tre muajve nga dita e dorëzimit të aktgjykimit.

### **Vendimi sipas kërkesës**

#### **Neni 286**

Rreth kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë vendos Gjykata e Lartë e Kasacionit.

Rreth mbledhjes së këshillit, gjykata nga paragrafi 1, i këtij neni do të njoftoj Prokurorin Publik Republikan.

Para se lënda të paraqiten për zgjidhje, gjykatësi i caktuar për raportim mund sipas nevoj të siguroj njoftime mbi shkeljet e theksura të ligjit.

### **Neni 287**

Gjatë zgjidhjes mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë Gjykata e Lartë e Kasacionit do të kufizohet vetëm në shqyrtimin e shkeljeve të rregullave për të cilat thirret në kërkesë e vet prokurori publik.

Rreth kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë i cili është dorëzuar përshkak të shkeljeve të ligjit (neni 285, paragrafi 1, pika 1) Gjykata e Lartë e Kasacionit vendos vetëm kur mendon se është fjala rreth çështjes nga rëndësia për zbatimin e drejtë dhe barabartë të të drejtave.

Gjykata e Lartë e Kasacionit me aktgjykim do të refuzoj kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë si të pa bazë, nëse vërtetohet se nuk egziston shkelja e rregullave në të cilat tregon në kërkesë.

Kur Gjykata e Lartë e Kasacionit vërtetohet se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar, do të sjellë aktgjykimin me të cilin sipas natyrës së shkeljes, do të amendoj vendimin e plotëfuqishëm apo të heq në mënyrë të plotë apo pjesërisht vendimet e gjykatës për kundërvajtje dhe gjykatës së shkallës së dytë për kundërvajtje dhe lëndën ta kthej në rivendim gjykatës për kundërvajtje apo të kufizoj vetëm atë që të vërtetohet shkelja e rregullave.

### **Neni 288**

Nëse kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është ngritur në dëm të dënuarit, ndërsa Gjykata e Lartë e Kasacionit gjenë se është e bazuar, do të vërtetohet vetëm a egziston shkelja e ligjit, duke mos prekur në vendimin e plotëfuqishëm.

Po nëse Gjykata e Lartë e Kasacionit gjenë arsyet për të cilat ka miratuar vendimin në favor të të dënuarit, egziston edhe për dikend prej bashkë të pandehurve të dënuar për të cilët nuk është ngritur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, do të veprojnë sipas detyrës zyrtare që ky lloj i kërkesës egziston.

Nëse kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është ngritur në favor të të dënuarit, Gjykata e Lartë e Kasacionit për Kundërvajtje gjatë sjelljes së vendimit lidhur me ndalesën nga neni 96, të këtij ligji.

## **Dorëzimi i aktgjykimit**

### **Neni 289**

Vendimi i Gjykatës së Lartë të Kasacionit në numrin e nevojshëm të shembujve i dorëzoet gjykatës për kundërvajtje përmes gjykatës së shkallës së dytë të kundërvajtjes.

### **Neni 290**

Nëse aktgjykimi i plotëfuqishëm hiqet dhe lënda kthehen në rigjykim, për bazë do të mirret kërkesa e mëparshme për nisjen e procedurës gjyqësore.

Gjykata është e nevojshme që të kryej të gjitha veprat e procesit de që të shqyrtoj çështjet për të cilat ka theksuar Gjykata e Lartë Kasacionit.

Në procedurën e përsëritur mund të theksohen faktet e reja dhe të dorëzohen faktet e reja.

Gjykata me rastin e miratimit të vendimit të ri lidhur me ndalesën nga neni 96, i këtij ligji.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk shtyen egzekutimin e aktgjykimit, mirëpo Gjykata e Lartë e Kasacionit gjatë zgjidhje së kërkesës mund të urdhëroj gjykatën që të shtyej, përkatësisht ndërpres egzekutimin e aktgjykimit deri sa nuk vendos mbi kërkesën e parashtruar.

## Kreu XXXIII PROCEDURA NDAJ TË MITURVE

### Zbatimi i dispozitave ligjore

#### Neni 291

Në procedurën për kundërvajtje ndaj të miturve zbatohen dispozitat e këtij kreu, ndërsa dispozitat tjera të procedurës për kundërvajtje janë të parapara me këtë ligj vetëm nëse janë në kundërshtim me këto dispozita.

Nëse ndryshe nuk është rregulluar me këtë ligj, në procedurën për kundërvajtje ndaj të miturit në përputhje me rrethat zbatohen dispozitat e Ligjit mbi kryesit e mitur të veprave penale dhe mbrojtjen penalo-juridike të personave të mitur („Gazeta Zyrtare e RS“, numër 85/05).

### Urgjenca e procedurës

#### Neni 292

Procedura për kundërvajtje ndaj të miturve është urgjente.

Para shqiptimit të masës edukative apo dënimit të të miturit, do të sigurohet mendimi i organit kompetent të kujdestarisë, përveç nëse ndërkohë i mituri është bërë i rritur.

Nëse organi kompetent i kujdestarisë nuk dorëzon mendimin në afat prej gjashtëdhjetë ditësh, gjykata mund t'i shqiptoj të miturit qortim ose dënim me të holla edhe pa mendimin e organit të kujdestarisë, duke i kushtuar rëndësi mbi zhvillimin mendor, ndjeshmërisë dhe karakteristikat personale të të miturit. Gjatë marrjes së veprimt ndaj të miturit në prani të tij, ndërsa posaçërisht gjatë dëgjimit të tij, personat të cilët marrin pjesë në procedurë janë të detyruar që të jenë të kujdesshëm, duke i kushtuar rëndësi zhvillimit mendor, ndjeshmërisë dhe karakteristikave personale të të miturit.

### Thirrja e të miturve

#### Neni 293

I mituri ftohet përmes prindërit, përkatësisht përmes përfaqësuesit ligjor, përveç nëse ajo nuk është e mundur përshkak të nevojave të reagimit të shpejtë apo shkaqe tjera të arsyeshme.

Nëse i mituri nuk ftohet përmes prindërit, përkatësisht përfaqësuesit ligjor, gjykata e cila udhëheq procedurën për kundërvajtje do t'i njoftoj rreth nisjes së procedurës.

Të miturit nuk mund t'i dorëzohet në formë të shkruar të shpallur në tabelën e shpalljeve të gjykatës.

### **Obligimi i dëshimit**

#### **Neni 294**

Askush nuk mund të lirohet nga detyra që të dëshmoj mbi mundësitë të nevojshme për vlerësimin e zhvillimit mendor të të miturit, njohjen e personalitetit të tij dhe mundësive në të cilat jetonë.

### **Ndarja dhe bashkimi i procedurës**

#### **Neni 295**

Kur i mituri ka marrë pjesë në egzekutimin e kundërvajtjes me personin e rritur, procedura ndaj tij do të ndahet dhe kryhet sipas dispozitave të këtij ligji.

Procedura ndaj të miturit mund të udhëhiqet sëbashku me procedurën kundër personave të rritur dhe të kryhet sipas dispozitave të përgjithshme të këtij ligji vetëm nëse bashkimi i procedurës është i nevojshëm për gjitha anët e shkarkimit të çështjeve.

Vendimin mbi ndarjen, përkatësisht bashkimin e procedurës e sjellë gjykatësi veprues.

### **Të drejtat e prindërve dhe kujdestarëve**

#### **Neni 296**

Mbi procedurën ndaj të miturve, organit të kujdestarisë, prindërve, përkatësisht përfaqësuesit ligjor të të miturve kanë të drejtë që të njihen me rrjedhën e procedurës, që gjatë procedurës të vendosen propozimet dhe të tregohen në faktet dhe dëshmitë të cilat janë të rëndësishme për sjelljen e vendimeve të drejta.

### **Mospërshtatshmëria e udhëheqjes së procedurës**

#### **Neni 297**

Gjykata mund të vendos që të mos udhëhiqet procedurë për kundërvajtje ndaj personit të mitur nëse mendon se nuk do të ketë përshtatshmëri që procedura të udhëhiqet duke pasur parasysh në natyrën e kundërvajtjes dhe rrethanava nën të cilat kundërvajtja është kryer, jeta e mëparshme e të miturit dhe karakteristikat e tija personale.

Në rastin nga paragrafi 1, i këtij neni, gjykata me vendim do të pezulloj procedurën për kundërvajtje, ndërsa në kundërvajtjen e bërë do të njoftohet prindi, adoptuesi, kujdestari, përkatësisht ushqyesi i personit të mitur dhe organi i kujdestarisë për arsye të marrjes së masave në kuadër të autorizimeve të tyre.

Rreth shqiptimit të masave edukative gjykata sjellë vendim.

## **E drejta në parashtrimin e ankesës**

### **Neni 298**

Kundër vendimit të miratuar në procedurën në të cilën të miturit iu është shqiptuar sanksioni për kundërvajtjen, ankesën mund ta deklaroj përveç personit nga neni 259, i këtij ligji, edhe kujdestari, vllau, motra dhe ushqyesi i të miturit.

Personat nga paragrafi 1, i këtij ligji mund ta deklarojnë ankesën në favor të të miturit edhe për kundër vullnetit të tij.

## **Qasja ndaj fëmijës**

### **Neni 299**

Kur vërtetohet se i mituri në kohën e egzekutimit të kundërvajtjes nuk ka i ka mbushur katërbëdhjetë vjet, do të pezullohet procedura për kundërvajtje.

Në rastin nga paragrafi 1, i këtij neni, gjykata rreth kundërvajtjes e cila është kryer e njofton prindin, adoptuesin dhe kujdestarin e të miturit, si edhe organin e kujdestarisë, ndërsa sipas nevojës mund ta njoftoj edhe shkollën, përkatësisht organizatën në të cilën është akomoduar i mituri.

## **Përfshirja e publikut**

### **Neni 300**

Në procedurë ndaj të miturit gjithmonë përfshirë publiku.

## **Kreu XXXIV**

### **KOMPENZIMI I DËMIT DHE KTHIMI I VLERËS SË TË HOLLAVE PËRSHKAK TË DËNIMIT TË PAJUSTIFIKUESHËM**

## **E drejta në kompensimin e dëmit përshkak të dënimit të pajustificueshëm**

### **Neni 301**

Të drejtë për kompensimin e dëmit ka personi i dënuar në mënyrë të pajustificueshme.

Me personin e dënuar në mënyrë të pajustificueshëm konsiderohet personi i cili me aktgjykim të plotëfuqishëm iu është shqiptuar dënimi i kundërvajtjes, masa mbrojtëse dhe masa edukative, ndërsa me rastin e mjetit të jashtëzakonshëm juridik procedura e re për kundërvajtje në plotëfuqishmëri është pezulluar apo është vendosur me aktgjykim lirues, përveç në disa raste:

- 1) nëse procedura për kundërvajtje është pezulluar përshkak të asaj që në procedurën e re me rastin e mjetit të jashtëzakonshëm juridik i dëmtuari si parashtrues i kërkesës ha hequr dorë nga kërkesa për nisjen e procedurës për kundërvajtje, ndërsa në bazë të marrëveshjes me të dënuarin;
- 2) nëse procedura e re për kundërvajtje është pezulluar përshkak të vjetërimit të nisjes dhe udhëheqjes së procedurës deri tek e cila ka ardhur përshkak të mosqasjes së të dënuarit;

3) nëse i dënuari me pranimin e tij të rrejshëm apo në ndonjë mënyrë tjetër me qëllim ka nxitur dënimin e tij, përveç nëse për këtë ka qenë i detyruar.

### **E drejta për kompenzimin e dëmit përshkak të heqjes së pa bazë të lirisë apo egzekutimit të kundërvajtjes**

#### **Neni 302**

Të drejtë për kompenzim ka edhe personi:

1) ndaj të cilit është caktuar egzekutim i sanksionit të kundërvajtjes para aktgjykimit të plotëfuqishëm nëse në procedurën e ankimit vjen deri tek pezullimi i procedurës për kundërvajtje apo deri tek lirimi nga përgjegjësia;

2) i cili është ndaluar, ndërsa procedura për kundërvajtje ndaj tij nuk është nisur apo nisja e procedurës më vonë është pezulluar, mirëpo jon ga arsyet e theksuara në nenin 301, paragrafi 2, pika 2) dhe 4) apo është liruar nga përgjegjësia;

3) që ka mbajtur dënimin me burg dhe me rastin e mjetit të jashtëzakonshëm juridik apo me rastin e ankesës të deklaruar kundër aktgjykimit me të cilin është caktuar egzekutimi i aktgjykimit para plotëfuqishmërisë, është shqiptuar dënimi me burg më i shkurtë se nga dënimi të cilin e ka mbajtur, apo është shqiptuar sanksioni i kundërvajtjes i cili nuk konsiston në heqjen e lirisë;

4) i cili është mbajtur pa baza më shumë se sa ligji e lejon.

Të drejtë për kompenzimin e dëmit nuk ka personi i cili me qasjet e palejuara ka shkaktuar vet heqjen e lirisë.

### **Zbatimi i duhur i Kodit mbi Procedurën Penale**

#### **Neni 303**

Nëse nuk është përcaktuar ndryshe me këtë ligj, në kompenzimin e dëmit përshkak të dënimit të pajustificuar në procedurën për kundërvajtje zbatohen dispozitat e ligjit me të cilin rregullohet procedura penale.

### **Kthimi i shumës së parave**

#### **Neni 304**

Personi i cili në procedurën për kundërvajtje në mënyrë jo të drejtë iu është shqiptuar dënimi në të holla, masa e konfiskimit të pasurisë apo masa mbrojtëse e konfiskimit të lëndës apo vlerës së parave të lëndës së konfiskuar (në tekstin e më tutjeshëm: kthimi i shumës së parave).

Kthimi i shumës së parave nuk mund të kërkoj personi i dënuar i cili me pranimin e rrejshëm ka shkaktuar dënimin.

### **Vjetrimi i të drejtave**

#### **Neni 305**



E drejta e personit të dënuar në mënyrë jo të drejtë që të kërkoj kompensimin e dëmit, përkatësisht kthimin e shumës së parave, vjetërsohet për tri vite nga egzekutimi i dënimit.

Vjetrimi nga paragrafi 1 i këtij neni pezullohet me parashtrimin e kërkesës në ministrinë përkatëse për punët e jurisprudencës.

Nëse kërkesa për kompensimin e dëmit, përkatësisht për kthimin e shumë së të hollave ka parashtruar personi i dënuar padrejtësisht, pas vdekjes së tij trashigimtarët e tij mund të vazhdojnë procedurën për realizimin e kërkesës në afat prej tre muajve nga dita e vdekjes së personit të dënuar padrejtësisht, dhe atë në bazë të kompensimit të dëmit material.

Nëse personi i dënuar padrejtësisht heq dorë nga kompensimi i dëmit, përkatësisht kthimit të shumës së parave, pas vdekjes së tij kërkesën nuk mund ta parashtroj.

#### *Procedura e realizimit të të drejtave*

#### Neni 306

Personi i autorizuar ka për detyrë që para parashtrimit të akuzës gjykatës me kërkesën e tij për kompensimin e dëmit t'i drejtohet ministrisë përkatëse për punët e jurisprudencës, për arsye të marrëveshjes mbi egzistimin e dëmit dhe lartësinë e kompensimit.

Nëse deri tek marrëveshja nuk vie në afat prej dy muajve prej ditës së pranimit të kërkesës, personi i autorizuar mund që gjykatës kompetente t'i dorëzoj akuzën për kompensimin e dëmit kundër Republikës së Serbisë. Kërkesa për kthimin e shumës së parave dorëzohet në ministrinë përkatëse për punët financiare.

Nëse organi kompetent rrefuzon kërkesën apo në afat prej dy muajve nuk sjell vendimin sipas kërkesës, personi i autorizuar mund që kërkesën e tij ta përmbush me padi për kompensimin e dëmit kundër Republikës së Serbisë.

Deri sa të zgjas procedura e organit kompetent nga paragrafi 1 deri 3, të këtij neni, nuk fillon vjetrimi i paraparë në nenin 305 të këtij ligji.

### Kreu XXXV EGZEKUTIMI I VENDIMEVE

#### Arritja e cilësisë së të egzekutuarit

#### Neni 307

Aktgjykimi, përkatësisht vendimi (në tekstin e mëtutjeshëm: vendimi) arrijnë cilësinë e plotëfuqishmërisë atëherë kur më nuk mund të kontestojnë me ankesë apo kur ankesa nuk është e lejuar. Vendimi i marrë në procedurën për kundërvajtje kryhet kur të bëhet e plotëfuqishme dhe kur egzekutimi nuk ka pengesa ligjor, nëse me këtë ligj ndryshe nuk është parashikuar.

Vendimi me të cilin është shqiptuar në mënyrë të plotëfuqishme dënimi në të holla apo është vendosur mbi kompensimin e të harxhimeve të procedurës apo mbi kërkesën e drejtës pronësore, apo është shqiptuar masa e konfiskimit të pasurisë, me forcë egzekutohet kur të arrij në vendim në afatin e paraparë për pagimin e dënimit, harxhimeve të procedurës, pasurisë, kompensimin e dëmit apo për kthimin e sendeve.

Urdhëri për kundërvajtje arrin cilësinë e të egzekutuarit me kalimin e afatit prej tetë ditëve nga dita e dorëzimit.

Nëse për disa raste të caktuara në ligj nuk është caktuar ndryshe, vendimi kryhet kur të kalojnë 15 ditë nga plotëfuqishmëria e tij, ndërsa nëse kundër vendimit është parashtruar ankesa, ai fat llogaritet nga dita e dorëzimit të vendimit të shkallës së dytë.

Urdhëri egzekutohet menjëherë nëse gjykata e cila e ka dhënë urdhrin nuk përcakton ndryshe.

Nëse personi juridik ndalon së egzistuari pas procedurës vendimtare të plotëfuqishme në të cilën janë vërtetuar përgjegjësia dhe sanksioni i egzekutuar për kundërvajtje, dënimi në të holla dhe përcaktimi mbi pasurinë do të kryhet ndaj personit juridik i cili është pasardhësi i tij juridik.

## **Egzekutimi para plotëfuqishmërisë**

### **Neni 308**

Aktgjykimi gjyqësor mund të egzekutohet edhe pas plotëfuqishmërisë në rastet e mëposhtme:

1) nëse i pandehur nuk mund të argumentoj identitetin apo nuk ka vendbanim, ose nuk jeton në adresën në të cilën është paraqitur, apo nuk ka vendbanim jashtë vendit apo shkon jashtë vendit për arsye të qëndrimit, ndërsa gjykata gjen se egziston dyshimi thelbësor që i pandehuri të ikë nga egzekutimi i sanksionit të shqiptuar;

2) nëse i pandehuri është dënuar për kundërvajtje të rëndë nga fusha e rendit dhe qetësisë publike, sigurisë së komunikacionit publik apo kundërvajtjes së rëndë me të cilën rrezikohet jeta apo shëndeti i njerëzve apo nëse këtë e kërkojnë interesat e sigurisë së përgjithshme apo sigurisë së qarkullimit të mallrave dhe financave apo për arsye morali apo është dënuar për kundërvajtjen nga e cila mund të ketë pasoja të vështira, ndërsa egziston dyshimi thelbësor që të vazhdohet me kryerjen e kundërvajtjes, të përsëritet kundërvajtja apo të shmanget nga egzekutimi i sanksionit të shqiptuar.

Në rastet në paragrafin 1, të këtij neni, në aktgjykim do të caktohet se i pandehuri edhe pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit të qaset egzekutimit të tij.

Nëse i akuzuari deklaron ankesën kund aktgjykimit me të cilin është caktuar egzekutimi i aktgjykimit para plotëfuqishmërisë së tij, gjykata është e obligueshme që shkresën e lëndës ta dorëzoj gjykatës së shkallës së dytë për kundërvajtje në afat prej 24 orëve, duke llogaritur edhe orën kur e ka pranuar ankesën, ndërsa gjykata e shkallës së dytë për kundërvajtje është obliguar që për ankesën të vendos dhe aktgjykimin e saj të ia dorëzoj gjykatës në afat prej 48 orëve duke llogaritur orën e pranimit të shkersës së lëndës.

Në aktgjykimin nga paragrafi 1, i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të deklaroj ankesën në afat prej 48 orëve, duke llogaritur orën e pranimit të aktgjykimit.

## **Egzekutimi i dënimit në të holla, taksës dhe harxhimeve të procedurës**

### **Neni 309**

Dënimet me të holla, dënimet të shqiptuara përshkak të mosrrespektimit të gjykatës, shqiptimit të tarifës gjyqësore dhe harxhimet e procedurës, vendimi mbi të kërkesën e drejtës pronësore dhe mbi konfiskimin e pasurisë egzekutohen në përputhje me këtë ligj.

## **Zbatimi i duhur i ligjit mbi egzekutimin e sanksioneve penale**

### **Neni 310**

Dënimi me burg, mospagesa e dënimit në të holla e shkëmbyer në dënim me burg, puna në interesin publik, masat mbrojtëse dhe masat edukative egzekutohen sipas ligjit me të cilin rregullohet egzekutimi i sanksioneve penale, po nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

### **Egzekutimi i masës mbrojtëse të konfiskimit të lëndës**

#### **Neni 311**

Masën mbrojtëse të konfiskimit të lëndës e egzekuton organi në të cilën kompetencë bie egzekutimi përkatësisht mbikqyrja ndaj rregullave sipas të cilat masa mbrojtëse është egzekutuar, nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

Nëse me aktgjykim është caktuar që lënda e konfiskuar t'i dorëzohet organit apo organizatës së caktuar, ai organ apo organizatë do të thirret që ta marrë lëndën.

Nëse kryersi me vullnet të tij ka tjetërsuar kundërvajtjen apo në tjetër mënyrë ka pa mundur egzekutimin, me vendim të posaçëm të gjykatës do të detyrohet që të paguaj vlerën në të holla, e cila i përshtatet vlerës tregtare të asaj lënde në momentin e miratimit të vendimit.

Nëse me aktgjykim është caktuar se lënda e konfiskuar të shitet, organi nga paragrafi 1, i këtij neni, do të kryej shitjen në përputhje me ligjin i cili e rregullon procedurën tatimore, nëse në ligjin e veçantë nuk është caktuar ndryshe.

Shuma e parave të fituar nga shitja e lëndës së konfiskuar, është e ardhur e buxhetit të Republikës së Serbisë.

### **Njoftimi mbi egzekutimin e masës mbrojtëse**

#### **Neni 312**

Organet të cilat sipas këtij ligji janë të detyruara të kryejnë masat mbrojtëse janë të obliguara që mbi egzekutimin e masave mbrojtëse të njoftojnë gjykatën e cila masën e shqiptuar.

### **Egzekutimi i masave të konfiskimit të pasurisë**

#### **Neni 313**

Masën e konfiskimit të pasurisë e egzekuton gjykata e cila e ka miratuar aktgjykimin.

Nga paluajshmëritë e detyrueshme mund të paguhet interesi pasuror i cila nuk ka mundur të paguhet në tjetër mënyrë.

Pagesa e detyrueshme e konfiskimit të pasurisë nga palëvizshmëria e kryen gjykata kompetente sipas rregullave të procedurës egzekutive.

Pasuria e konfiskuar me aktgjykim është e ardhur e buxhetit të Republikës së Serbisë.

Egzekutimi i masave të konfiskimit të pasurisë të shqiptuar ndaj personit juridik i cili pas aktgjykimit të plotëfuqishëm ka pushuar së egzistuari do të realizohet kundër personit juridik i cili ka marrë pronësinë e tij deri në lartësinë e pasurisë së konfiskuar.

Harxhimet e egzekutimit i mbart personi i dënuar.

### **Egzekutimi i dënimit me të holla dhe shumave tjera të të hollave**

#### **Neni 314**

Dënimi në të holla për kundërvajtjen e shqiptuar, harxhimet e procedurës për kundërvajtje dhe shumat e tjera në të holla të cilat janë paraparë në bazë të kompensimit të dëmit, në bayë të kërkesës së drejtës pronësore apo në bazë të konfiskimit të të mirës pronësore, e zbaton gjykata për kundërvajtje, e cila e ka shqiptuar, përkatësisht gjykata në të cilën territor është lëshuar urdhëri për kundërvajtje.

Dënimi në të holla, harxhimet e procedurës për kundërvajtje dhe shumat tjera të të hollave paguhen përmes postës apo bankës në fletpagesën e veçantë të cilën e plotëson gjykata kompetente, në afat të përcaktuar në vendim.

Nëse dënimi në të holla i shqiptuar me udhër të kundërvajtjes pagesa kryhet përmes numrit të llogarisë i cili është i shënuar në urdhresë (neni 170, paragrafi 1, pika 11).

Nëse personi i dënuar fizik, sipërmarrësi apo personi përgjegjës në afat të caktuar nuk paguan dënimin në të holla do të shkëmbehet në dënim me burg apo në punën në interesin publik, në përputhje me nenin 41, të këtij ligji apo të paguaj përmes rrugëve të detyrueshme.

Nëse personi i dënuar juridik në afat të caktuar nuk paguan dënimin në të holla, gjykata do ta paguaj përmes rrugëve të detyrueshme.

Harxhimet e pa paguara të procedurës dhe shumat e të hollave të shqiptuara në bazë të kërkesës pronësore juridike, kompensimin e dëmit apo konfiskimin e pasurisë gjykata do ta paguaj përmes rrugëve detyruese.

### **Vendimi mbi egzekutimin**

#### **Neni 315**

Pas kalimit të afatit për pagimin vullnetar, gjykata e cila ka sjellur vendimin e shkallës së parë e cila egzekutohet, përkatësisht gjykata në të cilin territor është dhënë urdhëri për kundërvajtje i cili egzekutohet sjellë vendim mbi egzekutim.

Me vendim gjykata cakton se a do të shkëmbehet pagesa e papaguar në dënim me burg apo në dënim me punë me interes publik apo të paguaj në mënyrë të detyrueshme.

Vendimin mbi cilën mënyrë do të egzekutohet dënimi i papaguar, gjykata e sjellë duke vlerësuar arsyet e përshtatshmërisë dhe efikasitetit në secilin rast konkret.

Nëse pas sjelljes së vendimit gjykata mbi shkëmbimin e dënimit në të holla, personi i dënuar do të paguaj dënimin e plotë, vendimi do të vendoset jashtë fuqisë, ndërsa dënimi me burg apo puna në interesin publik nuk do të kryhet apo do të pezullohet egzekutimi i mëtutjeshëm, nëse egzekutimi i ndonjë dënimi të tillë ka filluar.

Nëse personi i dënuar paguan pjesëne dënimit me të holla, vendimi do të amendohet kështu që pjesa e papaguar e dënimit në të holla shkëmbehet në denim me burg apo punë në interesin publikë apo pagim përmes rrugëve detyruese.

Nëse personi i dënuar nuk e kryen punën me interes publik apo as përmes dënimit të egzekutuar me burg prej nëntëdhjetë ditëve nuk paguan pjesën e mbetur të dënimit në të holla, me vendim të ri do të përcaktohet që pjesa tjeër e dënimit të paguhet përmes rrugëve detyruese.

### **Përmbajtja e vendimit mbi egzekutim**

#### **Neni 316**

Vendimi mbi egzekutimin përmban:

- 1) gjykata e cila ka sjellur vendimi;
- 2) personi të cilit iu është shqiptuar dënimi i cili egzekutohet;
- 3) vendimi përfundimtar me të cilin është shqiptuar dënimi në të holla;
- 4) shuma e shqiptuar e dënimit në të holla;
- 5) mjetet dhe lënda e egzekutimit si edhe të dhënat tjera janë të nevojshme për realizimin e pagesës së detyrueshme;
- 6) vendimi mbi harxhimet e egzekutimit;
- 7) udhëzimi për mjetin juridik.

Vendimi mbi pagesën e detyrueshme i dorëzohet të dënuarit, mbrojtësit të tij si edhe organit kompetent për zbatimin e vendimit.

Nëse me vendim mbi egzekutimin e pagesës së detyrueshme të harxhimeve të papaguara të procedurës dhe shumave tjera të të hollave të shqiptuara në bazë të kërkesës pronësore dhe juridike, kompenzimi i dëmit apo konfiskimi i pasurisë në vendim theksohet në mënyrë të veçantë.

### **Ankesa në vendimin mbi egzekutim**

#### **Neni 317**

Kundër vendimit mbi egzekutimin e personit të dënuar mund të dorëzohet ankesë në afat prej tri ditëve nga dita e pranimit të vendimit nga arsyet e mëposhtme:

- 1) nëse plotësohet detyrimi i cili detyrimisht egzekutohet;
- 2) nëse vendimi në bazë të cilës ndryshimi i caktuar i dënimit apo pagesa e detyrueshme hiqet, amendohet, vendoset jashtë fuqisë, përkatësisht nuk ka cilësinë e dokumentacionit egzekuteus;
- 3) nëse nuk ka kaluar afati për plotësimin e detyrimeve;

- 4) nëse gjykata e cila ka sjellur vendimin mbi egzekutim nuk është kompetente;
- 5) nëse nuk janë plotësuar kushtet për shkëmbimin e dënimit në të holla nga neni 41, i këtij ligji;
- 6) nëse pagesa e detyrueshme është caktuar në çështjet dhe drejtat jashtë nga egzekutimi, përkatësisht në të cilat mundësia e egzekutimit është e kufizuar;
- 7) në vendimin mbi harxhimet e egzekutimit.

Ankesa në vendimin mbi pagesën e detyruar nuk përmban egzekutimin e saj.

Gjykatësi kundër të cili vendimi mbi pagesën e detyruar është parashtruar ankesë mund vet të vendos jashtë fuqisë vendimin e tij nëse gjen se arsyet në ankesë janë të pa baza, në të kundërtën, do të dorëzohet ankesa me shkresat e lëndëve këshillit kompetent të atij ligji.

Rreth ankesës vendos këshilli në përbërje prej tre gjykatësve. Gjykatësi i cili ka sjellur vendimin mbi pagesën e detyrueshme nuk mund si anëtar i këshillit të vendos mbi këtë ankesë.

### **Mjetet dhe lëndët e pagesës së detyrueshme**

#### **Neni 318**

Mjetet të cilat bëhet pagesa e detyrueshme:

- 1) egzekutimi në mjetet nga llogaria e personit të dënuar;
- 2) egzekutimi me të ardhurat personale të personit të dënuar;
- 3) egzekutimi me regjistrim, vlerësim dhe me shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi të personit të dënuar.

Lëndët në të cilat realizohet pagesa e detyrueshme janë sendet dhe të drejtat në të cilat mund të realizohet egzekutimi sipas dispozitave të ligjit me të cilat rregullohet egzekutimi dhe sigurimi.

Mjetet të cilat kryhet pagesa e dënimit në të holla harxhimet e procedurës dhe shumave tjera në të holla dhe lëndët ndaj të cilave pagesa e detyrueshme realizohet e cakton gjykata me vendim mbi egzekutimin nga neni 315, i këtij ligji.

Nëse gjatë zbatimit të vendimit konstatohet se pagesa e detyrueshme nuk mund të realizohet me mjetet dhe lëndët e egzekutimit të cilat janë të caktuar në vendim, gjykata mund amendoj vendimin dhe të caktoj mjet tjetër dhe lëndën e egzekutimit.

Në procedurën e pagesës së detyrueshme pikë sëpari shlyen harxhimet e procedurës dhe harxhimet e egzekutimit.

Harxhimet e pagesës së detyrueshme dhe harxhimet e egzekutimit i bart personi i dënuar.

Pas vdekjes së personit të dënuar fizik, personit përgjegjës apo sipërmarrësit, pagesa e detyrueshme e dënimit në të holla, harxhimet e procedurës për kundërvajtje dhe shumave tjera të të hollave nuk do të egzekutohet.

### **Realizimi i pagesës së detyruar në mjetet nga llogaria e personit të dënuar**

### **Neni 319**

Pas pranimit të vendimit mbi egzekutimin e pagesës së detyrueshme të dënimit në të holla, harxhimet e procedurës dhe shumave tjera të të hollave nga llogaria e personave të dënuar e cila bëhet në bankat komerciale e kryen organi për pages të detyrueshme në përputhje me dispozitat e ligjit me të cilat rregullohet pagesat.

Organi për pagesën e detyrueshme është i detyruar që në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të vendimit mbi pagesën e detyruar të njoftoj gjykatën për kundërvajtje kompetente mbi pagesën e egzekutuar apo mbi arsyet e mosegzekutimit të pagesës së detyruar.

### **Zbatimi i pagesës së detyrueshme në të ardhurat personale të personit të dënuar**

### **Neni 320**

Gjykata mund që me vendim mbi egzekutim të caktoj se pagesa e detyruar të bëj sekuistrimin në të ardhurat personale të personit të dënuar.

Me vendim në paragrafi 1, i këtij neni, caktohet marrja e pjesës personale të të ardhurave të dënuarit dhe udhërohet që paguesit të këtyre të ardhurave që me rastin se secilës pages të atyre të ardhurave, duke filluar nga pagesa e parë e ardhshme nga pranimi i vendimit të gjyqit, dhe deri në pagesën e plotë të kryej pezullimin dhe të paguaj pjesën e pezulluar në llogarinë e caktuar pagesore.

Paguesi i të ardhurave personale të të dënuarit është i obliguar që menjëherë të veproj sipas urdhërit të gjykatës si edhe se gjykata kompetente të njoftoj mbi ndryshimet nga ndikimi në zbatimin e pagesës së detyrueshme më së voni në afat prej pesë ditëve nga dita ndodhjes së ndryshimit.

Nëse paguesi i të ardhurave personale të të dënuarit nuk pezullon dhe nuk paguan shumën e të ardhurave personale në të cilat realizohet pagesa e detyruar, në llogarinë e caktuar gjykata mund të sjellë vendim që pagesa e detyruar të zbatohet nga mjetet e llogarisë së paguesit.

Nëse me këtë ligj nuk është ndryshe caktuar në pagesën e detyruar nga të ardhurat personale e personit të dënuar, në pajtim zbatohen dispozitat e ligjeve të cilat rregullojnë egzekutimin dhe sigurimi.

### **Pagesa e detyruar në sendet e luajtshme dhe të paluajtshme të personit të dënuar**

### **Neni 321**

Në rast se nuk është e mundur që të kryhet pagesa e detyrueshme në tjerën mënyrë, gjykata mund të sjellë vendim që pagesa e detyrueshme të zbatohet në sendet e paluajtshme apo në sendet e paluajshme të personit të dënuar fizik, sipërmarrësve apo personit përgjegjës.

Pagesën e detyruar në sendet e luajshme dhe të paluajtshme të personit të dënuar do t'i zbatoj gjykata kompetente territoriale dhe reale, në përputhje me dispozitat e ligjit me të cilat rregullohet egzekutimi dhe sigurimi.

### **Obligimi i njoftimit mbi pagesën e dënimit në të holla**

### **Neni 322**

Rreth pagesës së egzekutuar të dënimit në të holla, harxhimet e procedurës dhe shumave tjera të të hollave, organi kompetent për pagesa publike është i detyruar që menjëherë ta njoftojë gjykatën, përkatësisht organin i cili ka sjellur vendimin e dorëzimit të raportit mbi pagesën, sëbashku me certifikatën mbi ndryshimet ditore në llogaritë e përshtatshme.

### **Neni 323**

Egzekutimi i aktgjykimit në aspektin e kompenzimit të dëmit dhe kthimit të sendeve kryhet me kërkesë të të dëmtuarit.

Aktgjykimi i plotëfuqishëm është titulli egzekutiv.

## **KREU XXXVI REGJISTRAT PERSONALE**

### **1. Regjistri i sanksioneve**

#### **Neni 324**

Për qëllim të sjelljes së evidencës personale të sanksioneve për kundërvajtje të shqiptuara udhëhiqet regjistri personal i sanksioneve.

Regjistri i sanksioneve është bazë e centralizuar elektronike në të cilën ruhen dhe përpunohen të gjitha të dhënat.

#### **Ruajtja dhe menaxhimi me të dhënat në regjistrin e sanksioneve**

#### **Neni 325**

Regjistri ruhet në mbajtësin e centralizuar elektronik të të dhënave pranë ministrisë përkatëse për punët e jurisprudencës, e cila është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe ruatjen e saj.

Ministria kompetente për punët e jurisprudencës është e obliguar që të marrë masat teknike, kuadrove dhe organizatore për mbrojtjen e të dhënave, në përputhje me standardet procedurat e miratuara, të cilat janë të nevojshme në mënyrë që të dhënat të mbrohen nga humbja, shkatërrimi, qasja e pautorizuar, ndryshimet, publikimi dhe të gjitha keqpërdorimet tjera, si edhe që të vërtetoj obligimin e personave të cilët janë punësuar në përpunimin që të ruajnë sekretin e të dhënave.

#### **Udhëheqësi i të dhënave në regjistrin e sanksioneve**

#### **Neni 326**

Kryetari i gjykatës për kundërvajtje emëron udhëheqësin e të dhënave në regjistër i cili ka këto autorizime dhe obligime:

1) që të kujdeset ligjërisht, sistematikisht dhe shënimin e azhuruar, fshirjen dhe ndryshimeve të të dhënave në regjistër;



- 2) të siguroj personave të autorizuar qasje në regjistër;
- 3) të jap çertifikata të vërtetuara nga regjistri dhe vërtetime që personi nuk është i shënuar në regjistër;
- 4) të sigurohet ruajtja dhe arkivimi i dokumentacionit i cili paraqet bazën për regjistër, shlyerjen apo ndryshimin e të dhënave në regjistër;
- 5) merr veprime të tjera të nevojshme për azhurimin e drejtë dhe pa pengesa të të dhënave në regjistër, në përputhje me ligjin.

### **Të dhënat të cilat shënohen në regjistrin e sanksioneve**

#### **Neni 327**

Në regjistër të sanksioneve shënohen këto të dhëna:

- 1) emri dhe mbiemri dhe numri personal i personit të dënuar fizik, sipërmarrësit, përkatësisht personit përgjegjës të personit juridik, përkatësisht numrin dokumentit të udhëtimit të personit të huaj fizik, për sipërmarrësit edhe emrin dhe selia e punëtorisë;
- 2) për personin e dënuar juridik emri dhe selia, PIB-i dhe numri amëz
- 3) vendimi i plotëfuqishëm, përkatësisht përfundimtar me të cilën është shqiptuar sanksioni i kundërvajtjes;
- 4) kualifikimi juridik i kundërvajtjes së kryer;
- 5) lloji dhe përshkrimi i sanksionit të shqiptuar të kundërvajtjes;
- 6) afati i masës së shqiptuar mbrojtëse;
- 7) gjykata për kundërvajtje e cila e ka sjellur aktgjykimin, përkatësisht organi i cili ka dhënë urdhërin për kundërvajtje;
- 8) gjykata për kundërvajtje e cila e ka kryer regjistrimin;
- 9) data e regjistrimit.

### **Shënimi i të dhënave në regjistrin e sanksioneve**

#### **Neni 328**

Shënimi i të dhënave nga neni 327, i këtij ligji, e kryen gjykata e cila ka miratuar vendimin e plotëfuqishëm apo përfundimtar, e cila është bazë për regjistrim, përkatësisht gjykata e shkallës së parë në të cilin territor është lëshuar urdhëri i kundërvajtjes i cili është bazik për regjistrim.

Shënimi i të dhënave në regjistrin e sanksioneve kryhet sipas zbatimit të plotëfuqishmërisë, përkatësisht konkludimit të vendimit me të cilin është shqiptuar sanksioni i kundërvajtjes, rreth të cilës gjykata kompetente kushton kujdes në bazë të detyrës zyrtare.

Dhënësi i urdhërit për kundërvajtje, në përputhje me nenin 173, paragrafi 3 i këtij ligji, është i detyruar që menjëherë pas skadimit të afatit nga neni 173, paragrafi 2, i këtij ligji, të dorëzoj gjykatës komptente kopjen e dhënies së urdhërit për kundërvajtje me konstatimin e konkludimit dhe shënimin që a është paguar denimi në të holla.

### **Fshirja e të dhënave nga regjistri i sanksioneve**

#### **Neni 329**

Sanksioni i shqiptuar i personit juridik, fizik dhe përgjegjës, si dhe sipërmarrësit fshihet nga evidenca në bazë të detyrës zyrtare nëse personi i dënuar në afat prej katër viteve prej ditës së vendimit të plotëfuqishëm me të cilin iu është shqiptuar sanksioni, të mos bëj ndonjë kundërvajtje tjetër.

Përrjashtimisht nga paragrafi 1, i këtij neni, vërejtja e shqiptuar fshihet në afat prej një viti nga momenti i plotëfuqishmërisë së vendimit me të cilin është shqiptuar.

Personit të mitur do t'i shlyhet dënimi i shqiptuar burgut për të mitur në afat prej dy viteve nga dita kur është egzekutuar, vjetruar dhe është falur dënimi, po nëse nuk kryen ndonjë kundërvajtje të re.

Masat mbrojtëse nuk do të shlyhen nga evidencat për kundërvajtje deri sa të mos kryhen apo deri sa të mos arrihet afati i vjetërimit të egzekutimit të masës mbrojtëse.

### **Dhënia e të dhënave nga regjistri i sanksioneve**

#### **Neni 330**

Të dhënat mbi personat e dënuar nga regjistri i sanksioneve mund të jepen vetëm gjykatës tjerër, prokurorisë kompetente, policisë dhe organeve të inspeksioneve, në lidhje me procedurën penale apo me procedurën për kundërvajtje e cila udhëhiqet kundër personit i cili më herët ka qenë i dënuar për kundërvajtje, organeve përgjegjëse për egzekutimin e sanksioneve për kundërvajtje apo organeve kompetente të cilat marrin pjesë në procesin e shlyerjes së dënimit.

Në kërkesën e autorizuar të organit nga paragrafi i mëparshëm i këtij ligji, mund të jepen të dhënat nga regjistri i sanksioneve për personin e dënuar po nëse ende zgjasin pasojat e caktuara ligjore të dënimit apo masat mbrojtëse apo nëse egziston interes i arsyeshëm i bazuar në ligj.

Qytetarëve dhe personave juridik me kërkes të tyre duhet t'i jepen të dhënat mbi dënimin e tyre për kundërvajtje.

Prej qytetarëve dhe personave juridik nuk mund të kërkohet që të dorëzojnë dëshmitë që nuk janë të dënuar për kundërvajtje, por vetëm nëse ajo është paraparë shprehimisht në ligj.

Me kërkesën për dhënie e të dhënave nga regjistri i sanksioneve dorëzohet edhe dëshmia për pagesën e kompenzimit për shërbimin e kërkuar. Kompenzimin për dhënie e të dhënave nga regjistri e përcakton me akt të veçant ministri për punët e jurisprudencës.

## **2. Regjistri i dënimeve të papaguara dhe shumave të tjera të të hollave**

#### **Neni 331**

Për qëllim të pagesës efikase të dënimeve të shqiptuara në të holla, kompenzimi i harxhimeve dhe pagesa e shumave tjera të të hollave në bazë të kompenzimit të dëmit, kërkesës së drejtës pronëse apo konfiskimin e pasurisë, udhëhiqet regjistër i posaçëm i dënimeve të papaguara dhe shumave tjera të të hollave (në tekstin e mëtutjeshëm: regjistri i dënimeve në të holla).

Regjistri i dënimeve në të holla është bazë e centralizuar e të dhënave në të cilën ruhet të gjitha të dhënat e dhëna në regjistër.

Të gjitha dënimet e papaguara, harxhimet e procedurës dhe shumat tjera të të hollave të cilat janë të shqiptuara me vendim të plotëfuqishëm dhe përfundimtar të gjykatës apo përmes udhërit përfundimtar dhe egzekuteus të kundërvajtjes regjistrohen në regjistrin e dënimeve në të holla.

Në ruajtjen dhe menaxhimin e të dhënave në regjistër të dënimeve në të holla zbatohen dispozitat mbi regjistrin e sanksionve nga neni 325 dhe 326, i këtij ligji.

### **Të dhënat të cilat shënohen në regjistër të dënimeve në të holla**

#### **Neni 332**

Në regjistër të dënimeve në të holla shënohen të këto të dhëna:

- 1) emri dhe mbiemri dhe numri personal i personit të dënuar fizik, sipërmarrësit, përkatësisht personit përgjegjës të personit juridik, përkatësisht numrin dokumentit të udhëtimit të personit të huaj fizik i cili në afat të caktuar nuk ka paguar plotësisht dënimin në të holla dhe shumat e tjera të shqiptuara apo nuk ka kompenzuar harxhimet shqiptimit të procedurës;
- 2) për personin e dënuar juridik emri dhe selia, PIB-i dhe numri amëz, për sipërmarrësit edhe selia e puntorisë;
- 3) vendimi i plotëfuqishëm, përkatësisht përfundimtar me të cilën është shqiptuar detyrimi në të holla;
- 4) gjykata për kundërvajtje e cila ka sjellur vendimin përkatësisht organi i cili ka lëshuar urdhërin për kundërvajtje;
- 5) shuma e borxhit dhe qëllimi e borxhit;
- 6) data e maturimit të dënimin për tu paguar;
- 7) gjykata për kundërvajtje e cila ka kryer regjistrimin;
- 8) data e regjistrimit.

Mospagimi i dënimeve në të holla dhe shumat tjera të shqiptuara në të holla evidentohen edhe ushqihen në regjistrin për dënime në të holla.

### **Shënimi i të dhënave në regjistrin e dënimeve në të holla**

#### **Neni 333**

Regjistrimi i të dhënave nga neni 332, i këtij ligji, e kryen gjykata e cila ka miratuar vendimin i cili është bazik për regjistrim, përkatësisht gjykata e shkallës së parë në të cilin territor është lëshuar urdhëri për kundërvajtje i cili është bazik për regjistrim.

Regjistrimi i të dhënave në regjistër të dënimeve në të holla kryhet pas afatit për pagesë vullnetare, rreth të cilës gjykata kompetente kushton rëndësi në bazë të detyrës zyrtare.

Në shënimin e të dhënave në regjistër të dënimeve në të holla në pajtim zbatohen dispozitat e nenit 328, paragrafi 3 i këtij ligji.

### **Shlyerja dhe ndryshimi i të dhënave në regjistrin për dënime në të holla**

#### **Neni 334**

Nëse personi i dënuar pjesërisht apo plotësisht e paguan shumën e borxhit apo nëse dënimi në të holla plotësisht apo pjesërisht e zëvendëson shqiptimin e dënimit me burg apo punë në interes publik, gjykata kompetente është e detyruar që menjëherë të kryej shlyerjen e të dhënave, përkatësisht të regjistroj ndryshimin e përshtatshëm në regjistrin e dënimeve në të holla.

Nëse personi i dënuar para procesit të egzekutimit vullnetarisht në mënyrë të pjesshme apo të plotë paguan dënimin me të holla me urdhërin për kundërvajtje, dhënësi i urdhërit është i obliguar që rreth kësaj të menjëherë të njoftoj gjykata kompetente.

Dënimi në të holla dhe harxhimet e procedurës, të dhënat mbi personin e dënuar si edhe të gjitha të dhënat në lidhje me këtë të shlyen nga regjistri i dënimeve në të holla, menjëherë pas asaj që i dënuari paguan shumën e borxhit të plotë, përkatësisht pas skadimit të afatit prej katër viteve nga dita kur urdhëri për kundërvajtje apo aktgjykimi të bëhen të plotëfuqishëm.

### **Qasja në të dhënat në regjistrin dhe dhënien e certifikatave dhe të dhënave nga regjistri**

#### **Neni 335**

Të dhënat nga regjistri i dënimeve në të holla janë të qasura në të gjitha gjykatat për kundërvajtje, si edhe organet kompetente për udhëheqjen e procedurave nga neni 336, i këtij ligji.

Në dhënien e të dhënave nga regjistri i dënimit në të holla, në pajtim zbatohen dispozitat e nenit 326 dhe 330, i këtij ligji.

Kërkesa për lëshimin e të dhënave nga regjistri i dënimeve mund të dorëzohet në secilën gjykatë për kundërvajtje.

Qasja në të dhënat nga regjistri i dënimeve në të holla edhe më saktë përcaktohet me aktin e posaçëm nga ministri për punë të jurisprudencës.

### **Pasoja e regjistrimi në regjistër për dënimet në të holla**

#### **Neni 336**

Për qëllim të pagesës së dënimit të shqiptuar në të holla, harxhimeve të procedurës dhe shumave tjera të shqiptuara të cilat janë evidentuar në regjistrin për dënimet në të holla, personit të dënuar deri sa plotësisht të shlyej shumën e borxhit nuk do t'i lejohet:

1) lëshimi i lejes së vozitjes dhe lejes provë të vozitjes;

2) lëshimi i vërtetimit për regjistrim, lejen e trafikut, tabelave dhe etiketës së regjistrimit, vërtetimin mbi regjistrimin e përkohshëm të veturave dhe tabelat e regjistrimit të përkohshëm;

3) çlajmrimi i veturës.

Me ligj të veçantë mund të parashihet edhe mohimi i përkohshëm i lëshimit apo shtyerjes së afatit të lejeve dhe dokumenteve.

Nuk mund të mohohet lëshimi apo shtyerja e afatit të lejeve dhe dokumentave të cilat kanë rrezikuar realizimin e të drejtave të njerëzve dhe pakicave kombëtare të garantuara me Kushtetutë, shëndetin dhe sigurinë e njerëzve, mjedisin jetësor apo pasuria e formës së madhe.

## Kreu XXXVII KONKLuzionet e Normave dhe Çaktimi i Lëndëve në Egzekutimin e Mardhënieve në Mes Gjykatave në Republikën e Serbisë

### Heqja dorë nga egzekutimi

#### Neni 337

Gjykata e cila e ka shqiptuar dënimin, masën edukative apo masën mbrojtëse mund të kërkojë që ky dënim, përkatësisht kjo masë të kryhet në hapësirën e gjykatës së dytë në Republikën e Serbisë, në të cilën ka vendbanim, përkatësisht qëndrim të personave të cilët zbatohet.

### Detyrimet e gjykatës sipas transferimit të egzekutimit

#### Neni 338

Gjykata e cila ka zbatuar egzekutimin sjellë vendim mbi harxhimet të cilat kanë ndodhur gjatë zbatimit të egzekutimit.

Për arsytet të shlyerjes së harxhimeve të ekzekutimit, gjykata e cila ka zbatuar egzekutimin do ta mbajë shumë prej vlerës së paguar.

## Kreu XXXVIII DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

#### Neni 339

Dispozitat mbi kundërvajtjet të cilat nuk janë në përputhje me këto ligje do të rregullohen deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji.

#### Neni 340

Procedurat për kundërvajtje do të fillojnë deri në ditën e zbatimit të këtij ligji do të përfundohet sipas rregullave të Ligjit mbi Kundërvajtjet („Gazeta Zyrtare RS“, nr. 101/05, 116/08 dhe 111/09)

Procedurat nga paragrafi 1, i këtij ligji, deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji për zgjidhjen sipas ankesës në vendimin e organit të administratës kompetente të gjykatës së shkallës së dytë për kundërvajtje.

Lëndët e gjykatave për kundërvajtje në të cilat deri në ditën e fillimit të këtij ligji nuk është miratuar vendimi sipas ankesës në vendimet e organeve të administratës, do t'i referohen në kompetencë gjykatës së shkallës së dytë për kundërvajtje.

#### **Neni 341**

Aktet nënligjore të përcaktuar me këtë ligj do të miratohen në afat prej gjashtë mujave prej ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.

#### **Neni 342**

Në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji ndalon së vazhduari Ligji mbi Kundërvajtjet („Gazeta Zyrtare e RS“, nr. 101/05, 116/08 dhe 111/09).

#### **Neni 343**

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Serbisë“, ndërsa zbatohet prej 1 mars 2014.

### **Nenet e pavarura të Ligjit mbi Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit mbi Kundërvajtjet**

(„Gazeta Zyrtare e RS“, nr. 13/2016)

#### **Neni 21**

Dispozitat rreth kundërvajtjeve të cilat nuk janë në përputhje me këtë ligj do të harmonizohen në afat prej një viti prej ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.

#### **Neni 22**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e shpalljes në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Serbisë“.